AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në**

**" Psikologji Klinike"**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Barleti"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.As.Dr. Oriola Hamzallari**
**Dr. Ela Tollkuçi**

**Janar/2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Master i Shkencave në "Psikologji Klinike"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Barleti" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit (DSHSSH) |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër MAS Nr. 507, dt. 06.09.2022 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikël i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike, 4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS (ETCS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 (Shtatë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | Viti akademik 2023-2024 5 PAE/3 PAK<br>Viti akademik 2022-2023 4 PAE/2 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | Viti akademik 2022-2023 4 studentë;<br>Viti akademik 2023-2024 15 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master i Shkencave në ``Psikologji Klinike`` është një program studimi, i cili ofrohet prej vitit 2022 dhe ka për mision përgatitjen e psikologëve me orientim klinik duke u bazuar në objektiva, strukturë dhe përmbajtje që i pajisin studentët me aftësi të thelluara në njohuri dhe aftësi praktike, që i përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe i përgatit për marrjen e licencës së psikologut.Vizioni i institucionit ku ofrohet ky program është krijimi i një programi të arsimit të lartë cilësor që të funksionojë si një sistem akademik i organizuar tërësisht në baza akademike të njohura sipas modelit të shprehur në Procesin e Bolonjës. Prespektiva e programit të studimit krijon mundësinë që studentët të jenë të përgatitur sa më shumë në përzgjedhjen e rrugëtimit të tyre profesional si brenda dhe jashtë vendit. Ky është një program studimi i ciklit të dytë të studimeve universitare, i nivelit 7 të studimeve të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike, me kohë të plotë, me 120 kredite dhe formon psikologë klinicistë. Ofrohet nga njësia kryesore: Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit si pjesë e Institucionit të ``Universitetit Barleti`` dhe njësia bazë është Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit. Kjo kurrikul kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me konteksin Shqiptar. Ky program i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur aplikimin e tij në të ardhmen. Programi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi specifike përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike të lidhura me çrregullime të veçanta. Programi i studimit i jep studentëve njohuri themelore teorike dhe praktike duke përfshirë si lëndë të formimit bazë deri tek lëndët më të shtjelluara dhe më specifike të profesionit. Programi synon të aftësojë studentët për të zotëruar profesionin si në aspektin teorik ashtu edhe praktik, duke i pajisur me njohuri plotësuese në drejtime të veçanta sipas kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të cilat i marrin përmes lëndëve me zgjedhje. Ky program studimi i nënshtrohet procesit të vlerësimit për akreditim për herë të parë, i cili bazohet në dy grupe lëndësh të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Numri i studentëve të rregjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencës në ``Psikologji Klinike`` për vitin akademik 2023 – 2024 është 15 studentë (të dhëna të mara nga sekretaria mësimore) gjatë vizitave në IAL.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Psikologji Klinike", identifikimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[1], si dhe në përputhje me Vendimin Nr. 825, datë 24.12.2021 "Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017", "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"[2]. Për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike'' ofruar nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në ``Universitetin Barleti``. ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit, Dr. Oriola Hamzallari dhe Dr. Ela Tollkuçi. Gjatë procesin të vlerësimit të jashtëm grupi i ekspertëve është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Rajna Lila. Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike", gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në datat 12-13 mars 2024. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht ``Univeristetit Barleti`` sipas parashikimeve të akteve rregullatore të ASCAL. Gjatë vizitës dy ditore (12-13 mars 2024) në ``Univeristetin Barleti`` u mbajtën takime me drejtuesin e njësisë kryesore dhe drejtuesin e njësisë bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, etj. Gjithashtu, u zhvilluan vizita në mjedise të UniBA-së, të DSHSSH-së, si dhe në bibliotekë, mjedise studimi, auditore, laboratorë, dhe në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj. Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon ``Universitetin Barleti``, Tiranë, MASR, publikun e gjerë dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në ``Psikologji Klinike`` mbi përmbushjen e standardeve. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë pikat e forta të tyre duke bërë të mundur fokusimin mbi to për një zhvillim cilësor dhe me standarde konform aspektit profesional dhe tregut të punës si dhe standardeve përkatëse.

[1] Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri" https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/P%C3%ABrmbledhje-e-legjislacionit-p%C3%ABr-arsimin-e-lart%C3%AB-perditesuar-deri-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf.

[2] Vendimi Nr. 825, datë 24.12.2021 Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/VKM%20Nr.825,%20dat%C3%AB%2024.12.2021%20P%C3%ABr%20disa%20shtesa%20dhe%20ndryshime%20n%C3%AB%20VMK%20Nr.%20109,%20dat%C3%AB%2015.2.2017.pdf

*Universiteti "Barleti", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 99 / 35 Prot, datë 04.12.2024. Universiteti "Barletit", njofton në ASCAL më datë 13.12.2024, me anë të shkresës me Nr.1661 Prot, datë 13.12.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit",* ***IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1661 Prot, Datë 13.12.2024.***

**Përgjigje mbi "Komente mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm"**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Psikologji Klinike"**

**Universiteti "Barleti"**

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

Lidhur me komentin e institucionit për:

**Standardi I.2;**

**Kriteri 1**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin Standardi I.2, Kriteri 1, GVB është shprehur si vijon:

"Sqarojmë se programit në shqyrtim MSc Psikologji Klinike:

Ka filluar në vitin akademik 2022-2023, e për rrjedhoje ka pasur vetëm një vit të parë ku janë ofruar 6 lënde nga staf PAE me total 45 kredite, dhe 2 lëndë janë mbuluar nga staf i jashtëm me total 15 kredite. Për vitin akademik 2023-2024, viti i dytë i studimeve për të njëjtin grup ka patur 3 lëndë të mbuluara nga staf PAE me 28 kredite dhe 2 lëndë me total 14 kredite të mbuluara nga staf PAK. Detyrimet përmbyllëse me 18 kredite (punimet e diplomave) janë mbuluar po ashtu nga pedagogë të brendshëm. Për vitin akademik 2023-2024, viti i ri i parë ka patur 54 kredite të mbuluara nga staf PAE dhe vetëm 6 kredite (1 lëndë) të mbuluar nga staf PAK. Pra në nivel kreditesh për programin nga 120 total, 91 janë ofruar nga staf PAE dhe 29 nga staf PAK pra 75.83% të brendshëm dhe 24.17% nga staf i jashtëm. Në nivel ngarkese mësimore 79% e orëve është mbuluar nga stafi me kohë të plotë, dhe 21% është mbuluar nga stafi me kohë të pjesshme. Sa më sipër është e provuar edhe nga orari mësimor, regjistrat e lëndëve dhe punimet e diplomave.

**Për më shume ju lutem referojuni tabelave, nr.12.1, 12.2, 6.1 dhe 6.2 të vëna në dispozicion në RVB. "**

GVJ përgjigjet si vijon:

Duke ndjekur sqarimin e dhënë dhe të specifikuar në totale kreditesh dhe raporte (përqindje) bashkëngjitur, GVJ sërisht gjen nevojën për një reflektim të detajshëm në mbrojtje të faktit që, rregullimi i raportit PAE/PAK, duhet riparë si i tillë dhe në mënyrë të pavarur nga vlera në kredite e orevë në auditor. Paraprakisht, theksojmë se, për nevoja argumentimi, GVJ në sqarim e tij, i referohet edhe tabelës nr. 4 të vënë në dispozicion me dosjen e akreditimit.

Nisur nga plani mësimor, në vitin e parë akademik 2022-2023, janë ofruar tetë lëndë të këtij programi dhe në vitin e dytë akademik 2024-2025, janë ofruar, tek të dyja vitet, katërmbëdhjetë lëndë, pra edhe gjashtë lëndë së bashku me praktikën dhe detyrimet përmbyllëse, të cilat zhvillohen në semestrin e tretë dhe të katërt. Dukshëm ky program studimi është i organizuar në lëndë, një pjesë e mirë e të cilave mbartin ngarkesë të lartë kreditesh (bihen në sy lëndët me 9 kredite). Këto lëndë të përkthyera në orë në auditor, janë ngarkesë e lartë dhe kjo mbulohen nga stafi PAE.

Nisur nga sa më sipër, po ti referohemi tabelës nr. 4, stafi PAE i departamentit, i cili lektron në këtë program studimi, rezulton me një ngarkesë totale mbi normë. Peshë në këtë ngarkesë zë edhe ajo që mbulohet për këtë program studimi.

Me qëllim që ngarkesa totale vjetore PAE të mbahet në normë, shpërndarja e ngarkesës për çdo program studimi mund të kërkojë një angazhim në rritje të personelit PAE, duke reduktuar kështu personelin PAK. Rikujtojmë se qëllimi final i kësaj është shmagia e mbinormës e cila mund të cënojë cilësinë e mësimdhënies të stafit PAE. Për këtë arsye, GVJ gjykon se raporti 70% me 30% për stafin PAE/PAK duhet respektuar si i tillë, pavarësisht krediteve dhe faktit që kjo duhet të shoqërohet me një rritje të angazhimit të personelit PAE. Si përfundim, shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar.

**Standardi I.2**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin I.2, Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"Sikurse shpjeguam më lart, mendojmë që llogaritjet kanë pasaktësi ndaj duhen rivleresuar. Për këtë arsye kërkojmë të konsiderohen rishikimet tona dhe të vleresohet ndryshimi në Përmbushet plotësisht."

GVJ përgjigjet si vijon:

Për shpjegimet e dhëna më lartë, lidhur me Standardi I.2; Kriteri 1, ritheksojmë problemtikën dhe nevojën qe raporti PAE/PAK duhet rishikuar me prioritet. Shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar. GVJ vazhdon ta vlerësoj këtë standard të Përmbushur Kryesisht.

**Standardi I.3**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin I.3, Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"Duke vlerësuar sugjerimin e GVJ për zgjerimin e marrëveshjeve, e cila ka qënë dhe mbetet në fokus të UniBa, na lejoni të sqarojmë se për numrin e studentëve që ka pasur ky program studimi edhe pse nga GVJ mund të konsiderohet i vogël, i kanë mbuluar plotësisht nevojat e studentëve, dhe në funksion të cilësisë së mësimdhënies.

**Sa më sipër lutem referojuni tabelës, nr.5 në RVB dhe evidencave nr. 10.2 dhe 10.3 të dorëzuara për procesin e akreditimit të programit.**

Departamenti zotëron gjithë dokumentacionet e nevojshme për të provuar aktivitetin e tij, përfshirë regjistrin e mbledhjeve të departamentit, komunikimet me emailin zyrtar, etj. Studentët përfshihen në aktivitete mësimore të detyrshme p.sh., praktikat mësimore sipas parashikimeve të kryera, ndërsa përfshirja e tyre në klubet e studentëve apo edhe në programet Erasmus+ është në varësi të interesave dhe kufizimeve të tyre. Dokumentat e praktikave profesionale vërtetojnë përfshirjen dhe perfitimin e studenteve nga këto bashkëpunime.

Shkalla e përmbushjes së Kriterit I është Përmbushet Kryesisht. Gjykojmë se nëse merren në konsideratë sqarimet tona, niveli i përmbushjes së fushës I duhet të jetë Përmbushet Plotësisht."

GVJ përgjigjet si vijon:

GVJ sërisht gjen nevojën të theksojë që marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet që përmbushin nevojat formuese të programit, janë garanci për ofrimin e cilësisë tek studentët në rritje të një programi që synon jetëgjatësi dhe sukses në kohë. Ky synim ushqehet nga diferenca në rritje e numrit të studentëve për të cilët ju, nga viti akademik 2022-2023 ku reflektoni 4 studentë, kemi një rritje me 15 studentë në vitin akademik 2023-2024. Akoma dhe më shumë ky synim dokumentohet në Evidencën nr. 4. e cila i referohet studim periodik të tregut per programin Msc. Psikologji klinike. Të dhënat dytësore të evidentuara nga ju në këtë studim, reflektojnë një trend konstant, mesatarisht 30 studentë të regjistruar dhe me një punësim në profil që shkon mesatarisht në 40% nga totali i të diplomuarve në vit. Këto tendenca duhet të jenë pikësynim që arrihet duke ofruar këtë programi studimi që, për më tepër, sikurse theksohet në këtë analizë tregu, paraqet avantazhe në krahasim me të tjerë të cilët ofrohen në Institucionet e tjera të arsimit të lartë. Ashtu sikurse ju theksoni, mundësia e bashkëpunimit me sa më shumë qëndra dhe Institucione nga më të mirat në vend është padiskutim një plus i rëndësishëm në këtë drejtim.

Në lidhje me marrëveshjet e bashkepunimit me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit, departamenti duhet te shtojë dokumentacionin dhe raportet, të cilat do të përbënin vlerë të shtuar nëse do t`i ishin bashkëngjitur RVB-së. Kjo do të evidentonte përpjekjen për të siguruar një përfshirje më të qartë të studentëve në këto bashkëpunime. Për ta ilustruar këtë mungesë, sërisht

bazuar në analizën e tregut të punës, në faqen 17, renditen një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me njësi të rëndësishme për hapjen e këtij programi studimi. Të gjitha këto marrëveshje parashtrohen në analizë si të lidhura specifikisht me funksion e këtij programi studimi. Evidentimi i tyre mungon në dokumentacionin bashkëngjitur dosjes së akreditimit vënë në dispozicion për GVJ-në.

Për shpjegimet e dhëna më lartë, shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar. GVJ vazhdon ta vlerësoj këtë fushë të Përmbushur Kryesisht.

**Standardi II.3**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin II.3, Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"Duke vlerësuar thellimin e grupit vlerësues në syllabuse, e gjejmë me vend të sqarojmë se pedagogët kanë lirinë akademike për të përgjedhur literaturën dhe temat për t'u trajtuar. Në disa raste përditësimi me libra të 5 viteve të fundit nuk përmbush kriterin e cilësisë për librat më të mirë në fushë. Sigurisht që literatura duhet të pasqyrohet sipas kritereve të shkrimit APA ku shkruhet mbiemri dhe gërma e parë e emrit, etj, por këto nuk gjykojmë se përbëjnë shkas për të vlerësuar përmbushje kryesisht, për sa kohë që në thelb, informacionet janë të pasqyruara, të detajuara e transparente. Sa i përket transferimeve, sqarojmë që procedurat janë të unifikuara në rregulloren e brendshme të transferimeve të studentëve, vleresimet bëhen me komisione të veçanta për çdo rast nga komisione të ngritura për këtë qëllim në nivel Departamenti.

**Sa më sipër lutem referojuni evidencës nr. 18. 2 të dorëzuar për procesin e akreditimit të programit.**

Për sa më siper, gjykojmë se niveli i përmbushjes duhet të behet Permbushet Plotesisht. "

GVJ përgjigjet si vijon:

GVJ ndjen nevojën të shtojë specifikimet si më poshtë:

-Parashtrimi i literaturës sipas kritereve të shkrimit APA, natyrisht që nuk përbënë shkakun e vetëm për vlerësim me përmbushje kryesisht, pasi në argumentim e GVJ evidentohen aspekte të tjera të rëndësishme si më poshtë:

- Mangësi dhe jo azhornim në disa syllabuse, sidomos përsa i përketë literaturën bazë. Përtejë lirisë së padiskutueshme akademike të çdo pedagogu si edhe, pa cënuar kriteret e cilësisë për librat më të mirë të fushës, rikujtojmë mundësinë që ofrohet për programet Master i Shkencave në shfrytëzimin e literaturës së azhornuar botërore në gjuhën angleze. Sigurisht, GVJ i njeh nevojat që ka ende vendi ynë për literaturë cilësore në lëmin klinik, por ndërkaq gjykon që për këto programe duhet të shohim me largpamësi edhe për mundësitë që ofron literatura botërore dhe aksesi i pakufijëzuar online që kemi sot.

-GVJ vazhdon të thekësoj mungesën e syllabusit të praktikës profesionale i cili është po aq i rëndësishëm sa syllabuset e çdo lënde apo moduli tjetër në program

- GVJ është i sigurt se, në rregulloren e brendëshme të trasferimeve të studentëve, janë të përcaktura procedurat e trasferimeve të studentëve dhe kjo, njësoj si për çdo rregulore tjetër në nivel institucional, jo gjithnjë është e aksesueshme për së drejti nga studentët. Nisur nga sa thamë, një udhëzues i posaçëm për studentët, i aksesueshëm në çdo moment nga ata, me të gjitha informacionet e nevojshme e jo vetëm kriteret e pranimit dhe rregulloret e transferimeve, është shembulli më demostrativ i transparencën së lartë institucionale për ta.

*Për sa më sipër, shkalla e rivlerësimit mbetet e pandryshuar. GVJ vazhdon të gjykoje se niveli i permbushjes vazhdon të jetë Permbushet Kryesisht.*

**II.4 (fq. 26-30)**

Lidhur me komentin e GVJ për II.4 (fq. 25-26), GVB është shprehur si vijon:

"Gjykojmë se gjetjet e bëra në këtë përmbledhje janë përsëritje të sa janë thënë më lartë mbi marrëveshjet e bashkepunimit, syllabuset, ngarkesat dhe sërish vlerësimi është përmbushet kryesisht. "

GVJ përgjigjet si vijon:

*GVJ vazhdon të mbajë qëndrimin fillestar dhe rekomandimet për përmirësim. Shkalla e rivlerësimit mbetet e pandryshuar. Niveli i përmbushjes vazhdon të mbetet Përmbushet kryesisht.*

**Standardi II.6**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin II.6, Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"Ky rekomandim me vlerësimin përmbushet kryesisht sërish është evaziv, pasi kërkon dokumentim për aspekte të evidentuara lehtësisht përmes punimeve të diplomave dhe projekteve ku përfshihen studentët e interesuar. Nuk ka rezultuar që studentët të kenë pasur kërkesa për angazhim të cilat nuk janë mbështetur në të tëra mundësitë, si ato për akses ashtu edhe ato financiare, që mundësohen përmes projekteve të ndryshme që janë në zbatim nga UNIBA.

*Për të gjitha sa më sipër kërkojmë rishikimin për vlerësimin e bërë në Përmbushet plotësisht.*

Shkalla e permbushjes së fushës II Përmbushet kryesisht gjykojmë se është total i sa më sipër dhe nuk reflekton plotësisht realitetin. Sigurisht që është punuar për të rritur punën kërkimore shkencore të Departametit, por theksojmë se anëtarët janë të përfshirë në projekte kërkimore shkencore dhe aplikative dhe programi në shqyrëtim ua ka mundësuar studentëve përfshirjen në to, sikurse provohet edhe nga punimet e diplomave.

Gjykojmë se nëse merren në konsideratë sqarimet tona, niveli i përmbushjes së fushës II duhet të ndryshojë në Përmbushet Plotësisht. "

GVJ përgjigjet si vijon:

GVJ është e mendimit që rekomandimi dhe vleresimit `Permbushet kryesisht` është plotësisht i argumentuar dhe mbështetet në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe vizitën e kryer në Institucion. Patjetër, jemi plotësisht të mendimit që punimet e diplomave janë një moment shumë i rëndësishëm hulumtues dhe kërkimor për studentët, por nuk janë të vetmet që kërkojnë dhe duhet të mundësohen për nivelet e formimit në Master të Shkencave. GVJ do të kishte dashur të njihej me të gjitha dokumentat që faktojnë angazhimin në aktivitete shkencore. Për sa më sipër i takon punimit të diplomave, vizita në institucion, nuk përkon me periudhën kur studentët dorëzojnë dhe diskutojnë temat që për më tepër, do të ishin të parat për këtë program studimi dhe nuk përbëjnë pjesë në këtë vlerësim.

Sa për të përmendur disa prej angazhimeve alternative: studentët inkurajohen të jenë pjesë e referimeve dhe artikujve në bashkëpunim me stafin akademik; ata duhet të angazhohen në konferenca shkencore studentore të organizuara posaçërisht për ta në nivel Institucional ose departamental apo edhe ndër-departamental; studentët marrin pjesë në debate shkencore me tematik të rëdësishme, etj. Këto, së bashku me përfshirjen në projekte, reflektojnë jo vetëm interesin e studentëve por edhe inisiativën dhe angazhimin e Institucionit për t`i incetivuar më së shumëti në këtë drejtim. Vërtetë GVJ nuk evidentoj kërkesa të studentëve për të cilat të ketë munguar mbeshtetja me të tëra mundësitë, por as nuk mundi të faktonte këtë duke u mbështetur në dokumentat për këtë program studimi. Për këtë arsye, nuk mund të mos e lëmë si rekomandimim. Vlerësimi nuk i referohet punën kërkimore shkencore të Departametit dhe anëtarëve, apo përfshirjes së tyre në projekte kërkimore shkencore dhe aplikative. Ky vlerësim lidhet specifikisht me mundësit e ndryshme të përfshirjes së studenteve dhe, në kushtet kur punimet e diplomave nuk mund të shërbejnë si provë, ato gjithashtu nuk mund të jenë të vetmet që demostrojnë nivelin e angazhimit të studentëve në këtë drejtim.

*Për të gjitha sa më sipër, Shkalla e rivlerësimit mbetet e pandryshuar. GVJ rikonfirmon vlerësimin e bërë me Përmbushet kryesisht.*

**Standardi IV. 1;**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin IV.1; Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"GVJ bazuar në dokumentacionit për kualifikimin e stafit akademik, ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, kushtet e pagave të personelit, lëvizshmërinë e stafit nga viti i parë i programit në vitin e dytë të programit, del në konkluzionin se ky standard përmbushet pjesërisht. UniBa dhe DSHSSH për të synuar arritjen e standardit plotësisht duhet të synojë rritjen

e qëndrueshmërisë së stafit akademik, kualifikimin e vazhdueshëm dhe në përputhje me programin studimor të të gjithë stafit, kushte transparente të punës për të gjithë stafin, rrogat e stafit akademik të përafrohen të paktën me pagat e personelit akademik në institucionet publike, duke nxitur motivimin e punonjësve për kualifikim të mëtejshëm, si dhe pozicione pune të stafit akademik në funksion të zhvillimit të karrierës së tyre akademik dhe jo që ky pozicion të shoqërohet me pozicione të personelit administrativ.

Duke e vlerësuar sugjerimin, sqarojmë se çdo anëtar i stafit ka kontrata individuale pune në përputhje me parashikimet ligjore, duke respektuar interesat e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Gjykojmë që kjo është një çështje që e rregullon tregu i punës dhe që e tejkalon qëllimin e vlerësimit. Duke qenë se ky konkluzion është për të tetë kriteret gjykojmë se duhet rishikuar vlerësimi për standardin me Përmbushet Plotësisht."

GVJ përgjigjet si vijon:

Konkluzionet në kriterin 4.1 janë bazuar në vlerësimin si të dokumentacionit të programit dhe vizitave të kryera në institucion. Një ndër problematikat lidhet me përfshirjen e pagave në çdo kontratë pune, duke nxitur transparencën e këtyre kontratave dhe duke qënë në përputhje me Kodin e Punës. Gjithashtu, problematika të tjera të evidentuara lidhen me largimin e mbi 50% të stafit PAE, dhe në një rrezik për të mbuluar kurset e programit studimor me 70% të stafit PAE. Pikëzimi me 3 sugjeron se ka mundësi për të përmirësuar kushtet e punës së stafit akademik, të rrisë transparencën e vlerësimit të tyre me pagat përkatëse, duke krijuar më shumë mundësi për një qëndrueshmëri më të lartë të stafit. Tek konkluzionet është bërë një ndryshim nga "ky standard përmbushet pjesërisht" në "ky standard përmbushet kryesisht". Ky ndryshim është bërë për të qenë në përputhje me vlerësimin me 3 pikë për këtë kriter. Vlerësimi me 3 pikë është vënë duke marrë parasysh përparësitë e ofrimit të programit studimor dhe duke vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme të UniBa për të rritur cilësinë e programit studimor. *GVJ ka marrë në konsideratë komentet e institucionit dhe mbas rivlerësimit të kriterit shpreh se shkalla e përmbushjes së këtij kriteri nuk ndryshon.*

**Standardi IV.2;**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin IV.2; Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"GVJ duke shfletuar dokumentancionin përkatës dhe duke vëzhguar ambientet e godinave universitare, nxjerrë përfundimin se infrastruktura e vënë në dispozicion nga UniBa është në përputhje me objektivat e programit studimor, e përshtatshme dhe garanton realizimin e procesit të mësimdhënies-mësimnxënies ndëraktive, si dhe garanton mjedise për zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike. UniBa ka arritur të krijojë marrëveshje në nivel institucional me institucione të rëndësishme publike dhe jo publike, dhe rekomandohet ë këto marrëveshje të zgjerohen në të ardhmen duke nxitur rritjen e kapaciteteve të bashkëpunimit me institucione të rëndësishme që

kanë me prioritet ofrimin e një game të gjerë shërbimesh të vlerësimit dhe ndërhyrjes psikologjike. Një shqetësim në lidhje me praktikën profesionale është se kreditet e vendosura nuk përputhen me realizimin e orëve në terren, informacioni është jo i plotë për ndarjen e orëve të praktikës, pasi është dhënë totali i orëve gjithsej e më pas janë dhënë informacione për orë të tjera praktike dhe orë individuale. Për këtë arsye sygjerohet të rishihet kjo mospërputhje për të krijuar mundësi studentëve për të plotësuar normën e orëve të praktikës profesionale sipas një organizimi në përputhje me kuadrin ligjor.

Meqenëse ky standard lidhet me vlerësimin e kapaciteteve fizike të institucionit dhe strukturave ku kryhen praktikat, dhe siç shprehet vetë GVJ kjo infrastrukturë është në përputhje me objektivat e programit studimor, e përshtatshme dhe garanton realizimin e procesit të mësimdhënies-mësimnxënies ndëraktive, si dhe garanton mjedise për zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike gjykojmë që shqetësimi i ngritur në konkluzion nuk lidhet me plotësimin e këtij standardi. Kapacitetet fizike janë ndër më modernet në Shqipëri, ndaj sygjerojmë rivlerësimin për përmbushjen e standardit në Përmbushet Plotësisht."

<u>GVJ përgjigjet si vijon:</u>

Në lidhje me konkluzionin në IV.2, vlerësimi për infrastrukturën e praktikës bazohet në një mospërputhje midis krediteve të kursit dhe orëve të kursit. Specifikisht kursi ka 12 kredite, që ekuivalentohen me 300 orë gjithsej, në semestrin e dytë përfshihen 18 orë praktike dhe 30 orë praktike individuale. Kjo mospërputhje midis krediteve të kursit dhe shpërndarjes së orëve ka nevojë për rishikim, pikëzimi me 3 pikë është vënë për të reflektuar këtë shqetësim dhe për të përmirësuar kurrikulën e programit studimor, specifikisht për kursin e praktikës profesionale. Evidenca 40.3 nuk konfiguron në dokumentacionin për programin, as në dokumentacionin e dërguar pas vizitës në institucion. Për këtë vlerësim është marrë në konsideratë Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike, si dhe Vendimi Nr.41, Datë 24.1.2018. Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. <u>*Si përfundim, shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar.*</u>

**Standardi IV. 3;**

**Konkluzione**

<u>Lidhur me komentin e GVJ për Standardin IV.3; Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:</u>

"GVJ arrin në konkluzionin se është bërë një përpjekje e rëndësishme për të krijuar hapësira studentëve për të shfletuar literaturën në shqip dhe në gjuhën e huaj. Por, ky proces ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, në hapësira të veçuara, të cilat plotësojnë standartet për mungesë zhurmash për lexim. Gjithashtu, programi studimor duhet të garantojë literatura të 5 viteve të fundit, e këto literatura të ofrohen në cikle leksionesh të përditësuara në gjuhën shqipe, të gjenden kopjet fizike dhe digjitale të këtyre literaturave dhe literaturave origjinale në gjuhët përkatëse. Rekomandohen më shumë hapësira fizike për librat fizikë për programin studimor, si dhe më shumë mundësi për studentët të shfletojnë literaturën në motor kërkimor të tjerë ku të kenë akses të plotë.

Sa u përket mjediseve. Insitucioni ka bibliotekën që përmbush kushtet për studim, sikurse dhe një numër të madh mjedisesh të tjera si PIT stop, klasa, amjente rekreative, menca ej., që u krijojnë kushte studentëve për të studiuar në mënyrë të pavarur e pa u penguar. Sa i përket literaturës, ajo garantohet nga biblioteka dhe pedagogët përmes librave e materialeve shtesë online që u mundësohen studentëve të cilët kanë akses të plotë në to dhe mundësi për t'i qarkulluar sipas interesave studimore, ndaj sygjerojmë rivlerësimin për përmbushijen e standardit në Përmbushet Plotësisht."

GVJ përgjigjet si vijon:

UniBa ka bërë përpjekje të rëndësishme për të ofruar një gamë të gjerë hapësirash përfshirë dhe hapësira për lexim. Vlerësimi i bërë merr në konsideratë kriteret për hapësirat e bibliotekës, jo hapësirat e integruara me ambiente të tjera si holli, pjesa e sekretarisë, ku studentët mund të lexojnë por hapësira është e zhurmshme dhe vazhdimisht me stimuj shpërqëndrues. Përpjekja e stafit akademik është vlerësuar në pikëzim, por duke qenë se studentët nuk kanë një sistem dixhital të formalizuar, këto përpjekje të rëndësishme mbeten jo formale. Për këtë arsye rekomandohet që kopjet fizike të leksioneve të depozitohen në bibliotekë. Pikëzimi me 3 pikë është tregues i përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur cilësinë e ofrimit të programit studimor, por gjithashtu ka hapësirë për të përmirësuar më tej infrastrukturën e bibliotekës, pasurimit me libra fizikë të përditësuar të literaturës ndërkombëtare dhe të depozimit të leksioneve në bibilotekë. Si përfundim, shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar.

**Standardi IV. 4;**

**Konkluzione**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin IV.4; Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"Në konkluzion, duke u bazuar në dokumentancionin e DVV si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ gjykon se UniBa disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional Intranet. Ky sistem përdoret më shumë nga punonjësit e administratës, personelit akademik dhe ndihmës akademik, por në programin e studimit master shkencor në psikologji klinike, nuk përdoret nga studentët. UniBa dhe DSHSSH ka vënë në dispozicion platforma komunikimi për studentët me anën e rrjeteve sociale, faqes së internetit, platformave të mësimit online, por është e nevojshme që sistemi Intranet të aplikohet tek studentët e programit të masterit shkencor në psikologji klinike.

Sistemi intranet mundëson akses të plotë në të të stafit, në folderin Shared. Ky sistem nuk ka për funksion komunikimin mes studentëve, të cilët mund të komunikojnë lirisht përmes platformave të tjera, përfshirë këtu e-mailin zyrtar, google clasrooms, etj. Sa më sipër lutem referojuni evidencës nr.35 fagja nr. 72 e në vijim. Sygjerojmë rivlerësimin për përmbushjen e standardit në Përmbushen Plotësisht."

GVJ përgjigjet si vijon:

UniBa vazhdimisht ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur cilësinë e ofrimit të programit studimor duke lehtësuar komunikimin dhe duke ofruar për studentët mundësi komunikimi me adresa zyrtare, duke ndihmuar dhe lehtësuar komunikimin e stafit administrativ dhe akademik, e ky organizim mjaft efikas është vlerësuar në këtë kriter. Pikëzimi me 3 pikë është vënë pasi është e nevojshme të ketë një sistem të formalizuar dixhital për studentët. Përmirësimi i infrastrukturës dixhitale për studentët krijon mundësi për formalizimin e procesit të të nxënit, të përfshirjes aktive të tye dhe të dokumentimit të procesit. ***Si përfundim, shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar.***

**Standardi IV. 5;**

**Konkluzionet**

Lidhur me komentin e GVJ për Standardin IV.4; Konkluzione, GVB është shprehur si vijon:

"Në konkluzion, GVJ rekomandon një analizë më të hollësishme të buxhetit financiar si në nivel institucioni, të njësisë kryesore dhe njësisë bazë duke evidentuar këtë proces. UniBa garanton financim për realizimin e programit, por ky financim nuk evidentohet si i qëndrueshëm në kohë, e gjithashtu nuk evidentohet nëse njësitë bazë kanë kapacitete të menaxhojnë në mënyrë efikase burimet financiare për programet e tyre, dhe rekomandohet që çdo program të ketë një buxhet specifik të implementimit të tij.

Ky konkluzion është i shkëputur nga gjetjet për secilin kriter të përfshirë në pikën 1V.5, ku vetëm tek kriteri 3 është sugjeruar " dokumentimi i auditit për çdo periudhë kohore, si auditit brenda institucionit dhe atyre jashtë institucionit". Kujtojmë që UniBa është institucion jopublik, mënyra si është i organizuar institucioni, është e centralizuar për të siguruar financim të qëndrueshëm në kohë e papenguar për realizimin e programit, të pa ndikuar nga aftësia e stafit për të përthithur fonde apo për t'i menaxhuar ato. Thënë ndryshe, nëse një anëtar i stafit ka nevojë për mbështetje në aktivitetin e tij shkencor, ai përfiton pas vlerësimit, mbulim nga një fond i vendosur në dispozicion nga institucioni. Po ashtu, projektet e fituara në kapacitet institucional, janë në funksion të përmbushjes së rezultateve të pritshme nga njësitë përkatëse. Projektet ku është përgjegjës për zbatim departamenti që ofron këtë program studimi, administrohen nga Financa e institucionit sipas parashikimeve të bëra në projekt, sikurse funksionon edhe në institucionet e tjera analoge. Institucioni ka rreth 20 vite që funksionon dhe ka treguar qëndrueshmëri të lartë financiare, ka mjedise në pronësi, ka investuar në rritjen e kapaciteteve nga viti në vit falë kësaj qëndrueshmërie financiare. E gjejmë vlerësimin plotësohen pjesërisht tërësisht të pabazuar dhe kërkojmë rishikimin e tij në Përmbushen Plotësisht. Sa më sipër është e shpjeguar edhe në tabelën nr.18 në RVB. Po ashtu vlerësojmë që në totalin e saj. Fusha IV duhet të ndryshojë në vlerësim në Përmbushet Plotësisht për të gjitha arsyet e sipërpërmendura."

GVJ përgjigjet si vijon:

Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë disa problematika që lidhen me këtë kriter. Së pari, është konstatuar se dokumenti i auditimit të jashtëm nuk është si evidencë. Evidencat në lidhje me auditimin e jashtëm mungojnë, duke krijuar paqartësi mbi praktikat financiare të institucionit. Së dyti, burimi më i madh financiar garantohet nga regjistrimi i studentëve. Mbështetja vetëm tek regjistrimet e studentëve si një burim parësor financiar është sfiduese dhe e paparashikueshme nën kushtet e një tregu të paqëndrueshëm. Së treti, gjithashtu, 5.7% e buxhetit shkon për aktivitete kërkimore dhe blerje librash, 2.2% për projekte dhe 3% për teknologji në mësimdhënie, duke sugjeruar se këto burime janë të kufizuara për të nxitur ofertën akademike dhe për të mbështetur zhvillimin e stafit akademik. Së fundmi, në evidencat e programit studimor mungon një plan buxhetor në nivel të njësisë bazë për programin. Për këtë arsye GVJ rekomandon një plan strategjik për qëndrueshmërinë financiare të institucionit duke rritur burimet e të ardhurave financiare dhe duke krijuar prioritete në kërkim si dhe një plan buxheti në nivel të njësisë bazë ku të ketë zëra për programin studimor. GVJ vlerëson përpjekjet e auditimit të brendshëm dhe transparencën e shfaqur për tabelat financiare. GVJ shpreson që duke u bazuar në këto vlerësime, do të mbështesim institucionin në nxitjen e mjediseve të qëndrueshme financiare që i japin prioritet ekselencës akademike.

*Si përfundim, shkalla e rivlerësimit të standardit mbetet e pandryshuar.*

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Psikologji Klinike".**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Sipas Statutit[3] Institucioni jopublik i arsimit të lartë Universiteti ''Barleti'' i quajtur ndryshme UniBa e bazon aktivitetin e tij në ligjin nr. 80/2015, ''Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë'' si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Rregullorja e Universitetit ''Barleti''[4], rrjedh nga Statuti i Insititucionit dhe hartohet në funksion të zbatimit të tij. Në parimet e tij bazë UniBa është institucion laik, i depolitizuar dhe i pavarur. Sipas parimeve në rregulloren e aktivitetit të UniBa, udhëheq fryma e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të sanksionuara në aktet juridike kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim eleminimin e çdo praktike jodemokratike, diskriminuese apo denigruese, ndaj stafit akademik, studentëve dhe stafit administrative në tërësi.<br>UniBa ka për mision përgatitjen e studentëve jo vetëm si profesionistë por edhe si qytetarë të angazhuar në një botë në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Në vizionin e tij UniBa është një institucion cilësor dhe një aktor zhvillimi që ofron vlera profesionalizmi dhe qytetarie, duke përgatitur individ të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e | UniBa ka për mision përgatitjen e studentëve jo vetëm si profesionistë por edhe si qytetarë të angazhuar në një botë në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm.<br>Sipas objektivave të programit[5] është përgatitja e psikologëve të cilët t`i përgjigjen nevojave të tregut. Sipas rregullores programi bazohet në përvojat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në |

[3] Evidenca 1.4 Statuti I Universitetit ''Barleti'' 2020, KREU I, Dispozitë e Përgjithshme, Neni 1, Neni 3, Neni 4, Neni 5.
[4] Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit ''Barleti'', KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 1, Neni 3.
[5] Evidenca 3. Rregullore e Programit MSh në psikologji Klinike, Tiranë 2022, KREU I, Dispozita e Pëgjithshme, Neni 2, Neni 3.

| | |
|---|---|
| veprimtarisë. | përputhje me nevojat e tregut dhe të kohës dhe për t`ju përgjigjur aspiratave për një shërbim të përshtatshëm jo vetëm individual dhe të shoqërisë por mbi të gjitha duke respektuar standardet europiane të profesionit të psikologut klinik.<br>Nisur nga qëlllimet e Institucionit të përshkruara në Statutin[6] e tij, si edhe objektivat e programit, vihet re se ka përputhshmëri me këto pika të qëllimeve të parashikuara në statut:<br>1. të ofrojë studime univesitare të cikleve të ndryshme bazuar në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve EQF dhe Kornizën Shqipëtare të Kualifikimeve KSHK, të bazuar në kërkim dhe inovacion si dhe të lidhur ngushtë me praktikën e aplikimit.<br>2. Të zhvillojë programe formuese dhe trajnuese si dhe të realizojë shërbime në një prespektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare.<br>Programi është gjithashtu në përputhje me shtyllat kryesore të aktivitetit të UniBa të parashikuara në Statut dhe në rregulloren e Universitetit[7]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Nisur nga objektivat e programit të studimit të renditura në rregulloren[8] e tij, programi hartohet dhe ofrohet në përshtatje me tre shtyllat të Statutit[9] dhe të rregullores UniBa[10], përkatësisht:<br>a. Shtylla akademike e fokusuar në strukturën dhe ofertën akademike<br>b. Shtylla e studentit në qëndër e fokusuar në veprimtarinë studentore dhe komunitare<br>c. Shtylla e kërkimit të aplikuar dhe inovacionit, e fokusuar në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuara.<br>Po ti referohemi stategjisë së zhvillimit (2020-20230)[11] gjejmë përshtatshmëri të këtij programi me platformën e zhvillimit të përbërë nga konteksti, vizioni dhe misioni i këtij Universiteti dhe specifikisht në faktin që ky Universiteti funksionon si një sistem akademik i organiuar tërësisht në baza akademike të njohura sipas modelit të shprehur në Procesin e Bolonjës. Programi është në përputhje me gamën e gjerë të programeve të studimit që synon të |

[6] Evidenca 1.4 Statuti i Universitetit ''Barleti'' 2020, KREU I, Dispozitë e Përgjithshme, Neni 4, Neni 6, Neni 7.
[7] Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit ''Barleti'', KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 4.
[8] Evidenca 3. Rregullore e Programit MSh në psikologji Klinike, Tiranë 2022, KREU I, Dispozita e Pëgjithshme, Neni 2, Neni 3.
[9] Evidenca 1.4 Statuti i Universitetit ''Barleti'' 2020, KREU I, Dispozitë e Përgjithshme, Neni 6.
[10] Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit ''Barleti'', KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 4.
[11] Evidenca 5.1. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2023, fq 4-7.

| | |
|---|---|
| | ofrojë institucioni përfshirë edhe programet e studimit Master i Shkencave sikurse është edhe ky program. Strategjia e zhvillimit parashikon brenda misionit të Universitetit përgatitjen e studentëve të nivelit të lartë dhe profesionistë si edhe programe studimi që synojnë një ofertë akademike të pasur dhe gjithëpërfshirëse duke krijuar përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar. Në strategjinë e zhvillimit UniBa gjithashtu ka për qëllim të zhvillojë programe formuese dhe trajnuese dhe të realizojë shërbime arsimore, sociale dhe kulturore në një prespektivë të gjerë Evropiane dhe ndërkombëtare. UniBa ka për qëllim të zhvillojë kërkimin shkencor aplikativ në koordinim të vazhueshëm me qëndrat dhe Insitutet e UniBa dhe nevojat e operatorëve zbatues edhe në shoqëri. Për përmbushjen e qëllimit stategjia e zhvillimit në UniBa parashikon që Institucioni mund të kontraktohet dhe/ose të lidh marrëveshje bashkëpunimi me ente publike dhe private për veprimtari të përbashkëta didaktike, të praktikave mësimore, kërkimit dhe konsulencës e shërbimeve ndaj të tretëve. Programi është gjithashtu në përputhje me shtyllat e zhvillimit të Universitetit të parashikuara edhe në strategjinë e tij të zhvillimit (2020-2030). |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integrimit Europian 2030 është dokumenti kryesor që përcakton prioritetet e zhvillimit të vendit për periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Ajo integron objektivat kombëtare për zhvillim ekonomik dhe social, si dhe procesin e integrimit evropian dhe përmbushjen e objektivave të qëndrueshme ndërkombëtare.<br>Ky program studimi respekton Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit Europian 2030 në disa pika të rëndësishme:<br>-është një program në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF), një element kyç i strategjisë së integrimit europian.<br>-Universiteti Barleti fokusohet në zhvillimin e kërkimit të aplikuar dhe inovacionit, që është një tjetër prioritet i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim. Në përputhje me strategjinë, institucioni angazhohet në kërkime të aplikueshme që kontribuojnë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit.<br>-Programi ofrohet për të përgatitur studentë profesionistë dhe qytetarë të angazhuar duke qënë kështu në përputhje me objektivin e strategjisë për të krijuar një shoqëri të aftë të përballojë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktika profesionale janë një tjetër shembull i përputhshmërisë me këtë strategji. |

| | |
|---|---|
| | Nisur nga këto aspekte, programi i studimit i ofruar nga Institucioni po kontribuon në përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit Europian 2030, veçanërisht në fushat e arsimit, kërkimit dhe përgatitjes profesionale |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Master i Shkencës në Psikologji Klinike ofruar nga në Universiteti Barleti (UniBa) është në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke siguruar që arsimimi i studentëve të përmbushë standardet e kërkuara për tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Kjo është në linjë me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit Europian 2030, që promovon përmirësimin e kualifikimeve dhe harmonizimin me standardet evropiane.*<br>*Gjithshtu, UniBa është e fokusuar në kërkim dhe inovacion, veçanërisht në kërkime të aplikuara që kontribuojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.*<br>*Programi i studimit si edhe misioni i UniBa synojnw përgatitjen profesionale të studentëve dhe formimin e tyre si qytetarë të angazhuar nw përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Institucioni i arsimit të lartë, Universiteti \`Barleti\` (UniBa), është licencuar me vendim Nr. 571, datë. 12.08.2005 dhe kryen veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi[12]. Pra ky Universitet ka tashmë më shumë se 18 vjet vite eksperiencë në treg. Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit i cili është një ndër katër njësitë bazë që ofrohen nga ky Universitet. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në vetëvete është i përbërë nga katër Departamente:<br>1. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve<br>2. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional<br>3. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit |

[12] Evidenca 1.4 Statuti i IAL.pdf

| | |
|---|---|
| | 4. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit<br><br>Departameni i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit është ai brenda të cilit ofrohet ky program Studimi[13]. Ky program Studimi[14] ka fushë kërkimore të përafërt ose komplementare me atë të programeve të tjera kërkimore që ofron ky Departament. Në përbërjen e tij **Departamenti për vitin akadedmik 20023-2024** ka ka **7 anëtarë personel me kohë të plotë** prej të cilëvë 1 është me titull Prof. Asoc. Dr. 5 janë me titull PhD/Dr. dhe një anëtar ka gradën Msc[15]. Rezulton që përgatitja e personelit është në përputhje me parashikimet e Rregullores së këtij Departamenti. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe koordinohet nga Koordintori i Departamentit ashtu sikurse përcaktohet në rregullore e Departamentit. Në programin e studimit japin mësim 5 pedagogë me kohë të plotë të gjithë që gëzojnë titullin Dr./PhD[16].<br><br>*Ajo që vihet re është se në nivel Departamenti ka një raport të zhdrejtë mes stafit me kontratë dhe stafit efektivë pasi raporti i tyre është 15 me 7. Me qëllim që të demostrohen kapacitete dhe burimet e duhura në nivel institucional departamenti duhet të mbulojë minimalisht nevojat e tij me 70 % të stafit të brendëshëm ndërkohë që jemi në nivelet e 30%. I njëjti rezultat evidentohet edhe për stafin brenda programit të studimit për të cilin, këto raporte PAE/PAK janë 5/3 pra stafi PAE mbulon 60% të nevoja për këtë program studimi. Duhen bërë përpjekje për të rregulluar mbulimin e këtyre nevojave sipas kërkesave ligjore.* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas | Programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është program i ciklit të dytë të studimeve referuar nivelit 7 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve. Programi realizihet me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike[17]. Fusha e studimit të programit është në përputhje me atë të Fakultetit të shkencave socile, Turizmit dhe Sporit[18] për aq kohë sa ky fakultet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe pas miratimit nga ana e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, ofron programe të ciklit të dytë të studimit. Në fund lëshohet diplomë përkatëse. Programet e studimit Master i Shkencave në këtë Fakultet japin njohuri të |

[13] Evidenca 1.2 Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.pdf
[14] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf
[15] 6. Lista e plote e stafit te departamentit te shkencave te sjelljes dhe shendettit.pdf
[16] Lista e plote e stafit akademik qe jep mesim ne kete program studimi.pdf
[17] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf
[18] Evidenca 1.1 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit.pdf

| | |
|---|---|
| direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | thelluara teorike, praktike dhe trajnim për kërkimim shkencor në një fushë brenda një specialiteti. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është në përputhje me objektivat kryesorë të Departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit (DSHSSH) që është njësia bazë nga i cili buron ky program studimi. Kjo njësi bazë ka në fokus përcjelljen e dijeve dhe aftësimin praktik të studentëve në funksion të rritjes së mirëqënies bio-psiko-sociale të individit për t`u integruar, ndër të tjera, edhe në profesionin e psikologut[19]. Programi i përgjigjet nevojave të tregut duke formuar profesionistë të shëndetit mendor të aftë për t`u përballur me sfidat e profesionit[20]. Në afat të gjatë njësia bazë synon të shëndërrohet në një factor impakti, përmes ofrimit të një edukimi cilësor në fushën e psikologjië si edhe përfshirjen në ktivitete apo projekte aplikative që mundësojnë vënien ë njohurive në praktikë. Objektivat e programit të studimi[21] konsistojnë në cilësinë akademike në përputhje me standardet ndëkombëtare, zhvillimin e kërkimit shkencor bazik dhe të aplikuar me cilësi të lartë, forcimin e lidhjeve me tregun e punës dhe ndërkomëbëtarizimin e programit të studimit të cilat gjithashtu janë në përputhje me katër pikat e objektivave strategjik të DSHSSH si më poshtë:<br>1. Ofrimi i një cilësie akademike në nivele ndërkombëtare<br>2. Prodhimi i kërkimit shkencor bazik dhe të aplikuar me cilësi të lartë<br>3. Forcimi i lodhjeve me tregun e punës<br>4. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit<br>Njësia bazë[22] sipas rregullores së saj, Kreu III Ciklet dhe programet e studimti, Neni 17, parashikon të ofrojë programe studimi të ciklit të dytë përfshirë peogramet e studimit \`Master i Shkencave\` sikurse është dhe programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike duke qënë gjithashtu në përputhje me përcjelljen e njohurive të thelluara teorike dhe praktike si edhe trajnimin për kërkim shkencor në fushën sipas specialitetit. Programi ofrohet në 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike ose katër semestra. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program Studimi |

[19] Evidenca 5.2 Strategji e Zhvillimit të Departamentit 2022-2025
[20] Evidenca 1. Strategji e Zhvillimit të Programit të Studimit Msc Psikologji Klinike.
[21] Evidenca 3. Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.
[22] Evidenca 1.2 Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.

| | |
|---|---|
| "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Në nivel Institucioni (UniBa) bën përpjekje që Diplomimi i studentëve në këtë program studimi, të mos shënojë mbylljen e marrëdhënies mes tij dhe institucionit në tërësi. Sikurse citohet në raportin e vlerësimit të brendëshëm:<br>*`Angazhimi i UNiBa me këtë grup është institucional, i përkushtuar dhe ambicioz. Synimi është ofrimi i ndihmës në kualifikimin e vazhdueshëm të të diplomuarve, gjë e cila realizihet edhe përmes trjanimeve që UniBa ofron në fushat specifike të programit ku ata u diplomuan. Me këtë synim u Krijua Akademia e Mirëqënies dhe Shëndetit dhe Sportit`.*<br>Në mbështetje të sa më sipër, është raporti i punës vjetore të Departamentit DSHSSH 2023-2024[23], ku një zë në tabelën e aktiviteteve të planifikuara nga ky Departament janë edhe aktivitetet trajnuese në kuadër të akademive, sipas së cilave, në muajt Tetor 2023-Maj 2024, departamenti parashikon koordinimin me zyrën e trajnimeve që studentët e programeve të jenë pjesë e trajnimeve të organizuara nga Akademia (përfshirë studentët e Masterit të Shkencave në Psikologji Klinike), për të siguruar një marrëdhënie vazhdimësie midis studentëve dhe UniBa. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike synon ofrimin e një cilësie akademike të nivelit ndërkombëtar dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Objektivat strategjike të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit përfshijnë zhvillimin e kërkimit shkencor bazik dhe të aplikuar, forcimin e lidhjeve me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimin e programeve studimore. Këto objektiva janë thelbësore për zhvillimin afatgjatë të programit dhe për përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale.*<br>*Universiteti "Barleti" synon të mbajë një marrëdhënie të vazhdueshme me studentët e diplomuar, duke u ofruar mundësi trajnimesh dhe përfshirje në aktivitete praktike përmes Akademisë së Mirëqënies, Shëndetit dhe Sportit. Kjo është një iniciativë që synon zhvillimin profesional të vazhdueshëm të të diplomuarve.* |

[23] Evidenca 28.2. Raport i Punës vjetore të Departamentit 23-24.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *<u>Problematika e raportit stafit.</u>* *<u>Në nivel departamenti dhe programi, ka një disproporcion mes stafit të brendshëm dhe atij me kontratë. Vetëm 30% e nevojave në nivel departamenti dhe 60% e nevojave në nivel programi studimi mbulohen nga stafi i brendshëm, që bie ndesh me kërkesat ligjore për mbulimin e këtyre nevojave me një përqindje më të lartë të stafit me kohë të plotë.</u>* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | **X** | |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Rregullorja e Universitetit \`Barleti\`[24] është dokumenti kryesor që përcakton organizimin, funksionimin, detyrat, kompetencat, përgjegjësitë si edhe marrëdhëniet ndërmjet njësive. Kjo rregullore përcakton gjithashtu rregullat kryesore të organizimit dhe funksionimit të veprimtarive vendimarrëse kolegjiale dhe /ose individuale, të procesit mësimor/kërkimor, si edhe të çdo aspekti tjetër të përfshirë në fushën e aktiviteteve që mbulon ky Universitet. Kjo Rregullore ka të përcaktuar ndarjen e detyrave mes njësive kryesore, njësive bazë, organeve kolegjiale, Dekanatit, Rektoratit, Këshillave, Komisioneve, Njësive dhe Zyrave të gjitha struktura me përgjegjësi përkatëse por që bashkërendojnë dhe analizojnë punën përkatëse duke garantuar kështu mbikëqyrjen dhe mbarëvatjen e punës edhe të këtij programi studimi. Në rregulloren e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit[25] janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar përgjegjësitë, detyrat dhe kompetencat e përgjegjësit të departamentit si edhe ato të koordinatorit të Departamentit si personat që mbulojnë peshën kryesore në nivel të njësisë bazë për programin e studimit. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni | Institucioni ka vënë në dispozicion evidenca me të dhëna mbi marrëveshjet e bashkëpunimit[26] me Institute të Kulturës, Qëndra dhe Strehëza, Kopshte, Studio Psikologjike (në total 6 (gjashtë) Marrëveshje Bashkëpunimi) të cilat demostrojnë për marrëdhënie |

[24] Evidenca 1.3 Rregullore e Univesitetit Barleti, Nëntor 2022.
[25] Evidenca 1.2 Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit
[26] Evidenca 10.3 Marrëveshjet brenda vendit.

| | |
|---|---|
| vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | të vazhdueshme bashkëpunimi me aktorë të tjerë brenda vendit. Gjithashtu Insitucioni ka vënë në dispozicion të dhëna mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit (MoU)[27] që ka me 12 (dymbëdhjetë) Insitutcione homologe/Universitete jashtë vendit. Ndërkohë, Insitutcioni vë në dipozicion edhe një listë me marrëveshje dhe memorandiume bashkëpunimi[28] e cila nuk rezulton të ketë rëndësi në realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve për këtë program studimi për arsye se, së pari, Institucionet me të cilat është nënshkruar marrëveshja nuk përmbushin kushtin si institucione homologe dhe së dyti, me përjashtim të 13-të (trembëdhjetë) prej këtyre marrëveshjeve të nënshkruara në vitin 2022, pjesa tjetër janë më të hershme në raport me vitet gjatë të cilave është aktiv programi i studimit në shqyrëtim.<br><br>*Rekomandojmë njësinë bazë të bëj më shumë përpjekje për shtimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe që do t`i vinin në ndihmë objektivava specifik mësimor dhe formues.* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | Në funksion të realizimit të praktikave profesionale, bashkëpunimet dhe aktorët që Insitucioni vë në dispozicion dhe që demostrojnë realizimin e qëllimeve praktikuese, klinike, kërkimore-shkencore dhe të mobilitetit janë ato të lartë përmendurat dhe që parashikohen në Evidencën 10.3 dhe Evidnecën 10.2.<br>*Këto evidenca, sidomos ato të lidhura me marrëveshjet brenda vendit, nuk rezultojnë të mjaftueshme për plotësimin e të gjitha këtyre objektivave duke lënë ende hapësira me nevojë për t`u plotësuar me marrëveshje të tjera bashkëpunimi specifikisht me institucione, kompani apo klinika.*<br>*Rekomandohet gjerësisht departamenti të shtojë numirn e këtyre marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve brenda vendit.* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të | Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, ku ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në ``Psikologji Klinike`` harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. |

[27] Evidenca 10.2 Te dhena mbi marreveshjet e bashkepunimoit (MoU), mobilitetin e stafit dhe studenteve dhe marreveshjet ne kuader te projektit Erasmus +.
[28] Evidenca 21.1 Marreveshje dhe memorandume bashkepunimi.

<table>
<tr><td>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</td><td colspan="4">Këto të dhëna pasqyrohen në dokumentat e raporteve të punës vjetore të Departamentit[29][30]. Vlen për t`u theksuar fakti se, si pasojë e mungesës së pasqyrimit të dokumentacionit, si p.sh. mbledhjet e departamentit të shoqëruara me bllokun e procesverbaleve, apo edhe të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të programit, nuk mund të japim një përshkrim të qartë të nivelit të përfshirjes së studentëve. Në çdo rast, nga lista e bashkëpunimeve dhe takimet dhe bisedat e zhvilluara me stafin dhe studentët, evidentohen raste të tilla të realizimit të bashkëpunimeve.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Rregullorja e Universitetit "Barleti" përcakton organizimin dhe funksionimin e njësive të saj, duke garantuar koordinimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e programeve të studimit si Masteri i Shkencave në Psikologji Klinike.<br>Departamenti ka të nënshkruara gjashtë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet brenda vendit dhe dymbëdhjetë me universitete jashtë vendit, por ato nuk përmbushin plotësisht nevojat mësimore dhe formuese të programit.<br>Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit rekomandohet të zgjerojë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe, për të mbështetur më mirë objektivat e tij akademik.<br>Departamenti duhet të shtojë dokumentacionin dhe raportet për të siguruar një përfshirje më të qartë të studentëve në këto bashkëpunime.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

[29] Evidenca 28.2 Raporti i punes vjetore te departamentit 23-24.pdf
[30] Evidenca 28.1 Raporti i punes vjetore 2022 2023 DSHSSH.pdf

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master i Shkencave në `Psikologji Klinike` është hapur me urdhët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), nr 507, datë 06.09.2022. Programi është i regjistruar si program i ciklit të dytë master, Niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Programi ofrohet në gjyhën shqipe, me kohëzgjatje 2 vite akdamike si edhe realizohet në 120 kredite në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas sistemit Europian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve[31]. Ky program gjithashtu, është i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga VKM nr. 41, datë 21.01.2018 ``Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, dt. 24.01. 2018 ``Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL``, I ndryshuar[32]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i Studimit Master i Shkencave në `Psikologji Klinike`[33] ka për mision përgatitjen e psikologëve me orientim klinik duke u bazuar në objektiva, strukturë dhe përmbajtje që i pajisin studentët me aftësi të thelluara në njohuri dhe aftësi praktike, që i përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe i përgatit për marrjen e licencës së profesionit. Programi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë psikologët klinikë të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi specifike përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh klinike të lidhura me çrregullime të veçanta. Programi i studimit i jep studentëve njohuri themelore teorike dhe praktike duke përfshirë si lëndë të formimit bazë deri tek lëndët më të shtjelluara dhe më specifike të profesionit. Programi synon të aftësojë studentët për të zotëruar profesionin si në aspektin teorik ashtu edhe praktik, duke i pajisur me njohuri plotësuese në drejtime të veçanta sipas kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të cilat i marrin përmes lëndëve me zgjedhje. Studentët gjithashtu kanë mundësi të angazhohen në aktivitete extrakurrikulare nga një rrjet i gjerë shërbimesh studentore që ofrohen pranë Universitetit |

[31] Evidneca 3. Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike, Neni 2. Përshkrimi I programit dhe objekti.
[32] Evidenca 1. Strategji e Zhvillimit për programin e studimit Msc psikologji Klinike, fq 2-3.
[33] Evidenca 1. Strategji e Zhvillimit për programin e studimit Msc psikologji Klinike, fq 4-5.

| | |
|---|---|
| | Barleti. Studentët e Psikologjisë janë pjesë aktive e klubit të psikologëve me një sërë aktivitetesh që kanë në fokus përfshirjen e studentëve për të vënë në prkatikë njohuritë e fituara. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Në planin mësimor të programit të studimit janë të përcaktuara kreditet për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Studenti është i detyruar të ndjekë praktikën mësimore të parashikuar në planin mësimor dhe ti nënshtrohet të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve njëlloj si për të gjitha detyrimet e tjera. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve edhe `Paketën e Praktikës`[34] të cilën ata duhet ta plotësojnë dhe dorëzojnë ne departament përpara detyrimeve përmbyllëse. Për të fituar Diplomën Master i Shkencave në Psikologji Klinike studentët duhet të kenë siguruar 120 kredite[35]. Prova finale është në trajtën e punimit të diplomës. Në planin mësimor të programit të studimit gjenden respektivisht: praktika, me veprimtari formuese D dhe 12 ECTS dhe detyrimet përmbyllëse si veprimtari formuese E me 18 ECTS[36]. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi |

[34] Evidenca 1. Strategji e Zhvillimit për programin e studimit Msc psikologji Klinike, fq 3.
[35] Evidneca 3. Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike, Neni 12 Praktika, Neni 16 prova finale.
[36] Evidenca 2.1. Plan Mësimor MSH Psikologji Klinike.

| | |
|---|---|
| "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Kandidati që dëshiron të ndjekë programin e ciklit të dytë Master i Shkencave duhet të vërtetojë me dokumenta mbarimin e studimeve të ciklit të parë në një IAL brenda dhe jashtë vendit, të dëshmojë njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të bashkimit Europian sipas nivelit të përcaktuar në aktin nënligjor të Ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë si edhe të pranojë dhe të dëshmojë pagesën e tarifës së studimit. Të gjitha realiohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Neni 84 si edhe aktet rregullatore të Institucionit[37]. |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Institucioni është në pritje të akteve nënligjore të Ministrisë në vijim të VKM-së 310 datë 11.05.2022, për kodifikimin e programeve të studimit. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi |

[37] Evidneca 3. Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike, Neni 12 Praktika, Kreu V Pranimi i Studentëve, Neni 23 Kriteret e Pranimit, Neni 25 Dokumentacion Pranimi.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Programi Master i Shkencave në Psikologji Klinike, i licencuar nga Ministria e Arsimit në vitin 2022, është një program i ciklit të dytë që realizohet në 120 kredite dhe ofrohet në gjuhën shqipe për një periudhë prej dy vitesh akademike.*<br>*Programi ka për qëllim përgatitjen e psikologëve klinikë, duke u fokusuar në aftësitë teorike dhe praktike që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës, dhe përfshin detyrime të lidhura me praktikën profesionale dhe një punim diplome si pjesë përfundimtare.*<br>*Kandidatët që duan të ndjekin programin duhet të plotësojnë kriteret e përfundimit të ciklit të parë të studimeve, njohjes së një gjuhe të huaj dhe pagesës së tarifës, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Universiteti `Barleti`(UniBa) është institucion i arsimit të lartë jopublik i llojit Universitet i cili ofron veprimtari në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Në përputhje me ligjin Nr. 80, 2015 ``Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë``, ai është i licencuar me vendim nr. 571, datë 12.08. 2005 të Këshillit të Ministrave dhe ka një strukturë të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë, njësi ndihmëse-akademike dhe njësi administrative sipas përcaktimeve në statutin e këtij institucioni dhe bazuar në legjislacionin në fuqi.<br>Në Statutin[38] e këtij Institucioni gjenden të përcaktuara organet dhe autoritetet drejtuese të tij. Organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik dhe organet e tjera akademike janë Asambleja e Personelit Akademik dhe Komisionet e Përhershme. Organi më i lartë administrative është Bordi i Administrimit. Institucioni ka në përbërjen e tij edhe organet kolegjiale ku përfshihet Rektorati, Dekanti dhe Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta. |

[38] Evidenca 1.4, Statuti I IAL (Kreu III, Organizimi akademik dhe administrative i Universitetit Barleti, Neni 19.

| | |
|---|---|
| | Në strukturën e tij organizative ky Universitet është i përbërë nga katër fakultete:<br>• Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë<br>• Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit<br>• Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative<br>• Fakulteti i Shkencave Mjekësore<br>*Pavarësisht faktit se, në përbërjen e sturkturës orgaizative, Institucioni është në përputhje me legjislacionin në fuqi Neni 18 i ligjit nr. 80/2015 (duke respektuar kriterin e jo më pak se tre fakultete), duhet treguar më shumë kujdes në reflektimin e organizimit të strukturës në dokumentacionin përkatës. Më konkretisht, në bazë të po të njëjtit ligj, nr. 80/2015 (Neni 33 Statuti dhe rregullorja e isntitucioneve të arsimit të lartë) në Statut përcaktohen hollësisht organzimi dhe strukturat përbërëse të tij. Këto dy aspekte nuk gjenden të pasqyruara në këtë dokumentacion por vetëm në Rregulloren e Universitetit Barleti. Gjithashtu, përshkrimi në sturkturën e Fakulteteve në këtë rregullore (Neni 5, Fakultetet) si edhe organigrama bashkëgjitur Statutit duhet të azhornohen duke përfshirë katër fakultete e jo më tre sikurse rezulton në këto dokumenta të përmendur.*<br>Në përputhje me ligjin nr. 80/2015 (Neni 25 Departamenti) Departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore të Fakultetit i cili propozon kriteret e programit të studimit[39]. Sërisht, në Rregulloren e Univesitetit `Barleti` Fakultetit i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit është njësia kryesore e përbërë nga katër departamente:<br>• Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional<br>• Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve<br>• Departmenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit<br>• Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit<br>Departamenti i Shkencve të Sjelljes dhe shëndetit është përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Psikologji Klinike". Në përbërje të Departamentit janë 7 anëtarë me kontratë me kohë të plotë (për të dyja vitet akademike 2022-2023; 2023-2024) nga të cilët 1 është me titull Prof. Asoc. Dr, të paktën 4 janë me titull PhD/Dr. dhe në përputhje |

[39] Evidenca 1.1. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit ( Neni 5, Fakulteti).

<table>
<tr>
<td></td>
<td>me ligjin, i përkasin kategorisë ``Lektorë`` dhe staf me diplomë Master i Shkencave[40].<br>Të dhëna për Departamenti i Shkencve të Sjelljes dhe shëndetit:
<table>
<tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022 – 2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Dr./PhD.</td><td>4</td><td>8</td><td>5</td><td>9</td></tr>
<tr><td>Msc.</td><td>2</td><td>5</td><td>1</td><td>5</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>7</td><td>14</td><td>7</td><td>15</td></tr>
</table>
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</td>
<td>Sipas Rregullores së programit të studimit studenti duhet të zhvillojë praktikën mësimore të parashikuar në planin mësimor. Cituar Rregulloren e Programit MSH në Psikologji Klinike (Evidenca 3. Neni 12. Praktika), praktika zhvillohet në institucione, organizata dhe firma nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga departamenti.</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</td>
<td>Në rregulloren e Departamentit[41] parashikohet që Koordinatori i Departamentit të kryej edhe detyrën e Koordinsatorit të Programit/ Programeve të studimit që mbulon Departamenti. Sipas rregullores ka një sërë punësh të parashikuara që mbulohen prej tij/saj përfshirë koordinimin e punëve të brendëshme të departamentit dhe asistimin e përgjegjësit të departamentit. Sipas Vendimit nr. 24 datë 14/10/2022 `Për Emërimin në Detyrë të Koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit`[42] në këtë funksion është vendosur staf me diplomë masteri i shkencave që, për këtë program studimi, është gjithashtu përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. Nuk rezultojnë specifikime</td>
</tr>
</table>

[40] Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[41] Evidenca 1.2. Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe shëndetit, Neni 6 (Koordinatori i Departamentit)
[42] Evidenca 30. Për Emërim në Detyrë të Koordinatorit të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit

| | |
|---|---|
| | mbi përgjegjësitë e koordinatorit për ecurinë edhe të praktikave profesionale. Kjo, si në Rregulloren e Departamentit ashtu edhe në Paketën e Praktikës[43] |
| **Konkluzione** | *Universiteti Barleti (UniBa) është një institucion i arsimit të lartë jopublik që funksionon në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë në Shqipëri, me strukturë të organizuar në katër fakultete. Statuti dhe Rregullorja e institucionit përcaktojnë organet drejtuese dhe strukturën, por dokumentacioni i lidhur me organizimin dhe numrin e fakulteteve ka nevojë për përditësim. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit përfshin katër departamente, ku Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit është përgjegjës për programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Koordinatori i Departamentit ka detyra që përfshijnë organizimin e brendshëm dhe mbikëqyrjen e praktikës, megjithatë ka mungesë specifikimesh të qarta mbi përgjegjësitë e tij për praktikat profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, dhe në faqen zyrtare web të Universitetit ``Barleti``, në dritaren e pranimeve dhe të programeve të studimit master i shkencave gjendet sektori i Edukimit dhe Shkencave Sociale ku mund të merret informacion për programin e studimit Psikologji Klinike. Informacioni është i strukturuar në përshkrimin e programit, planin mësimor, karrierën, pranimin, tarifat dhe kalendarin akademik si edhe mund të aksesohet online në broshurën informuese për këtë program studimi. Sikurse citohet edhe në raportin e vlerësimit të brendëshëm: ` *Departamenti dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrative ka akses të plotë tek dokumentat rregulluese institucionale nëpërmjet sistemit intranet dhe nëpërmjet programeve të studimit, planeve mësimore,* |

[43] Evidenca 13.2. Paketa e Praktikës.

| | |
|---|---|
| | *syllabuseve, rregulloreve, dhe akteve të brendëshme rregullatoire të IAL`*<br>***Rekomandohet që, për lehtësi dhe korrektesë të aksesimit, në faqen zyrëtare web informacioni të jetë i azhornuar për vitin akademik 2023-2024 dhe i vendosur nën emërtesën e saktë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit si edhe broshura e programit të jetë e disponueshme edhe në dosjen e vetëvlerësimit dhe jo vetëm të jetë e aksesueshme online[44].*** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Nisur nga dosja e vetëvlerësimit për programin e studimit Master i Shkencave në `Psikologji Klinike` u konsultuan syllabuset e lëndëve[45] në të cilat gjenden informacionet mbi ngarkesën e mësimdhënies, orët brenda/jashtë auditorit, frekuentimin e lëndës, metodën për vlerësimin e njohurive, etj. Studentët njihen me syllabusin e lëndës gjatë ditës së parë të orës së mësimit.<br>Syllabusi paraqet ngarkesën e studentit (orë në auditor dhe jashtë auditorit) të ndarë sipas aktiviteteve specifike Leksion, Seminar, Praktikë, Projekte, Detyrë Kursi, etj.<br>Ngarkesa e kërkuar është në përputhje me ngarkesën e përllogaritur në kredite sipas raportit 25 orë/ECTS[46].<br>Lëndët janë të organizuara në 5, 6, 8, dhe 9 kredite dhe ndarja e orëve në auditor varion në varësi të ngarkesës në kredite, lirisë akademike por gjithnjë duke respektuar raportet mes orëve në auditor dhe punës individuale të studentit. Për shembull, nëse marrim rastin e lëndëve me 6 kredite, ky raport është 45 orë në auditor dhe 105 orë pune individuale.<br>Po ti referohemi seksionit të formave të kontrollit të dijeve, frekuentimi i lëndës duhet të jenë në masën të paktën 50% të seancave të leksioneve dhe 75% të seancave të ushtrimeve (dhe/ose seminareve/laboratoreve/praktikave) me qëllim që të lejohet marrja pjesë në provimin përfundimtar të lëndës. *Do të ishte mirë që ky informacion të ishte i paraqitur dhe në një Udhëzues të Studentit i cili t`i vihej në dispozicion studentëve në të gjitha nivelet. Vihet re që në dosjen e vetëvlerësimit ky dokument mungon (ka një Evidenca 11.1 Udhëzues për Metodat e mësimdhënies por që nuk reflekton këto informacione të nevojshme)*<br>Vlerësimi i njohurive të përvetësuara nga studentët bëhët sipas tabelës së më poshtme: |
| | |

[44] https://umb.edu.al/upload/stydiesbroshures/VOLANT-MSC-psikologji-klinike-upsh-23.pdf
[45] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve_Msc Klinike
[46] Evidenca 2.1. Plan mësimor MSH Psikologji Klinike

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>Komponentët e vlerësimit</td><td>Pesha (%)</td></tr>
<tr><td>Provimi i ndërmjetëm</td><td>20</td></tr>
<tr><td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Detyra e kursit</td><td>20</td></tr>
<tr><td>Porvimi Përfundimtar</td><td>50</td></tr>
<tr><td>TOTALI</td><td>100</td></tr>
</table>
Këto informacione specifike mbi vlerësimin e secilës lëndë jepen në syllabusin e lëndës.
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</td>
<td>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike u siguron studentëve informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.<br>Rekomandohet duke qenë praktikë e mirë që, në faqen zyrëtare të Internetit të Universitetit `Barleti`[47] të bëhen publike jo vetëm informacion i përgjithshëm mbi pranimet dhe tarifat për studentët por edhe rregulloret mbi trasferimet nga një program studimi në tjetrin brenda institucionit dhe transferimet nga një program studimi i një Universiteti tjetër në programin e studimiy të Universitetit `Barleti`.</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</td>
<td>Syllabuset e lëndëve në programin e studimit Master i shkencave në Psikologji Klinike[48] janë përgatitur sipas një formati standard dhe integrojnë elementët në vijim:
<ul>
<li>Emërtesa e lëndës</li>
<li>Ngarkesa e lëndës në kredite dhe orë</li>
<li>Semestri kur zhvillohet lënda</li>
<li>Përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit e detajuar në përmbledhjen e lëndës, rezultatet e të nxënit dhe metodat e mësimdhënies</li>
<li>Konceptet themelore</li>
<li>Tabela e integruar me sektorin e tematikës së lëndës, javët e zhvillimit të lëndës dhe të literaturës.</li>
<li>Format e kontrollit të dijeve e detajuar në frekuentim e lëndës, kontrollin e vazhdueshëm, tabelën e vlerësimit.</li>
<li>Literaturën bazë</li>
<li>Literaturën e rekomanduar</li>
</ul>
GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përmbajnë të gjithë elementët e nevojshmë për t`u pasqyruar në <u>to pavarësisht se, në disa</u></td>
</tr>
</table>

[47] `https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-psikologji-klinike.html
[48] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve_Msc Klinike

| | |
|---|---|
| | *syllabuse vihen re disa mangësi dhe mungesë azhornimesh në literatuë. GVJ rekomandon njësinë bazë që këto mangësi të merren parasysh duke i reflektuar në kohën e duhur këto ndryshime. Më konkretisht:*<br>*Në syllabusin e lëndëve si: metodat cilësore të kërkimit; trauma psikologjike: kuptimi dhe trajtimi 2022-2023; neuropsikologjia klinike 2024; literatura e vendosur përbri tematikës së lëndës, si për librin bazë ashtu edhe për librin e rekomanduar, duhet të paraqitet e plotë, jo vetëm me numrin e faqeve të referimit, por edhe me emrin e autorit/rëve, vitin e botimit, shtëpinë botuese. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që, sidomos literatura bazë, të jetë e azhornuar me botime/ribotime të pesë viteve e fundit. Gjenden raste syllabusesh ku literatura e rekomanduar është më e re se ajo bazë.*<br>*Në rastet kur lënda realizohet me leksione të përgatitura nga titullari/lektori i lëndës, përbri secilës tematikë që zhvillohet në çdo javë, tek literatura duhet të vendoset edhe titulli original i librit me autorin/rët, vitin, shtëpinë botuese dhe numrin e faqeve ku janë bazuar leksionet. Në rastin e programeve në nivelin master, literatura mund të qëndrojë edhe vetëm në gjuhën angleze. Rast për këtë mangësi janë syllabuset e lëndëve: psikopatoligji e fëmijës dhe adoleshentit 2022-2023; metodat cilësore të kërkimit 2024.*<br>*Ka syllabuse ku mungon tërësisht numri i faqeve të referimti për literaturën e çdo teme si në rastin: psikopatologjia e të rriturve 2022-2023;*<br>*Rekomandohet që në strukturimin e syllabusit të ndiqet shëmbulli i lëndës Psikologji klinike e avancuar 2024 apo lënda Psikopatologji e fëmijës dhe adoleshentit/Psikopatologjia e të rriturve 2024 ku literatura bazë është gjithashtu e azhornuar për pesë vitet e fundit.*<br>*Rekomandohet që lënda Çështje ligjore dhe etike të qëndrojë në syllabus sipas kësaj emërtese që ka në plan mësimor dhe sikurse është aktualisht: Çështje ligjore dhe etika profesionale e psikologut në shkollë. Ky program studimi është në psikologji klinike dhe nevojitet që të trajtojë gjerësisht çështjet etike të psikologut klinikist pa qënë nevojë të jetë i mbingarkuar me çështje të etikës së punonjësit social apo edhe ekskluzivisht të psikologut në shkolla.*<br>*U vu re një mangësi e syllabusit për lëndën e praktikës profesionale.*<br>*Në shqyrëtimin e syllabuseve të paraqitura nga institucioni për vitet 2022-2023 dhe 2024, titullarët e lëndëve janë personel akademik me së paku gradën shkencore `Doktor` ose PhD. Numri i lëndëve që kaanë titullarët me titull `Doktorë`/ PhD nuk i superon më shumë se dy për të dyja vitet. Titullarët e lëndëve me kohë të plotë (PAE)* |

| | |
|---|---|
| | *ende nuk janë në kuotat 70 % në raport me 30% të titullarëve të lëndëve me kohë të pjësshme (PAK).* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit si edhe në vizitën në institucion, sikurse edhe citohet nga grupi i vlerësimit të brendshëm në RVB: *`Sipas akteve nënligjore institucioni ka të drejtë të bëj ndryshime profilizuese deri në masën 20% pas akreditimit të programit, kështu që deri tani nuk ka patur ndryshime`.* Procedura e riorganizimit të një programi studimi është e përcaktuar në `Manuali i hartimit/ riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit`. Ashtu sikurse tregohen në këtë material, për riorganizimin e një programi ekzistues është njësia bazë e cila argumenton nevojën për përmirësim dhe përditësim të programit të studimit dhe pas konsultimit me Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, sipas modeleve në shtojcat bashkëngjitur këtij materiali, propozimet e bëra ia paraqet për miratim Dekanit. Dekani, pas aprovimit të kërkesës nga njësia bazë ia përcjell për miratim Senatit. Procedura dokumentohet sipas sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentacionit[49]. |
| **Konkluzione** | *Universiteti "Barleti" ofron informacione për programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike në faqen e tij zyrtare, ku përfshihet përshkrimi i programit, plani mësimor dhe detaje mbi karrierën, pranimin dhe tarifat. Ky informacion është i aksesueshëm në broshurat online.* *Dosja e vetëvlerësimit tregon që Departamenti dhe stafi akademik kanë qasje të plotë në dokumentacionin institucional përmes sistemit intranet dhe janë në dijeni për planin mësimor, syllabuset dhe rregulloret përkatëse.* *Programi kërkon që syllabuset të përfshijnë informacione të detajuara për ngarkesën në orë, metodën e vlerësimit dhe literaturën. Megjithatë, janë evidentuar mangësi dhe mungesë azhornimesh në disa syllabusë, sidomos në literaturën bazë.* *Vlerësimi i dijes së studentëve bëhet përmes një sistemi që përfshin provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, detyra kursi dhe pjesëmarrje aktive, me peshë të ndryshme për secilin komponent.* *Rekomandohet që Universiteti të ofrojë një Udhëzues të Studentit që përfshin të gjitha informacionet e nevojshme për kriteret e pranimit dhe rregulloret e transferimeve, duke përmirësuar qasjen dhe transparencën për studentët. Edhe pse syllabuset janë të* |

[49] Evidenca 15. Manuali i Hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe dhe vlerësimit të programeve të studimit (Kapitulli IV).

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *strukturuara dhe përmbajnë informacione të nevojshme për secilën lëndë, ka raste kur disa syllabuse nuk janë të azhornuara, veçanërisht për literaturën bazë, e cila duhet të jetë e përditësuar me botimet e pesë viteve të fundit. Në disa raste, syllabuset përmbajnë mangësi në përshkrimin e literaturës, ku mungon emri i plotë i autorëve, viti i botimit dhe shtëpia botuese. Një tjetër rekomandim është që të azhornohet syllabusi për praktikën profesionale, i cili aktualisht mungon. Programi Master i Shkencave në Psikologji Klinike gjithashtu duhet të përfshijë çështjet ligjore dhe etike të profesionit të psikologut klinik në një mënyrë më të gjerë, duke shmangur mbingarkesën me tematika që lidhen me profesionet e tjera, si p.sh., etika e punonjësit social apo psikologut në shkollë. Në përmbledhje, programi Master i Shkencave në Psikologji Klinike në Universitetin "Barleti" ofron një strukturë të mirëorganizuar.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Përmbajtja e lëndëve dhe praktika mësimore sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Nga ana e personelit akademik i kushtohet kujdes integrimit të aspekteve simuluese dhe praktike në lëndë që ndjejnë nevojën e ushtrimit praktik për të siguruar angazhimin sa më të plotë të studentëve dhe përfitimin maksimal nga ana e tyre. Praktika profesionale në vitin e fundit, me 12 kreditet e saj të përkthyera në 270 orë, shihet si një mundësi për t`u njohur dhe për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të hapur mundësinë e punësimit të tyre të ardhshëm[50]. *Në çdo rast, nisur nga evidencat e përcjella nga insititucioni mbi marrëveshjet e bashkëpunimit, rekomandohen më shumë përpjekje me qëllim rritjen e numrit të* |

[50] Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike

| | |
|---|---|
| | *marrëdhënieve me institucione dhe subjekte të tjera private që do të ngrenë numrin e bashkëpunimeve në këtë drejtim*[51]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semetra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit si edhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Më konkretisht, në këtë program studimi[52] veprimtaria mësimore shtrihet në dy vite akademike ose katër semetra, me kohëzgjatje 15 javë/semestër.<br>Janë respektuar kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.01.2018 ` Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë` në lidhje me shpërndarjen e veprimtarive formuese. Më konkretisht, vërehet se ka:<br>• 2 lëndë Bazë të kategorisë A me një total prej 12 kreditesh apo 10% të totalit të krediteve<br>• 7 lëndë karakterizuese të kategorisë B me 61 kredite ose rreth 51% të totalit të krediteve<br>• 3 lëndë ndërdisiplinore të kategorisë C me 17 kredite ose 14 % të totalit të krediteve<br>• 1 lëndë plotësuese e kategorisë D me 12 kredite ose 10% të totalit të krediteve<br>• Detyrimet përmbyllëse të kategorisë E me 18 kredite ose 15 % e totalit të krediteve<br>Gjithashtu, Përqindja totale e lëndëve të Kategorive A dhe B është 61% pra në përputhje me kriteret e kërkuara për rastin e programeve Master i Shkencave.<br>Lëndët e programit, edhe në varësi të specifikave, aplikojnë të gjitha seminare si edhe projekte dhe detyra kursi duke stimuluar studentin për kërkim shkencor duke prezantuar gjithashtu idetë e tyre. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky | GVJ gjatë vizitës në Institucion si edhe gjatë shyqëtimit të dokumentacionit dhe hulumtimit të ekspertëve, konstatoi se programi Master i Shkencave në Psikologji Klinike është në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS) duke patur një strukturë, lëndë dhe raport teori/praktikë si edhe ngarkesë në kredite në përputhje me profilin Master i Shkencave duke qenë gjithashtu i përafërt me programe të ngjashme në nivel ndërkombëtar. |

[51] Evidenca 10.3. Marrëveshjet brenda vendit
[52] Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike

| | |
|---|---|
| program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Nga të dhënat në planin mësimor[53] me përllogaritje rezultojnë 679 orë mësimore në auditor të ndara në:<br>- 450 orë leksione<br>- 209 orë seminare<br>- 20 orë projekte/detyra kursi<br>Ngarkesa në orë në auditor dhe orë pune e pavarur e studentit respekton raportin 1 kredit 25 orë mësimore/punë të studentit si edhe kriteret në pikat b) c) ç) d) të vendimit nr. 41, datë 24.01.2018 ` Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë`[54][55]. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktike mundësojnë arritjen e objektivave formues. Këto të fundit realizohen edhe nëpërmjet integrimit të aspekteve teorike të informacionit me aplikimet praktike ashtu sikurse u konfirmua dhe u vu re gjatë vizitës në intitucion. Ngritja e këtij programi studimi duke marrë edhe nga eksperiencat ndërkombëtare është bërë me qëllim rritjen e mundësive për trasferim mobilitet dhe punësim të studentëve edhe jashtë vendit në përfundim të studimeve të tyre. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Bazuar në dosjen e vetëvlerësimti si edhe duke analizuar syllabuset e lëndëve[56] të ofruara vihet re që janë të standardizuara dhe në përputhje me vendimet ligjore. Personeli akademik i njësisë bazë dëshmon se tregohet kujdes që syllabuset të rishikohen çdo fillim viti nga titullari apo pedagogu i lëndës, të konsultohen midis anëtarëve dhe janë të gjithë të miratuar nga përgjegjësi i departamentit[57].<br>*Vihet re në çdo rast, që literatura bazë dhe ajo e rekomanduar me përjashtim të disa praktikave të mira të vena në dukje për disa syllabuse në veçanti, në pjesën tjetër ka nevojë të jetë më e azhornuar me literaturën e viteve të fundit, aq më tepër që, në rastin e një programi master i shkencave lind e drejta që me studentët të punohet dhe me literaturë bazë në gjyhën angleze.* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, | Programi i studimit[58] Master i Shkencave në Psikologji Klinike synon përvetësimin nga ana e studentëve të koncepteve bazë, proceseve themelore sikurse janë njohja me etapat e zhvillimit, |

[53] Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike
[54] RVB_Msc. Psikologji Klinike (Aneks Tabelat Përmbledhëse, tabela 13)
[55] Evidenca 4. Studim Periodik i tregut për programin Msc. Psikologji Klinike, fq 2-3.
[56] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve
[57] Evidenca 28.1 Raport i punës vjetore të departamentit 22-23.
[58] Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike

| | |
|---|---|
| aftësive dhe kompetencave të synuara. | ndikimi i proceseve social-psikologjike, ashtu edhe të ndërlidhjes mes disiplinave dhe formit të specializuar. Ky i fundit reflektohet në lëndë specifike[59] si Psikopatologjitë e fëmijëve dhe adoleshentëve, Trauma, Kuptimi dhe Trajtimi, Këshillim Individual dhe në Grup, Psikopatologjitë e të rriturve, etj.<br>Qëllimet dhe objektivat janë të shprehura në lëndët e këtij programi duke siguruar përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara[60]. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Duke analizuar dosjen e vetëvlerësimit, përmbajtjen e programit të studimit[61], GVJ mendon se përmbajtja e programit të studimit në përgjithësi promovon mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me prirjet dhe kërkesat e tregut të punës[62]. Në këtë kuadër, institucioni ka në shërbim rrjetin e shërbimeve studentore i cili drejtohet nga Zv. Rektori për çështjet studentore, ku një nga detyrat kryesore është orientimi i funksionimit të Zyrës së Alumni dhe Karriera. Kjo zyrë, duke shfrytëzuar maksimalisht mundësitë dhe potencialet që ofron, sikurse janë organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura, bashkëpunimi me inisiativat sipërmarrëse të grupit Barleti, organizimit të vizitave studentore në instutucione publike dhe private, në kombinim me përmbajtjen e programit, mundësojnë punësimin e studentëve në përputhje me kërkesat/nevojat e tregut. *Në çdo rast, GVJ vazhdon të rekomandojë gjerësisht njësinë bazë që të risë përpjekjet për vendosjen e sa më shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit[63] me institucionet në vend me qëllim që të lehtësojë funksionimin e Zyrës së Alumnit dhe Karrierës. Të gjitha këto do të mundësonin ballafaqim e studentëve me tregun e punës përmes hapësirave për realizimin e trajnimeve, seminareve, praktikave profesionale ashtu sikurse të gjitha këto parashikohen nga programet e lëndëve të këtij programi studimi. Pa këto marrëveshje bashkëpunimi, të gjitha këto nuk do të ishin të mundura.* |
| **Konkluzione** | *Përmbajtja e lëndëve dhe praktika mësimore në programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike në Universitetin "Barleti" synon të sigurojë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për punësimin e studentëve. Personeli akademik i kushton një kujdes të veçantë integrimit të elementeve praktike dhe simuluese, sidomos në* |

[59] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve
[60] Evidenca 4. Studim Periodik i tregut për programin Msc. Psikologji Klinike, fq 2-3; fq 6-7.
[61] Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike
[62] Evidenca 4. Studim Periodik i tregut për programin Msc. Psikologji Klinike, fq 2-3; fq 8-11.
[63] Evidenca 10.3. Marrëveshjet brenda vendit

| | |
|---|---|
| | *lëndët që kërkojnë ushtrim praktik, duke rritur angazhimin e studentëve dhe duke siguruar përfitim maksimal nga ana e tyre. Megjithatë, GVJ rekomandon që institucioni të përpiqet të zgjerojë numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe subjekte të tjera private, për të rritur mundësitë për studentët në drejtim të praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit.*<br>*Në lidhje me përmbajtjen e lëndëve, GVJ vëren se syllabuset e lëndëve janë standardizuar dhe në përputhje me legjislacionin, por ka nevojë për përmirësime në literaturën bazë, e cila duhet të jetë më e azhornuar dhe të përfshijë më shumë literatura bashkëkohore edhe në gjuhën angleze, për një program Master i Shkencave. Disa syllabuse, tregojnë kujdes në përzgjedhjen e përmbajtjes, por kërkohet azhornim për të tjerat.*<br>*Përmbajtja e programit promovon mundësi të mëtejshme për studim dhe punësim, në përputhje me prirjet e tregut të punës. Zyrat e Alumni dhe Karrierës, e drejtuar nga Zv. Rektori për Çështjet Studentore, organizon leksione dhe seminare të hapura si dhe vizita studentore në institucionet publike dhe private. Këto aktivitete ndihmojnë në punësimin e studentëve, por GVJ rekomandon përpjekje të mëtejshme për zgjerimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për të krijuar mundësi të reja në tregun e punës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin | Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës një politikë institucionale e shprehur në nivel Departamenti është Bordi i karrierës[64]. Ky bord është i përbërë nga anëtarë nga tregu i punës si edhe nga Alumni Barleti me qëllimin përveç të tjerash, përmirësimin e kurrikulës dhe programit mësimor me kërkesat e tregut të punës. Sikurse vihet re në Vendimin e Bordit të Karrierës, ky bord ka në përbërjen e tij si anëtarë përfaqësues nga institucione |

[64] Evidenca 29 Vendim Bordi i Karrierës

| | |
|---|---|
| parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | të rëndësishme në fushën e psikologjisë, sektorin social në përgjithësi dhe universitetit të cilët kanë si funksion specific promovimin e lidhjes me tregun e punës[65]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Institucioni konsultohet me studentët e diplomuar nëpërmjet njësisë `Alumni dhe Karriera`, me anë të kontakteve të vazhdueshme që ka me të diplomuarit gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, edhe vlerësimi i secilës lëndë nga studenti[66], është një instrument dhe feedback i mirë nga ana e studentit mbi ecurinë dhe vlerësimin e tyre mbi lëndët nga të cilat është i përbërë ky program studimi. *Kjo duhet të paqyrohet dhe në fokus grupet me studnetët nëse kjo nuk bëhët ende.* Ndërkohë, pjesëmarrja e studentëve Alumni në mbledhjet e departamentit, me qëllim përfshirjen e tyre në diskutime për të ndarë opinione në lidhje me literaturën, metodën didaktike dhe nevojat e tyre gjatë kohës së ushtrimit të profesionit, ashtu sikurse theksohet në RVJ është një politikë shumë e mirë e cila nga *GVJ rekomandohet të faktohet me dokumenta dhe raporte të punës së departamenti të cilat aktualisht mungojnë*[67] |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | GVJ konstatoi se Departmenti ka të ngritur me vendim Bordin e Karrierës[68] që ka në përbërjen e tij anëtarë nga një rrjet bashkëpunëtorësh përfaqësues të institucioneve me rëndësi në sferën sociale përfshirë këtu edhe Urdhrin e Psikologut. Sikurse theksohet në Vendimin e Bordit të Karrierës qëllimi i tij është përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatja me kërkesat e tregur të punës.<br>Sikurse theksohet në RVB: `*së fundimi departamenti po aplikon për njohjen e programit Bachelor në Psikologji në Eurospy dhe për këtë qëllim, një grup pune po përgatit dosjen e aplikimit dhe po ndjek procedurat në vazhdim deri në finalizimin e njohjes së diplomës Master dhe në vazhdim*`. *GVJ do të kishte dashur që këto të dhëna të rëndësishme të faktoheshin me dokumentacionin përkatës i cili aktualisht mungon.* |
| **Konkluzione** | *Bordi i Karrierës, i përbërë nga përfaqësues të tregut të punës dhe Alumni të Universitetit ``Barleti``, ka një rol kyç në përshtatjen e kurrikulës dhe programit me kërkesat e tregut të punës. Institucioni angazhohet në konsultime të vazhdueshme me studentët e diplomuar përmes njësisë Alumni dhe Karriera dhe vlerësimit të lëndëve nga* |

[65] Evidenca 19.1 Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative.
[66] Evidenca 11.2 Formularë vlerësimi i studentëve për lëndët.
[67] Evidenca 19.1 Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative
[68] Evidenca 29 Vendim Bordi i Karrierës

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *studentët, për të përmirësuar përmbajtjen e programit. Pjesëmarrja e studentëve Alumni në mbledhjet e departamentit është një praktikë e mirw, megjithëse ende nuk faktohet me dokumente. Departamenti po synon njohjen ndërkombëtare të diplomave përmes Europsy, një proces që kërkon transparencë dhe dokumentim.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | GVJ konstatoi se një ndër shtyllat kryesore në të cilat mbështetet aktiviteti i UniBa[69] është kërkimi i aplikur dhe inovacioni duke sjellë kështu në fokus, për programin e studimit master i shkencave në Psikologji Klinike, si objektivë kryesorë[70] veprimtarinë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuar, inovacionin dhe projektet në fusha që kanë përputhshmëri në këtë drejtim. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Veprimtaria e njësive kryesore/bazë të UniBa rregullohet me rregulloret përkatëse të brendëshme që hartohen dhe miratohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe statutin e institucionit duke njohur lirinë akademike dhe autonominë organizative.<br>Gjithashtu, njësia Kryesore që është Fakulteti i shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit bashkërendon dhe administron veprimtarinë kërkimore ose artistike duke respektuar lirinë akademike të përsonelit[71]. Kjo njësi kryesore, nisur nga vetë natyra e saj, zhvillon aktivitete të karakterit artistik dhe rekreativ, si edhe të tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor[72][73]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, | Programi i studimit nxit dhe motivon personelin akademik dhe studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete kërkimore[74]. Kjo realizohet në disa mënyra: personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi është i angazhuar në veprimtari kërkimore me natyrë shkencore dhe |

[69] Evidenca 1.4 Statuti I Universitetit ''Barleti'' 2020, KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 6, Shtyllat kryesore.
[70] Evidenca 3. Rregullore e Programit MSh në psikologji Klinike, Tiranë 2022, KREU I, Dispozita e Pëgjithshme, Neni 3, Objektivat e programit të studimit.
[71] Evidenca 6. Dëshmi e respektimit të autoniomisë dhe lirisë akademike dhe finaciare.
[72] Evidenca 28.1 Raporti i punës vjetore 2022 2023 DSHSSH
[73] Evidenca 28.2 Raporti i punës vjetore të Departamentit 23-24
[74] Evidenca 13. Pjesëmarrja në konferencë e organizuar nga UniBa për stafin e angazhuar

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| projekte dhe aktivitete kërkimore. | aplikative[75]. Gjithashtu, si pjesë e veprimtarisë mësimore është dhe puna kërkimore e studentëve e cila realizohet përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet realizimit të detyrave të kursit dhe projekteve studimore, me kërkim në terren dhe ministudime. Pedagogët motivojnë studentët të hulumtojnë mbi tema të ndryshme të interesit dhe të kërkojnë mbi metodën më të përshatshme të hulumtimit[76][77]. *GVJ rekomandon në çdo rast, më shumë përpjekje dhe evidenca të përfshirjes në veprimtari kërkimore shkencore dhe aplikative të konceptuara për studentët e këtij programi studimi apo edhe në bashkëpunim me stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi.* | | | |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | GVJ mbi bazën e dosjes së vetëvlerësimit të vënë në dispozicion, konstatoi se në UniBa, administrimi i të ardhurave për aktivitetet apo projektet kërkimore realizohet në nivel institucional. Këto aktivitete ndiqen dhe kontrollohen ng Administratori për të gjitha strukturat në varësi të tij[78].<br>Për realizimin e aktiviteteve me karakter studimor, kërkimor dhe shkencor, njësia bazë ose Departamenti mbështetet financiarisht nga institucioni[79][80]. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se një nga shtyllat kryesore të UniBa është kërkimi i aplikuar dhe inovacioni, me fokus veprimtarinë kërkimore shkencore dhe aplikative për programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Njësia bazë mbështet veprimtarinë kërkimore të personelit dhe studentëve, duke promovuar projekte dhe studime kërkimore. GVJ rekomandon më shumë përfshirje dhe evidencë të aktiviteteve kërkimore për studentët, në bashkëpunim me stafin akademik. Administrimi i të ardhurave për projektet kërkimore realizohet në nivel institucional dhe kontrollohet nga administratori. Mbështetja financiare për aktivitetet kërkimore sigurohet nga institucioni.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

[75] Evidenca 11. Databaze i punës kërkimore të stafit 2022-2023; 2023-2024
[76] Evidenca 28.2 Raporti i punës vjetore të Departamentit 23-24
[77] Evidenca 33. Raporti Kërkimit Shkencor 22-33
[78] Evidenca 6. Dëshmi e respektimit të autoniomisë dhe lirisë akademike dhe finaciare.
[79] Evidenca 28.1 Raporti i punës vjetore 2022 2023 DSHSSH
[80] Evidenca 28.2 Raporti i punës vjetore të Departamentit 23-24

| Standardi II.7<br>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe vizita në Institucion konstatoi se njësitë përgjegjëse dhe njësia bazë, pavarësisht projekteve kërkimore shkencore dhe sigurimit të bashkëpunimeve me strukturat kërkimore që ka ndërmarrë dhe ndërmerr, ashtu siç theksohet në RVJ, nëpërmjet njësive të ndryshme sikurse është `BRIDGE`[81][82], *duhet të reflektojë me evidenca realizimin nëpërmjet tyre të objektivave për programin e studimit në shyqërtim.* Sikurse theksohet në dokumentacion, një prej objektivave parësore në nivel Departamenti është monitorimi dhe mbështetja e aktivitetit kërkimor-shkencor të stafit. Në këtë kuadër, fokusi është ndërtimi i networkut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në prizmin e mbështetjes dhe bashkëpunimeve në kuadër të kërkimit shkencor. *Në fakt mbështetja që rezulton është kryesisht ajo që njësia i jep anëtarëve të vetë në pjesëmarrjen në konferencën ndërkomëbrare sikurse është ajo IEREK. Në lidhje me grup-lëndët nga GVJ rekomandohet të merren masa që të funksioni dhe organizimin i kësaj strukuture të rëndesishme të pasqyrohen në rregulloret e njësive kryesore dhe njësisë bazë pasi vihen re mangësi të qënësishme në këtë drejtim. Njësitë njohin dhe kanë ngritur Bordet e karrierës por nuk rezultojnë grup-lëndë dhe pedagogë përgjegjës për to.* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe vizita në Institucion konstatoi se njësia përgjegjëse i është përgjigjur kërkesës për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor vetëm në një aktivitet ku edhe është angazhuar personel akademik i saj. Projekti ERASMUS+ si edhe bashkëpunimi me Universitetin South Bohemia[83] në të cilin janë të përfshirë 9 personel akademik që ka kryer/kryen mobilitet dhe 6 studentë ku vetëm njëri është nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit por jo nga programi i studimit Msc në Psikologji Klinike. *GVJ konstatoi se, mungojnë evidencat për vitin e përfshirjes në* |

[81] Evidenca 28.1 Raporti i punës vjetore 2022 2023 DSHSSH
[82] Evidenca 28.2 Raporti i punës vjetore të Departamentit 23-24
[83] Evidenca 10.2 Te dhena mbi marreveshjet e bashkepunimoit (MoU), mobilitetin e stafit dhe studenteve dhe marreveshjet ne kuader te projektit Erasmus +.pdf

| | |
|---|---|
| | *projektin ERASMUS+ si edhe vitin e fillimit dhe mbarimit të bashkëpunimit me Universitetin South Bohemia me qëllim vlerësimin dhe përputhshmërinë me kohën e hapjes së programit të studimit në shqyrëtim.* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe vizita në Institucion konstatoi se, *konferenca ndërkombëtare shkencore Urban Regeneration and Sustainability zhvilluar në dhjetor të 2022*[84]*, e cila është bashkëngjitur si referencë, nuk është evidencë e vlefshme për angazhimin e personelit dhe të studentëve në studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor sepse, jo vetëm që nuk është e organizuar nga kjo njësi bazë por edhe, nga të dhënat, nuk rezulton të ketë pjesëmarrje të stafit dhe studentëve nga ky program studimi dhe/ose njësi përgjegjëse.Konferenca International Scientific Conference `Science for Youth` 27-28 Maj 2022, e cila evidenton përfshirjen e stafit akademik të kësaj njësie përgjegjëse, është zhvilluar më përpara periudhës së nisjes së aktivitetit të programit të studimit në shqyrëtim ndaj nuk mund të konsiderohet si evidencë e vlefshme.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit konstatoi se në studimin periodik të tregut për programin Msc. Psikologji Klinike janë të shprehura arsyet pse ky program studimi ofron mundësitë për profesionist konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës[85].<br>-Programi i studimit mbështet në objektiva të përcaktuara qartë duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri si edhe duke gërshetuar praktikat e mira të vendeve europiane[86].<br>-Modelet e kurrikulave që janë ndjekur si shembull për hartimin e tij janë mbështetur në universitetet ndërkombëtare, sikurse janë Universiteti i La Sapiencës, Universiteti Sheffield, Universiteti Clemnson, Universiteti i Minessotës dhe duke ofruar një ndërlidhje të disiplinave me një gamë të gjerë të specializuar.<br>-Nisur nga kjo analizë tregu[87], e bazuar në të dhëna të ardhura nga analiza e institucioneve të arsimit të lartë si edhe studime të publikuara nga institucione dhe OJF të ndryshme, rrezulton se tregu i punës ka ende nevoja të papërmbushura për të tillë profesionist nisur edhe nga reformat e ndërmarra, planet e veprimit në fushëm e |

[84] Evidenca 13. Pjesmarrja ne konference e organizuar nga Uniba per stafin e nagazhuar.pdf
[85] Evidenca 1 Startegji e Zhvillimit për programin e Studimit Msc Psikologji Klinike.pdf
[86] Evidenca 5.2 Strategjia e zhvillimit të departamentit 2022-2025.pdf
[87] Evidenca 4 Studim periodik i tregut per programin Msc. Psikologji klinike.pdf

| | |
|---|---|
| | shërbimeve të shëndetit mendor, nevojat e shtuara të diktuara pas periudhës së pandemisë.<br>-Institucioni demostron se i ka struktuarat ne dispozicion të studentëve, burimet financiare dhe mbështetjen me projekte të Grupit Barleti për të realizuar denjësisht objektivin për të tillë profesionistë konkurues. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe vizita në Institucion konstatoi se, në ndryshim nga çfarë pranohet për këtë kriter në RVB, ky I fundit jo vetëm që aplikohet plotësisht për këtë program por edhe është përbushur prej tij për fazën që i takon procesit të vlerësimit. Njësia përgjegjëse ka ngritur struktura të posaçme brenda të cilave merr në konsideratë rekomandimet e Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë. Ashtu sikurse theksohet në strategjinë e zhvillimit të departamentit[88][89] dhe sikurse evidentohet në vendimin e bordit të karrirës[90]:<br>*``Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit ka themeluar tashmë Bordin e Karrierës, një sturkturë kyçe, për ndërlidhjen e Universitetit me tregun e punës duke përfshirë Urdhrin e Psikologut…``.*<br>Gjithashtu, në dokumentin e dorëzuar të studimit periodik të tregut të punës[91], institucioni dhe njësia përgjegjëse e njeh profesionin e rregulluar të psikologut, referon të dhëna mbi regjistrim e psikologëve që vijnë nga Urdhri i psikogut dhe e parashtron programin Msc. në Psikologji Klinike si potencialisht të përshtatshëm për të ofruar profesionist që kanë kompetencat e nevojshme, pra të aftë të marrin licencën përkatëse që do t`i mundësojë ushtrimin e profesionit për të përmbush nevojat e tregut të punës. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional* | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit konstatoi se, programi i studimit në shqyërtim është i regjistruar si program i ciklit të dytë Master, Niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve[92]. Ky program organizohet sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga VKM nr. 41, dt. 21.01.2018 ``Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL dhe VKM nr. 185, dt. 25.03.2021 ``Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, dt. 21.01.2018 ``Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL `` i |

[88] Evidenca 5.2 Strategjia e zhvillimit të departamentit 2022-2025.pdf
[89] Evidenca 1 Startegji e Zhvillimit për programin e Studimit Msc Psikologji Klinike.pdf
[90] Evidenca 29 Vendim Bordi i Karrieres.pdf
[91] Evidenca 4 Studim periodik i tregut per programin Msc. Psikologji klinike.pdf
[92] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf

| | |
|---|---|
| *QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | ndryshuar[93]. Lëndët e këtij programi, ashtu sikurse pasqyrohet në planin mësimor[94], janë të ndara në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Programi është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve. Për të gjitha këto aspekte të lartëpërmendura, ky program studimi plotëson kriterin b) të Nenit 7 për kriteret e anëtarësisë (Kreu III Kriteret e Anëtarësisë) në Ligjit nr. 40/2016 ``Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë``. Së fundimi, ky program studimi i është nënshtruar aplikimit për Certifikimin Ndërkombëtar Europsy si standardi më i lartë Europian në edukim, trajnim dhe kompetenca profesionale i përcaktur nga European Federation of PsychologistsAssociations (EEPA)[95]. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse, pavarësisht projekteve kërkimore dhe bashkëpunimeve të ndërmarra, siç është BRIDGE, duhet të demonstrojnë realizimin e objektivave të programit të studimit. Një nga objektivat kryesorë është monitorimi i aktivitetit kërkimor-shkencor, duke ndihmuar në ndërtimin e një rrjeti në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*<br>*Rekomandimi i GVJ është që të pasqyrohen në rregulloren e njësisë organizimi dhe funksionimi i strukturave si Bordi i Karrierës. Angazhimi në projekte si ERASMUS+ dhe bashkëpunimi me Universitetin South Bohemia tregojnë nevojën për më shumë evidenca dhe detaje për periudhën e përfshirjes.*<br>*Konferencat si Urban Regeneration and Sustainability dhe Science for Youth nuk ofrojnë evidenca të vlefshme për përfshirjen e stafit dhe studentëve, duke mos qenë të organizuara nga njësia bazë e programit.*<br>*Në lidhje me tregun e punës, programi i studimit ofron mundësi për profesionistë konkurrues dhe është mbështetur në modele kurrikulare ndërkombëtare, duke e nxjerrë në pah nevojën për profesionistë në shëndetin mendor.*<br>*GVJ vlerëson se ky program është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe legjislacionin në fuqi.* |

[93] Evidenca 1 Startegji e Zhvillimit për programin e Studimit Msc Psikologji Klinike.pdf
[94] Evidenca. 2.1 Plan Mesimor MSH Psikologji Klinike.pdf
[95] Evidenca 4 Studim periodik i tregut per programin Msc. Psikologji klinike.pdf

| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve dhe njohurive janë leksionet, seminaret, projekte, detyra kursi dhe praktika profesionale. Në hartimin e planit mësimor[96] dhe syllabuseve të lëndëve ky program studimi është bazuar dhe ka ndjekur manualin e hartimit të programit të studimit dhe ndryshimin e programeve ekzistuese[97] sipas së cilit, krijimi i planeve mësimore dhe përditësimi i atyre ekzistuese, në lidhje me shpërndarjen e lëndëve bëhet sipas komponentëve mësimor të përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" ndryshuar me VKM Nr 879, datë 18.12.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".<br>Llogaritja e krediteve të disiplinave mësimore, sipas veprimtarive formuese zhvillohet sipas një skeme e cila krijon hapësirën e nevojshme për realizimin e vlerësimit të vazhduar, duke rritur peshën e aktiviteteve apo detyrave që studenti zhvillon në mënyrë |

[96] Evidenca 2.1 Plan Mesimor MSH Psikologji Klinike.pdf
[97] https://umb.edu.al/upload/pdf/Manuali-i-hartimit-te-kurrikulave.pdf





| | |
|---|---|
| | të pavarur gjatë semestrit dhe duke ulur peshën e vlerësimit përfundimtar.<br>Institucioni dhe programi i studimit në shqyrëtim ndjekin një rregull të përgjithshëm sipas së cilit, për çdo lëndë, pesha e krediteve për orë leksionesh është 50%. 1 ECTS leksione, konvertohet në 10 orë në auditor dhe 15 orë studim individual. Në rastet e lëndëve teorike, 33% e krediteve caktohen orë seminaresh. Në varësi të objektivave të lëndës dhe kompetencave që duhet të arrijnë studentët, logaritja e orëve për kredite bëhet si më poshtë:<br>- 1 kredit = 7 orë seminare dhe 18 orë studim individual<br>Në fund, është parashikur që 17% e krediteve të jetë për projekte dhe detyra kursi. Pesha e krediteve për praktikë profesionale dhe provën finale është përcaktuar sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018.<br>Modeli i syllabusit të lëndës është i përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.41, datë 24.01.2018. Në syllabusin e lëndës[98] përcaktohen objektivat e lëndës/modulit dhe temat dhe aktivtetet mësimore që do të realizohen për arrijen e tyre dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Në syllabus reflektohen aktivitetet mësimore që justifikojnë ngarkesën e orëve mësimore të caktuara në planin mësimor.<br>Metoda e vlerësimit është e shprehur qartë në syllabusin e çdo lënde duke u përbërë nga komponetët e provimit të ndërmjetëm, 20% të totalit të vlerësimit, pjesëmarrja dhe aktivizimi me peshë 10%, detyra e kursit me peshë 20% dhe provimi përfundimtar me peshë 50% të totalit të vlerësimit. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik është i kujdesshëm që të monitorojë dhe të trajtojë me kujdes kërkesat e studentëve. Nga studentët ka vlerësime të mira duke shprehur se kjo i ka ndihmuar më së miri në përvetësimin e njohurive të ofruara nga ky program studimi. Në këtë program mënyra e mësimdhënies përfshin pjesën teorike si edhe seminare apo aspekte praktike ashtu sikurse parashtrohen në syllabus. Materialer mësimore gjenden në formën e librave fizik në bibliotekë por më së shumëti ato përcillen me email nga lektori i lëndës individualisht tek secili studentë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe | Institucioni tregon se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat akademike. Çdo lektor inkurajohet në përditësimin e kompetencave të tij didaktike duke u angazhuar në |

[98] Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve_Msc. Klinike.pdf

| | |
|---|---|
| në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | aktivitete të lidhura me këtë qëllim të organizuara nga institucioni dhe më gjerë.<br>Gjatë vizitës së GVJ rezulton se institucioni ka përditësuar infrastrukturën me teknologji bashkëkohore dhe laboratorë të cilat janë jo vetëm të aksesueshme por edhe i vijnë më afër përdorimit të teknologjisë për mësimdhënie si për pedagogët ashtu edhe për studentët. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit, vizita në institucion dhe takimi i zhvilluar me studentët e këtij programi studimi konstatoi se, në përgjithësi, të gjithë ata që janë të angazhuar në mësimdhënie[99] janë kompetentë në njohuri, koncepte dhe mësimdhënie, mbajnë të gjithë gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe një prej tyre Prof. Asoc.Dr dhe kanë eksperiencën e duhur në fushën e psikologjisë klinike[100]. Personeli përdor metodën interaktive e në përputhje me tematikën e lëndës.<br>Në përgjithësi personeli akademik i jep rëdësi të veçantë jo vetëm metodës tradicionale të mësimdhënies por kyesisht interaktivitetit gjatë procesit mësimor duke i dhënë rëndësi punës praktike, projekteve, simulimeve, punës në grup, etj. Ata i japin rëndësi kështu zhvillimit të individualitetit dhe të shprehurit korrekt dhe me profesionalizëm. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Njësitë përgjegjëse bëjnë vlerësimin e tyre dhe parashikojnë përmirësimin e metodave të mësimdhënies[101] nëpërmjet raportit të vlerësimit të studentëve për lëndën, i përpiluar nga Njësia e Cilësisë dhe Zhvillimit Kurrikular[102][103], i cili i vihet në dispozicion departmentit dhe rezultatet i dërgohen më pas lektorëve. Në takimin me studentët u konstatua se ky mekanizëm kishte funksionuar duke bërë që stili i mësimdhënies të kënaq nevojat e tyre. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e | Institucioni, nëpërmjet formularit të vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti i zhvilluar nga Njësia e Cilësisë dhe Zhvillimit Kurrikular dhe vlerësimit të mësimdhënies kolegë më kolegë[104] vlerëson dhe përditëson sistematikisht metodologjinë e |

[99] Evidenca 32 Cv te stafit akademik.pdf
[100] Evidenca 4. Lista e plote e stafit akademik qe jep mesim ne kete program studimi.pdf
[101] Evidenca 7 Shembull tip i plotësimit të formularit të vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti.pdf
[102] Evidenca 9. Raport i përpiluar nga zyra NJZKC mbi vleresimit te studenteve per v.a 2022-2023, sem I.pdf
[103] Evidenca 9.1 Raport i përpiluar nga zyra NJZKC mbi vleresimit te studenteve v.a 2022-2023, sem II.pdf
[104] Evidenca 8 shembull tip i plotesimit te formularit e vleresimit koleg per koleg (peer to peer).pdf

| | |
|---|---|
| vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | mësimdhënies. Nëpërmjet rezultateve të këtij procesi dhe koordinimit të punës me njësitë përgjegjëse, ka rezultuar e përshtatshme orientimi i mësimdhënies drejtë elementit praktik duke integruar elemente të tilla si: projektet, rastet studimore, shembujt praktikë që nga njëra anë nxisin autonominë kërkuese të studentit nga ana tjetër i krijojnë atyre një mbjent të përshtatshëm duke i ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre përpara aplikimit të profesionit në jetën reale. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit është i strukturuar në mënyrë të tillë që përfshinë leksione, seminare, projekte dhe praktikë profesionale, sipas rregullave të përcaktuara nga VKM-të përkatëse.*<br>*Llogaritja e krediteve të disiplinave mësimore është e organizuar për të lehtësuar vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve, duke i dhënë peshë sa aktiviteteve të tyre individuale ashtu edhe provimit përfundimtare.*<br>*Syllabuset për çdo lëndë përcaktojnë objektivat, temat, aktivitetet mësimore dhe metodat e vlerësimit, duke garantuar një qasje të qartë dhe të strukturuar për arritjen e kompetencave të pritura nga studentët.*<br>*Personeli akademik është i kualifikuar dhe përdor metoda interaktive të mësimdhënies, duke theksuar rëndësinë e praktikës dhe angazhimit të studentëve në procesin mësimor.*<br>*Institucioni angazhohet për përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës dhe metodave të mësimdhënies, duke u bazuar në vlerësimet e studentëve dhe rekomandimet nga njësitë përgjegjëse për cilësinë dhe zhvillimin kurrikular.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2** |
|---|

| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit, vizita në institucion dhe takimi i zhvilluar me studentët dhe stafin akademik në këtë institucion, konstatoi se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve, etj përcktohen në Rregulloret përkatëse si edhe janë të bëra publike dhe të njohura nga studentët.<br>Përkatësisht në rregulloren e programit të studimit[105] janë, Kreu III Vlerësimi i Studentëve, neni 17 ka të përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Gjithashtu, në Rregulloren e institucionit[106] është Kreu VII Kontrolli dhe Vlerësimi i dijeve që percakton në Nenin 83 sistemin e notave dhe në nenin 85 kontrolin e dijeve të studentëve. Në këtë rregullore gjithashtu në Kreun V Organizimi i Studimeve në Universitetin Barleti neni 72 përcakton format e frekuentimit të lëksioneve dhe seminareve si edhe neni 73 kushtet e mospranimit në provimin e një lënde. Së fundi, është gjithashtu edhe në Rregulloren për funksionimin e secretaries mësimore[107], neni 7, neni 9 dhe neni 11 ku përcaktohen pjesëmarrja e studentëve në auditor, riprovimet si edhe kontrolli dhe vlërësimi i dijeve të studentit.<br>Nga takimi me studentët u konstatua se ishin të informuar mbi mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive.<br>*Në çdo rast, GVJ rekomandon gjerësisht institucionin që të vërë në dispozicion të studentit duke e bërë publike, një Udhëzues për Studentin në të cilin të jenë të përcaktuar dhe të qarta këto kritere dhe mënyra të testimin dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Nga takimi me studentët dhe stafi akdemik, u konstatua se studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në nga lektori/rja e lëndës dhe në fillim të çdo lënde, sipas përmbajtjes së syllabusit të lëndës/modulit që në orën e parë të procesit mësimor.<br>Studentëve më pas, ju shpërndahet edhe syllbusi i lëndës kryesisht nëpërmjet formës së komunikimit me email individual. |

[105] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf
[106] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22.pdf
[107] Evidenca 13. 1 Rregullore për Funksionimin e Sekretarisë Mësimore.pdf

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit, konstatoi se metodologjia e testimit dhe vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm ashtu sikurse përcaktohet në Rregulloren për funksionimin e sekretarisë mësimore Neni 8 Rregullores së programit të studimit dhe Rregulloren e Institucionit Neni 85. Vlerësimi përfundim është me shkrim, me gojë ose i kombinuar, i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi dhe rrezultat i kombinimit të komponentëve të frekuentimit dhe pjesëmarrjes aktive në leksione dhe seminre, vlerësimit në projekte dhe detyra kursi si edhe në vlerësimin e provimit përfundimtar të lëndës.<br>Format e kontrollit të dijes të përcaktura specifikisht në frekuentimin, komponentët e kontrollit të vazhdueshëm dhe vlerësimit e lëndës, janë të parashikuara në seksionin përkatës në fund të syllabusit të çdo lënde[108]. |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka rregulla të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, të cilat janë të dokumentuara në Rregulloret përkatëse dhe janë të njohura nga studentët.*<br>*Rregulloret përcaktojnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit, si dhe format e frekuentimit të leksioneve dhe seminareve, duke siguruar transparencë dhe një kuadër të qartë për orientimin e studentëve.*<br>*Studentët janë të informuar mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit, sikurse bëhen të ditura nga lektorët në fillim të çdo lënde, përmes syllabusit dhe komunikimit me email.*<br>*Metodologjia e testimit bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfshin një kombinim të vlerësimeve të ndryshme, duke përfshirë provime përfundimtare, projekte dhe detyra kursi.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të publikojë një Udhëzues për Studentin, për të siguruar një informacion të qartë dhe të plotë mbi kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** |

[108] Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve_Msc. Klinike.pdf

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Format e kontrollit të dijes të përcaktura specifikisht në frekuentim, komponentët e kontrollit të vazhdueshëm dhe vlerësimit përfundimtar të lëndës, janë të parashikuara në seksionin përkatës në fund të syllabusit të çdo lënde[109] të përgatitur nga titullari i lëndës/modulit. Përkatësisht, vlërësimi i vazhdueshëm i studentit përmban 50% të vlerësimit total i cili, së bashku me vlereësimin përfundimtar, që ka peshën e 50% të vlerësimit përfundimtar, konkludojnë në vlerësimin përfundimtar sipas raporteve të parashikuara në nivel institucional. Provimi përfundimtar është detyrim pavarësisht rezultateve të marra gjatë vleresimit të vazhdueshëm. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | GVJ nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit, konstatoi që institucioni si pjesë e sistemit të menaxhimit të të dhënave ka vënë në dispozicion, ndër të tjera, një portal studentor, një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve SIS Classter, Intranet dhe GSuit për komunikim të brendëshëm. Posaçërisht, portali studentor është sistemi gixhital që ky institucion ka në përdorim që në 2016 por më specifikisht, ai që do të mbulojë nevojën e një sistemi elektronik të testimit dhe vlerësimit, do të jetë softëeri që pritet të instalohet, SIS Classter i cili, për çështjet akademike (AKADEMICS) do të mbulojë edhe provimet, planifikimin dhe vlerësimin[110]. Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe sekretarinë u konstatua që aktualisht, mënyra e komunikimit të vlerësimit bëhet drejtëpërdrejtë nëpërmjet sekretarisë dhe/ose nga lektori/ria e lëndës gojarisht ose nëpërmjet emilit personal të studentit.<br>Provimet përfundimtare realizohen të sekretuara. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet sipas komponentëve të vlerësimit të pasqyruar në syllabusin e çdo lënde[111]. Përkatësisht këta komponentë janë për të gjithë të përbërë nga:<br>Provimi i ndërmjetëm 20%, pjesëmarrja dhe aktivizimi 10%, detyra e kursit 20% dhe provimi përfundimtar 50% për një total të vlerësimti të lëndës prej 100%. Modeli i vlerësimit të vazhdueshëm është në përputhje me rregulloren institucionle, rreguloren e programit të studimit dhe legjislacionin në fuqi[112]. |

[109] Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve_Msc. Klinike.pdf
[110] Evidenca 35 Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK.pdf, fq 5-6
[111] Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve_Msc. Klinike.pdf
[112] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i vazhdueshëm, detyrat e kursit, role-play dhe provimet e ndërmjetme u evidentuan nga takimet me studentët dhe personelin akademik si elemente të rëndësishme të procesit që kompleton dhe përmirëson dijen nëpërmjet shkëmbimit të komenteve të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e rezultateve të studentit në të ardhmen. Në rregulloren e Institucionit[113] çdo student ka të drejtë të marrë dijeni për rrezultatin e provimit përfundimtar të tij, të ankohet për rezultatin brenda 48 orëve, të kërkoj nga përgjegjësi i departamentit të bëj verifikimet dhe t`i gjejë zgjidhje ankesës. Nëse përgjegjësi i departamentit nuk i gjen dot zgjidhje, vë menjëherë në dijeni Dekanin. Dekani, brenda 48 orëve nga marrja dijeni ngre një komision të posaçëm (ad-hoc), i cili bën verifikimin e pretendimit të studentit. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar ose përsëritjen e provimit me komision të miratuar nga Dekani. Realizimi i vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme është me qëllim që t`i përshtatet stileve të ndryshme të të nxënit të studentëve. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në Kodin e Etikës[114] përcaktohet se studenti duhet të shmangi veprime të dënueshme si plagjiatura, përvetësimi i punës së tjetrit, vjerdhja, mashtrimi dhe çdo veprim tjetër që parashikohet në rregulloren e Insitutcionit. Respektimi i proçedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave të zhvillohet me përpikmëri provimi. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rregullorja e Universitetit Barleti[115]parashikon të drejtën për ankimim të rezultatit dhe procedurës së vlerësimit dhe realizimit të provimit nga ana e studentit, duke garantuar të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Proçedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij proçesi të përcaktuar në rregulloren e departamentit[116] dhe në syllabusin e lëndës[117]. Gjithashtu kontrolli i cilësisë realizon kontrolle lidhur me trasparencën në vlerësimin me notë duke monitoruar komponentët e caktuar të krahasimit të vlerësimit të realizuar nga stafi akademik për lëndë |

[113] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22.pdf
[114] Evidenca 1.5 Kodi i Etikës.pdf
[115] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22.pdf
[116] Evidenca 1.2 Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.pdf
[117] Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve_Msc. Klinike.pdf

| | |
|---|---|
| | specifike. Në praktikat e komunikimit të vlerësimit në programin e studimit evidentohen aspekte të kumunikimit pozitiv që ju mundësojnë studentëve të jene me email dhe ballë për ballë me pedagogun e lëndës në momentin e komunikimit të vlerësimit dhe të konsultimit të menjëhershëm të çdo pakënaqësie të mundshme mbi vlerësimin. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Çdo student ka të drejtë të marrë dijeni për rezultatin e provimit, të kërkoj sqarim për notën dhe të kërkoj nga përgjegjësi i departamentit të bëj verifikimet dhe t`i gjejë zgjidhje ankesës. Ky i fundit nëse nuk gjen dot zgjidhje, vë menjëherë në dijeni Dekanin. Dekani, i cili bën një vlerësim dhe nëse është gabuar në vlerësim ngrihen komisione të posaçme (ad hoc) konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe nga takimet e zhvilluara në ambjentet e Universitetit Barleti me stafin akademik dhe studentët u vu re se Institucioni respekton proçedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto proçedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së Institucionit[118]. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve (komisioni ad hoc) bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. |
| **Konkluzione** | *Format e kontrollit të dijes në programin e Masterit i Shkencave në Psikologji Klinike përfshijnë një strukturë të qartë vlerësimi që është e përcaktuar në syllabusin e çdo lënde.*<br>*Sistemi i menaxhimit të të dhënave i Universitetit Barleti ofron mundësi të shumta për studentët, përfshirë një portal studentor dhe softuerin SIS Classter për menaxhimin e provimeve dhe vlerësimeve. Aktualisht, komunikimi mbi vlerësimet bëhet përmes sekretarisë dhe pedagogëve, që e siguron transparencën në procesin e vlerësimit.*<br>*Komponentët e vlerësimit për çdo lëndë përfshijnë: provimi i ndërmjetëm (20%), pjesëmarrja dhe aktivizimi (10%), detyra e kursit (20%), dhe provimi përfundimtar (50%), duke e çuar në një* |

[118] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22.pdf

| | |
|---|---|
| | *total prej 100%. Modeli i vlerësimit është në përputhje me rregulloret institucionale dhe synon të mbështesë zhvillimin e studentëve nëpërmjet komunikimeve dhe feedback-ut të vazhdueshëm.*<br>*Kjo qasje inkurajon studentët që të angazhohen në procesin e vlerësimit dhe të shfrytëzojnë të drejtat e tyre për të kërkuar sqarime dhe për të bërë ankimim për rezultatet. Instituсioni respekton procedurat e njohjes dhe rishikimit të vlerësimeve, duke garantuar transparencë dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve. Komunikimi mbi vlerësimet bëhet në përputhje me rregullat e privatësisë dhe të drejtat e studentëve për t'u informuar dhe për të kërkuar rishikimin e rezultateve të tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është pjesë e studimeve të ciklit të dytë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, i cili është i organizuar sipas studimeve me kohë të plotë dhe në dy vite si dhe mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe[119]. Objektivat formuese të këtij programi janë sa teorik dhe praktik dhe synojnë përgatitjen e psikologëve klinikë[120]. Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një kurrikule të pasur si në aspektin teorik edhe në atë të kërkimit shkencor. Ai garanton thellimin e njohurive, aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Për thellimin e dijeve në praktikën profesionale në vitin e dytë studentëve ju ofrohet Praktika e cila zhvillohet nga pedagogët përgjegjës dhe nga hulumtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit vërehen isntitucione ku studentët kanë mundësi të kryejnë praktikën. Aftësitë shkencore dhe dijet në fushën e kërkimit studentët i testojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të lëndëve nëpërmjet kontrolleve të pjeshme, detyrës së kursit dhe në përfundim me mbrojtjen e temës së diplomës. |

[119] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf
[120] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf, Neni 2

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Teknologjia e informacionit rezulton të jetë një ndihmesë e informacioneve ndihmëse në funksion të programit të studimit, por edhe në funksion të zhvillimit të aftësive dixhitalizuese. Brenda lëndëve fondi i literaturës është në gjuhë shqipe por edhe në gjuhë të huaj, kryesisht gjuhën angleze, duke krijuar kështu një mundësi të shtuar për studentët e programit të studimit për të zhvilluar aftësitë e tyre edhe në gjuhë të huaj në përputhje me fushën e studimeve duke qënë se Universiteti ofron programe bashkëpunimi nëpërmjet një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara dhe legjislacionin në fuqi. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës përmes udhëzimeve të veçanta dhe vlersimit të njohurive në përfundim të semestrit përkatës. UniBa dhe njësia kryesore/bazë përmes strukturave të saj synon të angazhohet në monitorim dhe nxitjen e stafit në drejtim të vlerësimit dhe përmirësimit të formave të mësidhënies. Në lidhje me këtë kriter, është formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët[121] ku ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri nga Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë dhe rezultatet që dalin nga raportet e përpiluara në përfundim të këtij procesi[122][123], për çdo semestër, i dërgohen departamenteve dhe lektorëve me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit si edhe rishikimin e progrmave të studimit nëse kjo është e nevojshme. *<u>GVJ</u> pas shyqërimit të këtij dokumentacioni sugjeron shtimin e përpjekjeve për të shtuar pjesëmarrjen e studentëve për këtë vlerësim, kryesisht për programin në shqyrëtim, pasi vihet re që për një pjesë të mirë të lëndeve dhe lektorëve vlerësimi është mjaftuar me vetëm 1 student. Kjo është bën të pavlefshëm këtë proces.* Gjithashtu, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore realizon dy herë në vit vlerësimin e performacës[124] dhe më pas harton skedën e vlerësimit duke i përfshirë atë në dosjen e stafit. Mbi bazën e Rregullores për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës si edhe formularët raportues dhe vetëraportues bashkëngjitur kësaj rregullorje[125], Komisioni i vlerësimit të |

[121] Evidenca 11.2 Formular i vleresimit te lendes dhe pedagogut nga studentet.pdf
[122] Evidenca 53 Raporti vleresimit te studenteve per v.a 2022-2023, sem I.pdf
[123] Evidenca 54 Raporti vleresimit te studenteve per v.a 2022-2023, sem II.pdf
[124] Evidenca 7.1 Manuali i Burimeve Njerëzore.pdf
[125] Evidenca 12 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.pdf

| | |
|---|---|
| | performancës, synon nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe zhvillimin, përmirësimin kurrikular dhe përmirësimin sa më cilësor të procesit mësimor. Raportimi i punës semestrale vetëdeklarohet nga ana e çdo pedagogu, dy herë në vit, duke u ndalur në një sërë aspektesh që kanë të bëjnë me mësimdhënien, punën kërkimore shkencore, angazhimin administrative dhe të gjitha këto bëhen gjithashtu pjesë e analizës vjetore të departamentit[126][127]. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që u japin studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë dhe zhvillimin e shprehive duke prekur aspektet praktike në një gamë lëndësh të detyruara dhe me zgjedhje. Kjo u bazua në bisedat e zhvilluara nga stafi dhe takimi me studentët. Përsa i përket referimit të syllabuseve të lëndëve mësimore[128] një pjesë e mirë e tyre paraqesin edhe elementët praktik të zhvillimit të leksioneve si role play, punë në grupe, etj. Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me instiucionet e tjera ka nisma me institucione si brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga Universiteti Barleti si konferenca, workshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie[129][130].Gjithashtu ka një klimë pozitive të ndërveprimit midis stafit dhe studentëve për çështjet mësimore. Procesi i mësimdhënies bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimit kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënit në tërësi. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë | Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, është vazhdimisht i interesuar për të qënë pjesë e diskutimeve shkencore mes profesionistëve të fushës duke marrë pjesë në aktivitete shkencore[131] si brenda edhe jashtë vendit, duke u informuar mbi zhvillimet e reja në fushën e tyre të ekspertizës |

[126] Evidenca 28.1 Raporti i punes vjetore 2022 2023 DSHSSH.pdf
[127] Evidenca 28.2 Raporti i punes vjetore te departamentit 23-24.pdf
[128] Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve_Msc. Klinike.pdf
[129] Evidenca 28.1 Raporti i punes vjetore 2022 2023 DSHSSH.pdf
[130] Evidenca 28.2 Raporti i punes vjetore te departamentit 23-24.pdf
[131] Evidenca 13. Pjesmarrja ne konference e organizuar nga Uniba per stafin e nagazhuar.pdf

| | |
|---|---|
| brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | dhe në fushën e psikologjise klinike[132][133]duke qënë se pjesë e stafit janë dhe pjesë eksperte apo anëtarë të Urdhrit të Psikologut. Informacionet për t`u bërë psikolog i licencuar i mbajnë studentët në koherencë të vazhdueshme. Universiteti Barleti, për personelin akademik, efektiv dhe me kontratë, ka zhvillur dhe zhvillon mobilitet të stafit dhe studentëve përmes projekteve dhe marrëveshje të ndryshme isntitucionale si brenda dhe jashtë vendit[134][135]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Përgjatë vitit akademik janë zhvilluar trajnime, konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar vendas apo të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik i programit të studimit dëshmon të jetë një urë lidhëse ndërmjet informacioneve më të fundit të shkencës dhe teknologjisë, të mundësuara shpesh nga Insitucioni dhe të incentivura prej tij në zhvillim e stafit akademik, duke i përcjellë këto tek studentët e programit të studimit. Personeli akademik i integron këto dije në strukturën e programeve lëndore dhe temave mësimore ose i shpërndan këto njohuri nëpërmjet orëve të hapura të zhvilluara edhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke qënë të angazhuar vetë si lektorë ose edhe duke ftuar kolegë vendas e të huaj ekspertë në fusha të ndryshme që lidhen me programin e studimit. |
| **Konkluzione** | *Struktura e programit është hartuar mbi bazën e një kurrikule të pasur që përfshin elementë teorikë dhe kërkimin shkencor, me qëllim zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve.*<br>*Në vitin e dytë, programi ofron mundësi praktike të zhvillimit profesional përmes praktikave në institucione të ndryshme, të cilat janë organizuar në bashkëpunim me pedagogët dhe partnerët e institucionit.*<br>*Një aspekt i rëndësishëm i programit është përfshirja e teknologjisë së informacionit, duke i siguruar studentëve akses në burime dixhitale dhe literaturë në gjuhën shqipe dhe angleze.*<br>*Vlerësimi i studentëve realizohet përmes një kombinimi të provimeve të ndërmjetme, pjesëmarrjes aktive në klasë, detyrave të kursit dhe provimeve përfundimtare. Gjithashtu, studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të pedagogëve dhe lëndëve, një* |

[132] Evidenca 20.2 Kerkim i aplikuar e projekte te UniBa 2015 e ne vazhdim.pdf
[133] Evidenca. 11. Databaze i punës kërkimore të stafit 2022-2023; 2023-2024.pdf
[134] Evidenca 10.3. Marreveshje brenda vendit.pdf
[135] Evidenca 10.2 Te dhena mbi marreveshjet e bashkepunimoit (MoU), mobilitetin e stafit dhe studenteve dhe marreveshjet ne kuader te projektit Erasmus +.pdf

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *proces i cili synon përmirësimin e mësimdhënies dhe përshtatjen e kurrikulës sipas nevojave të studentëve. Megjithatë, GVJ sugjeron fort rritjen e përpjekjeve për pjesëmarrjen e më shumë studentëve në këto vlerësime, për të bërë këtë proces sa më efektiv.* *Personeli akademik i këtij programi merr pjesë në konferenca dhe aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, universiteti inkurajon mobilitetin e stafit dhe studentëve përmes marrëveshjeve dhe projekteve ndërkombëtare. Këto përpjekje kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5** **Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Në rregulloren e Universitetit Barleti[136] theksohet se studimet e ciklit të dyte ``Master i Shkencave`` përmbyllen me një punim diplome. Në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike[137], i cili realizohet me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, theksohet se studimet në këtë program përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tij lëshohet diploma ``Master i Shkencave`` në ``Psikologji Klinike``. Në rregulloren e Universitetit Barleti nuk ka të përcaktuar notën mesatare për të cilën studenti ka të drejtë të mbrojë temë diplome dhe procedura e diplomimit përcaktohet në mënyrë të përmbledhur në rregulloren e programit[138]. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në | Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Turizmit, si struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit siguron që personeli akademik të asistojë në mënyrë të vazhdueshme diplomantët duke ju vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse sikurse është edhe Paketa e Provës Finale[139]. Ndjekja e procesit të përgatitjes së provës |

[136] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22.pdf, Kreu V, Neni 62.
[137] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf, Kreu I, Neni 2; Kreu II, Neni 4.
[138] Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf, Kreu IV, Neni 22.
[139] Evidenca 13.3 Paketa e proves finale.pdf, fq 2-3.

| | |
|---|---|
| funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | finale realizohet nga komiteti shkencor për provën finale, pedagogu apo udhëheqësi i propozuiar ose bashkëudhëheqësi me tutull i caktuar nga profesorati I UNIBA. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Nga takimi me stafin akademik u vu re se stafi akademik ofron mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta në provën finale. Ato i pajisin studentët me udhëzimet dhe procedurat e përgatitjes dhe të prezantimit të punimit të tyre të diplomës[140]. Në veçanëti kjo përfshin ndihmën për realizimin në mënyrë rigoroze të mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e provës finale ku komiteti shkencor i ngritur për këtë qëllim harton udhëzimet dhe procedurat e përgatitjes së provës finale. Ky komitet duhet të hartojë listën e temave që janë në studim për fushat që mbulon ky program studimi si dhe të garantojë që temat e propozuara të jenë të përshtatshme për këtë program studimi[141]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jashtë institucionit, janë dhënë dokumenta si listë marrëveshje bashkëpunimi por duhet theksuar se ka shumë pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me një bashkëpunimin të tillë. Përsa i përket bashkëpunimit brenda, pavarësisht faktit që nevojitej një numër më i gjerë dokumentacioni dhe evidencash bashkëngjitur dosjes, nga vizita në institucion u konstatua se kemi një sërë komponentësh si aksesi në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi dhe biblioteka. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes | Nga biseda me anëtarët e stafit të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si edhe nga shqyrëtimi i dokumentacionit, u vu re se komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre |

[140] Evidenca 13.3 Paketa e proves finale.pdf, fq 5-11.
[141] Evidenca 13.3 Paketa e proves finale.pdf, fq 2.

| | |
|---|---|
| së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | anëtarë. Përbërja e komisionit të vlerësimit bëhet nga komiteti shkencor i cili ia propozon më pas atë përgjegjësit të njësisë me një përshkrim të shkurtër për anëtarët e tij. Titullari i njësisë kryesore përcjell për miratim tek Dekani i Fakultetit komisionin e vlerësimit. Komisioni në përfundim të mbrojtjes së diplomës bën vlerësimin e punës së tyre sipas një sistemi standard të pikëve. *Pavarësisht faktit se, vlerësimi i punimit të provimit finale nuk specifikon qartësisht vlerësimin e tij me notë*[142]*, në rregulloren e Universitetit Barleti theksohet specifikisht se përfundimi i një vlerësimi shprehet detyrimisht edhe me notë*[143]. Rezultatet e mbrojtjes së punimit final i përcillen studentit formalisht nga sekretaria mësimore. Nëse midis anëtrëve të komisionit të vlerësimit ka mosmarrëveshje mbi vlerësimin e punimit atëhere, Komiteti shkencor, propozon shtimin e një anëtari tjetër në komision. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve dhe pas akreditimit të parë të programit, studenti do të pajiset me diplomën, listen e notave dhe suplementin e diplomës në Master i Shkencave në: Psikologji Klinike. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin e tij. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave kërkimore e profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Nga bisedat me stafin akademik Institucioni, për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm, do të ndjekë rregullat që i dikton legjistlacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit do të arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat dhe do të përpunohen të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit. |

[142] Evidenca 13.3 Paketa e proves finale.pdf, fq 12.
[143] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22.pdf, Kreu VII, Neni 83.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Studimet në Master i Shkencave në Universitetin Barleti kërkojnë përfundimin e një punimi diplome si pjesë përmbyllëse. Kjo kërkesë është e përcaktuar si në Rregulloren e Universitetit ashtu edhe në Rregulloren specifike të Programit të Studimit në Psikologji Klinike. Mbështetja e stafit akademik është e vazhdueshme për të siguruar që studentët të përmbushin kërkesat për provën finale. Komiteti shkencor është përgjegjës për hartimin e udhëzimeve dhe procedurave për prezantimin e diplomës. Paketa e Provës Finale ka rol kyç në mbështetjen për realizimin e proves finale sipas rregullores së njësisë bazë, duke ofruar udhëzime të detajuara për procesin. Në përbërjen e komisionit të vlerësimit janë gjithmonë të paktën tre anëtarë, dhe nëse ka mosmarrëveshje, mund të shtohet një anëtar shtesë. Vlerësimi i punimit të provës finale duhet të specifikojë më qartësisht faktin që realizohet me notë. Pas përfundimit të studimeve, studenti do të pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, duke reflektuar nivelin e kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Në lidhje me garantimin e mjediseve të përshtatshme për realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale në funksion të mësimdhënies, ritheksojmë se për këtë program studimi nuk parashikohen orë laboratorike, por në çdo rast, Institucioni ofron mjediseve të një cilësie të lartë, zyra këshillimi dhe vlerësimi që ju vijnë në ndihmë studentëve sipas nevojave të tyre. Gjithashtu, institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi laboratorët kompjuterik dhe laboratorët e gjuhës së huaj të universitetit. Gjatë vizitës stafi ndihmës akademik shpjegoi të gjitha funksionet e sallave laboratorike, të cilat, në varësi të nevojës, përdoren edhe nga studentët e këtij programi studimi. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Institucioni, për garantimin dhe realizimin e praktikave me qëllim përfitimin më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale, ka aktive disa marrëveshje bashkëpunimi nëpërmjet të cilave, përtej shkëmbimit të dijes dhe rinovimit të njohurive, parashikohet të garantohet edhe realizimi e trajnimit dhe praktikave në laborator[144]. Në këtë kuadër, duhet mbajtur parasysh tipologjia e praktikës së punës dhe e klinikës laboratorike për profesionin e psikologut e cila kryeisht konsiston në qëndra dhe studio psikologjike të natyrës terapeutike dhe/apo të këshillimit në psikologji ligjore. Përmendim për qëllim ilustustrues në këtë raport marrëveshjet që ka insitutcioni me Qëndrën `Strehësa Edlira Haxhiymeri`, Me Qëndrën Ekuilibrium, Me Studion Psikologjike Humanum, me Qëndrën Multidisiplinore të Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore `Family` SHPK, etj. Në funksion kë këtyre marrëveshjeve këto institucione angazhohen në ofrimin e ambjenteve për trajnime, ëorkshope, forume, konsultime, etj në funksion të realizimit të objektivave dhe në përmbushje të misionit dhe vizionit të Universitetit. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Për programin e studimit Master i Shkencës në Psikologji Klinike është i detyrueshëm zhvillimi i praktikës profesionale të studentit në institucione ashtu sikurse parashikohet edhe në kurrikulën e këtij programi studimi[145]. Studenti duhet të marrë vlerësim pozitiv për raportin që paraqet mbi praktikën, vlersim i cili në fund kthehet në kredite. Gjithashtu, në këtë proces zë një peshë të rëndësishme edhe vlerësimi i marrë nga mbikëqyrësi i praktikës në institucionin ku kjo e fundit është zhvilluar. Nga shqyrëtimi i dokumentit të Paketës së Praktikës[146] u konstatua se në dokumentacionin përkatës që studenti dorëzon, përveç Marrëveshjes së Praktikës, parashikohet edhe Formulari i Vlerësimit të Praktikës në të cilin personi mbikëqyrës jep vlerësimin e tij ndaj studentit si në formë sasiore ashtu edhe me një koment përshkrimor në fund të formularit. Gjithashtu, në Formularin e Vlerësimit të Raportit të Praktikës, pedagogu mentor/mbikëqyrës i praktikës, shpreh vlerësimin e tij në bazë kriteresh dhe ky formular i dorëzohet në përfundim sekretarisë së programeve master brenda afate të përcaktuara. |
| **Konkluzione** | *Programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike nuk përfshin orë laboratorike, por institucioni ofron mjedise me cilësi* |

[144] Evidenca 10.3. Marreveshje brenda vendit.pdf.
[145] Evidenca 2.1. Plani mësimor. pdf
[146] Evidenca 13.2 Paketa e Praktikes.pdf

| | |
|---|---|
| | *të lartë, si zyra këshillimi dhe laboratorë kompjuterikë e gjuhësorë, që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, si qëndra psikologjike dhe terapeutike, të cilat ofrojnë hapësira për praktikat profesionale, trajnim dhe zhvillim të kompetencave të studentëve. Praktika profesionale është e detyrueshme dhe vlerësimi përfundimtar bazohet në raportin e praktikës dhe në vlerësimin e mbikëqyrësit në institucionin përkatës, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të vlerësimit përfundimtar të studentit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, | Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, gjykojmë se të dhënat e bazuara në CV-në[147] e stafit PAE/PAK të angazhuar në këtë program studimi, nuk janë të plota. Për vitin akademik 2022-2023, nuk ka CV të një pjese të konsiderueshme të pedagogëve efektiv (R.P, M.R., A.B., A.XH) dhe CV të pedagogëve me kontratë (A.S., L.A., L.G., G.B., L.Xh., E.Dh., M.Xh., E.T., G.C. E.F), për vitin 2023-2024 nuk konfigurojnë me CV e tyre pedagogë efektiv (A.P., E.K., A.B), si dhe pedagogët me kontraktë (A.S., L.A., E.M., L.G., |

[147] Evidenca 32. CV të stafit akademik

| | |
|---|---|
| drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | G.B., L.Xh., E.Dh., M.Xh., E.T., G.C., E.F.)[148]. Vihet re se në këtë departament nga viti 2022-2023, në vitin akademik 2023-2024 ka pasur lëvizje të sfatit akademik efektiv, ku janë larguar katër punonjës (E.M., R.P, M.R., A.XH), mbi 50% të stafit efektiv duke treguar një paqëndrueshmëri në këtë staf[149]. Në nivel programi studimor, vihet re e njëjta përqindje në lëvizje të stafit akademik nga viti akademik 2022-2023 në vitin akademik 2023-2024[150]. Një aspekt që konsiderohet me ndikime negative lidhet me një pjesë të stafit akademik efektiv ose me kontratë të cilët nuk i zotërojnë kualifikimet në të tre nivele (BA, MA, DR) në fushën e psikologjisë (M.S, biokimi, e më pas master e doktoraturë në psikologji; E.F. edukimin bazë në psikologji dhe më pas ka vazhduar kualifikimet e mëtejshme në punë sociale, L.A. ka mbaruar studimet baze dhe master në psikologji por doktoraturën e ka mbaruar shkenca të edukimit dhe sociale) kualifikime të cilat mund të kenë impakt negativ në cilësinë e mësidhënies dhe kërkimit shkencor sipas interesave që shprehin studentët në fushat e psikologjisë klinike, duke mos qenë brenda fushës së tyre të kompetencës apo duke mos vazhduar të specifikohen në fushën e tyre të kompetencës. Gjithashtu, në CV për programin janë vënë edhe staf akademik i cili nuk figuron në listën e pedagogëve të programit e që kanë fusha të tjera studimi (M.K., G.Z). Bazuar në tabelën e mëposhtme e cila ka përmbledhur të dhënat e marra nga lista e plotë e stafit akademik të programit, GVJ konstaton se në nivel departamenti, personeli akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2022-2023 është 33% ndërsa personeli me kohë të pjesshme 67%, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 31% e personelit konfiguron me kohë të plotë, dhe 68% me kohë të pjesshme, duke treguar një kapacitet të ulët të institucionit në nivel të stafit akademik të qëndrueshëm dhe efektiv të angazhuar në mbulimin e orëve të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit[151]. Në nivel të programit studimor[152] për vitin akademik 2022-2023[153], vërehet se afërsisht 67% e stafit me kohë të plotë angazhohet në këtë program studimor, dhe 33% e stafit me kohë të pjesshme. Ndërkohë, për vitin 2023-2024, vërehet një ulje e dukshme e përqindjes së stafit me kohë të plotë në angazhimin në |

[148] Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[149] Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021. Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë
[150] Aneks. Tabelat Përmbledhëse ASCAL, Tabela 2
[151] Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[152] Evidenca 37. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Psikologjik Klinike
[153] Aneks. Tabelat Përmbledhëse ASCAL, Tabela 2

| | |
|---|---|
| | këtë program në 43%, ndërsa një rritje në përqindje në 57% për stafin me kohë të pjesshme. Ky tregues rrezikon mbulimin e programit studimor me personel akademik me kohë të plotë, duke rrezikuar cilësinë e programit studimor. |

*Të dhëna e mëposhtme për programin e studimit:*

| Tituj/grada[154] | 2022-2023 | | 2023-2024 | |
|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prof.As.Dr. | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Dr/PhD | 3 | 2 | 5 | 3 |
| Msc | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Në total** | **4** | **2** | **5** | **3** |

Vihet re se për vitin akademik 2022-2023, stafi akademik i departamentit në 67% e tyre kanë qenë me gradë shkencore/tituj akademik, ndërsa 33% kanë qenë me Msc, nuk ka pasur staf akademik me titullin Prof.Dr., ndërsa me titullin Prof.As.Dr. kanë qenë 10% e stafit. Në vitin akademik 2023-2024, vihet re një rritje e pedagogëve me gradë shkencore/tituj akademik në 73%, ndërsa me Msc një ulje në 27% të stafit të pedagogëve. Stafi akademik i përfshirë PAE dhe PAK në programin studimor, në vitin 2022-2023 dhe 2023-2024, vihet re se kanë qenë me gradë shkencore/tituj akademik. Por, në dokumentacionin për stafin akademik për vitin 2023-2024 për programin studimor vihet re mospërputhje në evidenca. Konkretisht Evidenca 4. Lista e plotë e stafit akademik që japin mësim në këtë program liston 5 staf akademik PAE dhe 3 staf akademik PAK, ndërkohë në tabelën 2 (pjesë e tabela të kërkuara nga ASCAL), në aneks të raportit, janë 4 staf akademik PAE dhe 4 staf akademik PAK.

*GVJ duke u bazuar në të dhënat mbi stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi gjykon se një çështje e cila ka nevojë të adresohet është qëndrueshmëria e stafit, rritja e kapaciteteve të stafit efektiv në krahasim me stafin me kohë të pjesshme, ruajtja e profileve akademike për stafin akademik sipas kurseve të ofruara në program. Gjithashtu, GVJ evidenton se dokumentacioni i dhënë nuk është i saktë në disa raste, duke krijuar paqartësi dhe jo koherencë të informacionit.*

[154] Tabela përmbledh të dhëna për stafin akademik që jep në programin studimor duke u bazuar në Evidencën 4. Lista e plotë e stafit akademik që jep mësim në këtë program dhe Tabelës 2, e gjendur në Aneks të raportit.

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Ngarkesa mësimore për PAE, për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024, janë dhënë në tabelat përmbledhëse të ASCAL, të cilat gjenden në Aneksin e RVB[155]. Për vitin akademik 2022-2023, rezulton se 4 anëtarë të stafi akademik PAE janë angazhuar në programin studimor. Ngarkesat vjetore të këtij stafi mungojnë[156]. Për vitin akademik 2023-2024, në tabelën 12.2, nuk janë përcaktuar nëse personeli akademik është efektiv apo me kontratë[157], por në tabelën 4[158] jepen ngarkesat mësimore vjetore të personelit akademik efektiv dhe me kontratë. Në këtë tabelë ngarkesat mësimore vjetore për PAE janë në përputhje me kornizën ligjore, por vihet re se të dhënat në këtë tabelë kanë mospërputhje në numër të stafti PAE dhe PAK, përkatësisht mospërputhja është evidente kur krahasohet Tabela 4 me tabelën 12.2 dhe me Evidencën 4[159]. Në tabelën 12.2 figurojnë 5 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe 4 anëtarë të personelit akademik me kontratë, ndërsa në Evidencën 4 për vitin 2023-2024, figurojnë 5 staf akademik PAE dhe 3 staf akademik PAK. Gjatë vizitës, GVJ ka kërkuar një tabelë me të dhëna të plota sipas tabelave excel të ASCAL, për të dy vitet akademike duke përcaktuar korrektësisht stafin akademik PAE dhe PAK. Kjo evidencë nuk u dërgua, në mënyrë që të saktësoheshin të dhënat. Vihet re se për këtë program studimor, për vitin akademik 2023-2024, sipas të dhënave të Tabelës 4[160] stafi është me 6 lëndë të ndryshme në total, por nuk kemi të dhëna nëse këto kurse jepen të ndara në 3 lëndë të ndryshme për çdo semester. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Institucioni nuk garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv, që janë pjesë e njësisë bazë. Lidhur me stafin e angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit të dhënat përgjithësisht dëshmojë një paqëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, pasi brenda këtij periudhe akreditimi është larguar mbi 50% e stafit akademik[161]. Konstatohet nga vizita në institucion se kontratat e punësimit të stafit efektiv me tituj dhe grada janë kohë të papërcaktuar, si dhe stafi akademik efektiv është i mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. |

[155] Aneks. Tabelat Përmbledhëse të cilat janë vendosur në fund të raportit të brendshëm (RVB-së)
[156] Aneks. Tabelat Përmbledhëse ASCAL, Tabela 12.1
[157] Aneks. Tabelat Përmbledhëse ASCAL, Tabela 12.2
[158] Aneks. Tabelat Përmbledhëse ASCAL, Tabela 4
[159] Evidenca 4. Tabela përmbledhëse për përfshirjen e stafit akademik nuk është në përputhje me Tabelën 2
[160] Aneks. Tabelat Përmbledhëse ASCAL, Tabela 4
[161] Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni ndjek një proçedurë rektrutimi për personelin akademik sipas strukturave të rregulluara në manualin e menaxhimit të burimeve njerëzore[162], duke u bazuar në parimet e meritokracisë dhe profesionalizmit. Çdo fillim semestri, para se të fillojë mësimi, njësitë bazë dhe ato administrative identifikojnë nevojat për rekrutim stafi, më pas merret konfirmimi nga Sekretari i Përgjitshëm dhe publikohet shpallja për vendet vakante në rrjetet sociale dhe faqen zyrtare të universitetit duke cilësuar kriteret e përgjithshme, të veçanta, dokumentat e nevojshme[163]. Më pas krijohet një listë e aplikantëve që i përcillet një komisioni të posaçëm që bën vlerësimin paraprak, duke përcaktuar një listë të shkurtuar të aplikantëve që do të merren në intervistë. Komisioni i intervistës përbëhet nga drejtues dhe specialistë të fushës së ekspertizës, dhe mbas intervistimit të aplikantëve del me një vendim për aplikantin fitues. Aplikanti njoftohet me telefon dhe email nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Kandidati fitues njihet me kushtet e kontratës dhe nëse është dakord firmos kontratën. Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të Universitetit Barleti janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Duke iu referuar përzgjedhjes së stafit akademik, duhet të kihet parasysh të ruhet qëndrueshmëria e stafit, stafi i përzgjedhur të ketë profil në përputhje me modulet, lëndët dhe përmbajtjen e programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Bazuar në infrastrukturën për programin e studimit[164], gjykojmë se Universiteti Barleti plotëson nevojat e studentëve të këtij programi studimi. Në lidhje më këtë kriter, duke analizuar kurrikulën e programit[165] të studimit konstatojmë se në të nuk ka orë laboratorike, por Universiteti ofron mjediseve mësimore me cilësi të lartë, gjithashtu edhe zyrë këshillimi dhe vlerësimi që përdoret sipas nevojave që kanë studentët në kurse të specializuara. Gjithashtu, institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi laboratorët kompjuterik dhe laboratorët e gjuhës së huaj të universitetit. Gjatë vizitës stafi ndihmës akademik |

[162] Evidenca 7.1. Manuali i burimeve njerëzore
[163] Evidenca 7.4. Formati i dosjes personale të stafit
[164] Evidenca Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16
[165] Evidenca 2.1. Plani mësimor

| | |
|---|---|
| | shpjegoi të gjitha funksionet e sallave laboratorike, të cilat në disa raste specifike, në varësi të natyrës së modulit apo kursit përkatës, përdoreshin edhe nga studentët e programit. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Universiteti Barleti, nëpërmjet Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit (DSHSSH) dhe Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore[166] (ZMBNJ) menaxhon të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në "Psikologji Klinike". Sektori i burimeve njerëzore është struktura përgjegjëse për mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon; ndjek ndryshimin e numrit të të gjithë personelit në institucion, të pagave përkatëse si dhe realizimit të tyre; nxjerr të dhënat e personelit që i nevojiten drejtuesve të institucionit. Stafi akademik dhe ndihmës akademik ka dosjet personale me të dhëna të plota. Këto të dhëna duhet të përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe konstatoi se dokumentacioni i tyre në disa raste nuk ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. Në disa raste, kontratat e punës nuk kishin të përcaktuar pagat e punjonjësve sipas kritereve të kontratave të punës të vendosura në Kodin e Punës[167], e në raste të tjera pagat i ishin shumë më të ulta se kufiri i pagave për punonjësit e institucioneve publike. Transparenca e kushteve të punës, e kritereve të pagave dhe arritja e standarteve të pagave me institucionet publike janë hapa që nevojiten për të zhvilluar motivacionin e punës midis anëtarëve të stafit akademik, qëndrueshmërinë e stafit akademik dhe zhvillimin e karrierës. Gjithashtu, në ngarkesën totale të personelit akademik për vitin 2023-2024[168], pedagogu E.K figuron si pjesë e Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, ndërkohë me kontratë figuron në DSHSSH por edhe në evidenca të tjera të paraqitura[169]. Ndërkohë E.F., figuron si pjesë |

[166]Evidenca 7. Manuali i burimeve njerëzore
[167] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë e marrë nga linku https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=93
[168] Evidenca 37. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Psikologjik Klinike
[169] Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit

| | |
|---|---|
| | e stafit akademik efektiv, por me një ngarkesë vjetore 89 orë, nën kriterin e normës për staf PAE me gradën shkencore Doktor Shkencash (165 orë). Gjatë vizitës GVB dhe Përgjegjësi i Departamentit kanë shpjeguar se E.K ka kaluar së fundmi në DSHSSH, ndërsa për E.F është aprovuar një leje sipas kërkesës së pedagoges. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UniBa ka nënshkruar marrëveshje me një sërë institucionesh dhe organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim krijimin e gjithë infrastrukturës së nevojshme për realizimin e praktikave profesionale, përmbylljen e studimeve të diplomës dhe të aktiviteteve të tjera formuese për programin e studimit "Master Shkencor në Psikologji Klinike"[170][171]. Paketa e praktikës profesionale[172] përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve gjatë praktikave profesionale. Gjithashtu, paketa e provës finale, përcakton detyrat e studentëve dhe stafit akademik për mbrojtjen e provës finale.[173] |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | DSHSSH në funksion të realizimit të objektivave formuese të programit të studimit MSH në "Psikologji Klinike" , si dhe në funksion të procesit mësimor ka nënshkruar marrëveshje kryesisht me qendra private por dhe institucione shtetërore (si Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza")[174] për objektivat e programit që kanë prioritet ndërhyrjet psikologjike me fëmijë dhe të rritur[175]. Në marrëveshjet brenda vendit rekomandohet të shtohen marrëveshje institucionale me institucione shtetërore që ofrojnë shërbime të ndërhyrje psikologjike klinike si Agjensia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Qendrat e Shëndetit Mendor etj. Marrëveshje të tilla do krijonin një mundësi më të gjerë për studentët për të pasur akses në dhënien e shërbimit psikologjik. |
| **Konkluzione** | *GVJ bazuar në dokumentacionit për kualifikimin e stafit akademik, ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, kushtet e pagave të personelit, lëvizshmërinë e stafit nga viti i parë* |

[170] Evidenca 10.3. Marrëveshje brenda vendit
[171] Evidenca 10.2. Të dhënat mbi marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU)
[172] Evidenca 13.2. Paketa e praktikës
[173] Evidenca 13.3 Paketa e provës finale
[174] Evidenca 21.1 Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi
[175] Evidenca 10.3. Marrëveshje brenda vendit

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *i programit në vitin e dytë të programit, del në konkluzionin se ky standard përmbushet kryesisht. UniBa dhe DSHSSH për të synuar arritjen e standardit plotësisht duhet të synojë rritjen e qëndrueshmërisë së stafit akademik, kualifikimin e vazhdueshëm dhe në përputhje me programin studimor të të gjithë stafit, kushte transparente të punës për të gjithë stafin, rrogat e stafit akademik të përafrohen të paktën me pagat e personelit akademik në institucionet publike, duke nxitur motivimin e punonjësve për kualifikim të mëtejshëm, si dhe pozicione pune të stafit akademik në funksion të zhvillimit të karrierës së tyre akademik dhe jo që ky pozicion të shoqërohet me pozicione të personelit administrativ.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Gjatë vizitës në institucion është kërkuar të plotësohen evidenca të cilat në RVB citoheshin, por nuk ishin pjesë e dokumentacionit. Evidenca Planimetria FSHSTS dhe Mjediset për FSHSTS mungojnë. Ky vlerësim është bazuar nga të dhënat e marra në Aneks të RVB-së[176] si dhe nga evidenca të institucionit të cilat gjenden në Dosjen e MP Arsim Special. UniBa për programin studimor siguron ambiente dhe mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, duke ofruar një godinë universitare[177][178]. Kjo godinë ofron auditore me kapacitete të ndryshme, me mjedise komode, ku në çdo auditor ka mjete teknologjike mbështetëse për të zhvilluar leksione dhe seminare ndëraktive. DSHSSH ofron 6 salla leksionesh për programin e studimit, 3 salla për praktikë lëndore, 1 sallë për aktivitete promovuese, duke ofruar infrastrukturë bashkëkohore për procesin mësimor[179]. Gjithashtu, UniBa siguron ambiente ku studentët kanë mundësi të zhvillojnë aftësi profesionale teorike dhe praktike. |

[176] Aneks. Tabelat përmbledhëse, Tabela 16
[177] Aneks. Tabelat përmbledhëse, Tabela 16
[178] Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën (marrë nga Dosja e MP Arsim Special)
[179] Aneks. Tabelat përmbledhëse, Tabela 16

| | |
|---|---|
| | Mjediset e godinës plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila është strukturuar në mënyrë të tillë që çdo pedagog të ketë hapësirën e tij për të punuar, kompjuterin individual, gjithashtu kjo zyrë shërben për mbledhje të departamentit. Gjithashtu, çdo drejtori apo njësi mbështetëse ka zyrën përkatëse si Njësia e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Burimet Njerëzore, zyra për IT, zyra për aktivitetet e qeverisë studentore, zyra për studentët, zyra e Kërkimit Shkencor, Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka etj[180]. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me mjete mbështetëse të teknologjisë së informacionit, si projektor, whiteboard, kompjuter, zyra të printimit dhe fotokopjimit për studentët. UniBa ka strukturuar dhe siguruar salla për praktika lëndore/profesionale të studentëve gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të vëzhgojnë drejtpërsëdrejti procese të vlerësimit psikologjik, teknikave të ndërhyrjeve psikologjike, duke zhvilluar aftësi jo vetëm teorike por edhe praktike. Gjithashtu, në mjediset e universitetit ka dy laboratore mbështetëse për studentët për të zhvilluar aftësi kompjuterike dhe aftësi të mësimit të gjuhës së huaj[181][182] |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, ateliетë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Duke u bazuar në dokumentacionin për infrastrukturën e godinave universitare të UniBa[183], si dhe duke u bazuar në vizitën në institucion, rezulton se UniBa ofron laboratorë, zyra, mjedise mësimdhënëse-mësimnxënëse, apo mjedise të tjera të cilat plotësojnë kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik, dhe objektivat formuese të programit të studimit në tërësi[184]. UniBa vë në funksion një godinë për të ofruar programin studimor, e cila ka një hapësirë të përshtatshme, e në të gjithë godinën studentët kanë akses në internet. Gjithashtu, mjediset monitoroheshin nga kamerat duke ofruar siguri të lartë në mjediset universitare. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe | UniBa si institucion i arsimit të lartë, në strukturën e tij ka tre laboratore të informatikës[185], ku veçanërisht studentët e programeve të informatikës dhe të teknologjisë së informacionit i shfrytëzojnë sipas objektivave të kurseve përkatëse. Programi i studimit Master Shkencor në "Psikologji Klinike" nuk ka në |

[180] Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën
[181] Aneks. Tabelat përmbledhëse, Tabela 16
[182] Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën
[183] Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën
[184] Aneks. Tabelat përmbledhëse, Tabela 16
[185] Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën

| | |
|---|---|
| profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | objektivat formuese prioritet laboratorët e informatikës, por këto laboratorë mund të përdoren nga studentët e programit në rastet kur projektet e tyre në kurse të ndryshme kërkojnë të zhvillojnë aftësi kompjuterike. Zhvillimi i aftësive teorike dhe praktike për programin përkatës bazohet në përqasje të mësimdhënies ndëraktive[186], e për të zbatuar principet e mësimdhënies ndëraktive, UniBa ka në infrastrukturën e tij salla të pajisura me mjete të teknologjisë, whiteboard, zyrë për vlerësim të nxënësve me nevoja të veçanta. DSHSSH ka krijuar marrëveshje me institucione publike dhe jo publike[187][188] për të zhvilluar praktika profesionale duke ofruar mundësi për zhvillim të aftësive të aplikuara. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Psikologu klinik është një profesion i rregulluar[189] dhe si i tillë, është e nevojshme licensimi profesional. Në këtë rrugëtim profesional, praktika profesionale në programin studimor është bazike për të zhvilluar aftësi praktike profesionale. Kursi i praktikës profesionale është përcaktuar me 12 kredite[190] sipas kritereve të vendosura për lëndët plotësuese në master shkencor[191], por në ngarkesën mësimore kjo lëndë figuron me 270 orë gjithsej, e më tej figuron në semestër të dytë me 18 orë dhe me 30 orë individuale[192]. Nuk përcaktohen orët e seminareve të praktikës, orët në institucion, duke dhënë një informacion jo të plotë për përllogaritjen e ngarkesës së 300 orëve të praktikës profesionale sipas 12 krediteve përkatëse.<br>DSHSSH ka treguar kapacitete për të formuar bashkëpunime me institucione publike dhe jo publike për të zhvilluar praktikat profesionale por edhe aktivitete të tjera profesionale në funksion të objektivave të programit studimor[193][194]. Institucioni mund të zhvillojë më tej kapacitetet bashkëpunuese duke formuar marrëveshje me institucione të rëndësishme shtetërore të cilat kanë prioritet dhënien e shërbimeve nga ekspertët e fushës së psikologjisë klinike, si Agjensia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Qendrat |

[186] Evidenca 16.3 Udhëzues i mësimdhënies
[187] Evidenca 10.3. Marrëveshje brenda vendit
[188] Evidenca 21.1 Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi
[189] Ligj Nr. 10 171, Datë. 22.10.2009 Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L-PRR1.pdf
[190] Aneks. Tabelat përmbledhëse, Tabela 9
[191] Vendim Nr.41, Datë 24.1.2018. Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/VKM%20Nr.879%20dat%C3%AB%2018.12.2019.pdf
[192] Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike
[193] Evidenca 22. Evidenca 10.3. Marrëveshje brenda vendit
[194] Evidenca 21.1 Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | e Shëndetit Mendor etj. Megjithatë, UniBa ka marrëveshje me institucione të rëndësishme që mund të krijojnë hapësirë për praktika profesionale duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh psikologjike, siç është marrëveshja me Qendrën Spitalore "Nënë Tereza". | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ duke shfletuar dokumentancionin përkatës dhe duke vëzhguar ambientet e godinave universitare, nxjerrë përfundimin se infrastruktura e vënë në dispozicion nga UniBa është në përputhje me objektivat e programit studimor, e përshtatshme dhe garanton realizimin e procesit të mësimdhënies-mësimnxënies ndëraktive, si dhe garanton mjedise për zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike. UniBa ka arritur të krijojë marrëveshje në nivel institucional me institucione të rëndësishme publike dhe jo publike, dhe rekomandohet që këto marrëveshje të zgjerohen në të ardhmen duke nxitur rritjen e kapaciteteve të bashkëpunimit me institucione të rëndësishme që kanë me prioritet ofrimin e një game të gjerë shërbimesh të vlerësimit dhe ndërhyrjes psikologjike. Një shqetësim në lidhje me praktikën profesionale është se kreditet e vendosura nuk përputhen me realizimin e orëve në terren, informacioni është jo i plotë për ndarjen e orëve të praktikës, pasi është dhënë totali i orëve gjithsej e më pas janë dhënë informacione për orë të tjera praktike dhe orë individuale. Për këtë arsye sugjerohet të rishihet kjo mospërputhje për të krijuar mundësi studentëve për të plotësuar normën e orëve të praktikës profesionale sipas një organizimi në përputhje me kuadrin ligjor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe | UniBa ka 3 mjedise për bibliotekën, ku nga këto tre mjedise, një mjedis ishte i organizuar me kompjutera personal dhe garantonte mjedis të qetë, por ky mjedis ishte shumë i kufizuar në krahasim me dy mjediset e tjera, të cilat ishin të integruara me ambiente të |

| | |
|---|---|
| njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | tjera. Nga ajo që vërehet në silabuse[195], literatura e detyruar dhe e rekomanduar nuk është e përditësuar, dhe rekomandohet që kjo literaturë të jetë e pesë viteve të fundit[196]. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, vërehet se leksionet nuk janë depozituar në bibliotekë. Përsa i përket literaturës në formë elekronike, UniBa ka krijuar një platformë online të rezervimit të librave që quhet Platforma Digjitale e Menaxhimit të Librit, e cila është një platformë e përhershme. Në këtë platformë studentët mund të kërkojnë dhe të rezervojnë online libra të cilat universiteti i ofron, e më së shumti këto janë libra në gjuhën shqipe por edhe në gjuhë të tjera që gjenden në libraritë kryesore në Shqipëri. Gjithashtu rezulton se universiteti ofron akses në motorin kërkimor JSTOR dhe ECONBIZ për studentët, ndërsa në platforma të tjera ky akses është i limituar dhe ofrohet vetëm për libra dhe artikuj që janë open access, pra që përdoren pa pagesë[197]. Lista e titujve të librave të ofruara nga biblioteka e UniBa është kryesisht në literaturë në gjuhën shqipe dhe jo në 5 vitet e fundit. Gjithashtu, kërkesa për libra të rinj për programin studimor janë të pakta dhe librat e kërkuar janë tekste në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, në të cilën përfshihet edhe literaturë e më shumë se 10 viteve[198]. Sugjerohet të rishihet literatura duke u fokusuar në literaturë të përditësuar, në 5 vitet e fundit dhe të citohet literatura në silabus sipas stilit APA (versioni 7)[199][200]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se nuk ka një përditësim të literaturës ndërkombëtare në bibliotekë. Literatura bashkëkohore për programin është e kufizuar, dhe në bibliotekë gjenden shumë pak libra bashkëkohorë që janë drejtëpërsëdrejti të lidhura me programin mësimor. Gjithashtu, nuk ka një bibliotekë digjitale për libra bashkëkohorë të 5 viteve të fundit që lidhen drejtpërsëdrejti me programin studimor. Nga GVJ sugjerohet të adresohet kjo situatë duke përditësuar literaturën, sidomos me libra të botimeve të fundit, të krijohet një metodologji për zgjedhjen e librave sipas kritereve specifike, si dhe të përcaktohen procedura |

[195] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve Msc Klinike
[196] Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021. Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë
[197] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17
[198] Evidenca 46. Kërkesë për tituj të rinj librash çdo fillim viti akademik
[199] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve Msc Klinike
[200] Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021. Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë

| | |
|---|---|
| | për përditësimin e literaturës sipas nevojave të departamentit për programin përkatës[201][202][203] |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | UniBa ka 3 ambiente që i konsideron si biblioteka. Gjithsesi, dy nga këto ambiente janë të ndërthurura me ambiente të tjera të institucionit, ku njëri nga këto dy ambiente krijon më shumë mundësi të leximit në qetësi, ndërsa ambienti tjetër është më i zhurmshëm. Ambienti i bibliotekës i veçuar nga mjedise të tjera ishte me hapësirë shumë të vogël, përafërsisht me kapacitet 25-30 persona, por i pajisur me kompjutera personal, ku studentët mund të shfletonin literatura digjitale. Në shfletimin e literaturave digjitale, studentët kishin mundësi të klikonin në një faqe të përgatitur nga stafi i bibliotekës dhe të klikonin në motor kërkimor të ndryshëm që ofronin akses të lirë të literaturave, por studentët nuk mund të aksesojnë literatura të cilat nuk ishin me akses të lirë, përveç në rastin e kërkimit në JSTOR[204]. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Në UniBa fondi fizik i bibliotekës ishte shumë i kufizuar. Një pjesë e konsiderueshme e programve lëndore bazohej në leksione të pedagogëve apo titullarëve të lëndëve, të cilat nuk depozitoheshin në bibliotekë. Literatura akademike nuk është e përditësuar për 5 vitet e fundit në të shumtën e rasteve. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës në shqip nuk lidhet drejtpërsëdrejti me literaturën e detyrueshme të programit, apo me literaturë që mund të jetë në funksion të programit[205]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | UniBa ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë të bibliotekës online për studentët e saj në fushën e programit përkatës. Gjithsesi, kapacitetet e bibliotekës garantojnë një shfrytëzim të kufizuar të literaturës online[206]. Platforma Digjitale e Menaxhimit të Librit është një platformë që UniBa garanton për studentët, e në këtë platformë studentët mund të rezervojnë libra online, por kjo literaturë është më së shumti në shqip dhe botimet janë të larmishme por është e kufizuar të gjesh botime të |

[201] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17
[202] Evidenca 46. Kërkesë për tituj të rinj librash çdo fillim viti akademik
[203] Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve Msc Klinike
[204] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)
[205] Evidenca 46. Kërkesë për tituj të rinj librash çdo fillim viti akademik
[206] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)

| | |
|---|---|
| | përditësuara, akademike e që lidhen direkt me tema në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu, UniBa mundëson vetëm një motor kërkimor me akses të plotë pa pagesë për studentët, që shfrytëzohet në kushte të barabarta, JSTOr, por për motorët e tjerë kërkimor aksesi është i kufizuar. UniBa nuk ofron platformën e bibliotekës digjitale Ulibrary dhe aksesin në EBSCO. Studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në bibliotekë e të marrin shërbimin e bibliotekës falas. Gjatë vizitës në institucion GVB, stafi akademik dhe përgjegjësi i njësisë bazë raportuan se ato bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të garantuar literaturën sa më bashkëkohore për studentët, duke hulumtur në literaturën e bibliotekës, ose në rastet kur kjo literaturë nuk gjendet, ato bëjnë përpjekje personale për të garantuar literaturën e përditësuar, që në të shumtën e rasteve ishte në gjuhën angleze. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Biblioteka në UniBa është pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim të bibliotekës nga të gjithë studentët. Por, ky ambient ka kapacitet të ulët, pasi është përafërisht e strukturuar për 25-30 vende të shfrytëzimit të bibilotekës duke përdorur kompjutera, për të gjithë studentët e programeve të ndryshme. Për të lexuar, në UniBa, kishte një ambient të dytë ngjitur me sallën e kompjuterave të bibliotekës me përafërsisht 40 vende leximi. Ky ambient edhe pse më i qetë nuk ishte i shkëputur nga ambientet e tjera të godinës[207]. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka në UniBa funksionon në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, në nivel Bachelor dhe master, në mënyrë që studentët të kenë hapësira të mjaftueshme të shfrytëzojnë bibliotekën për nevojat e tyre studimore. Oraret e bibliotekës janë 09.00-20.00. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë | Dokumentancioni i vënë në dispozicion nuk jep një procedurë të bashkëpunimit midis bibliotekës dhe DSHSSH[208][209] për të raportuar mbi fondin fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit si nga personeli akademik dhe studentët e programit përkatës. Në dokumentacion |

[207] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)
[208] Evidenca 28.1 Raport i punës vjetore 2022-2023
[209] Evidenca 28.2 Raport i punës vjetore të departamentit 2023-2024

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | mungon një relacion vjetor të këtij përditësimi[210][211][212]. Nga vizita e GVJ si me stafin akademik, me përgjegjësin e departamentit dhe me punonjësit e bibliotekës rezulton se departamenti bën vazhdimisht kërkesë për përditësim literature fizike dhe digjitale, por literatura e përditësuar ndërkombëtare garantohet në raste të veçanta për mungesë fondesh. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ arrin në konkluzionin se është bërë një përpjekje e rëndësishme për të krijuar hapësira studentëve për të shfletuar literaturën në shqip dhe në gjuhën e huaj. Por, ky proces ka nevojë për zhvillimi të mëtejshëm, në hapësira të veçuara, të cilat plotësojnë standartet për mungesë zhurmash për lexim. Gjithashtu, programi studimor duhet të garantojë literatura të 5 viteve të fundit, e këto literatura të ofrohen në cikle leksionesh të përditësuara në gjuhën shqipe, të gjenden kopjet fizike dhe digjitale të këtyre literaturave dhe literaturave origjinale në gjuhët përkatëse. Rekomandohen më shumë hapësira fizike për librat fizikë për programin studimor, si dhe më shumë mundësi për studentët të shfletojnë literaturën në motor kërkimor të tjerë ku të kenë akses të plotë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

[210] Evidenca 28.1 Raport i punës vjetore 2022-2023
[211] Evidenca 28.2 Raport i punës vjetore të departamentit 2023-2024
[212] Evidenca 43. Plan financiar i programit të studimit 2022-2023 dhe 2023-2024

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UniBa disponon një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron informacinet që lidhen me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim që është intranet, portali studentor online[213]. Sektori IT është përgjegjës për menaxhimin e këtyre sistemeve, udhëzimet, ndjekjen e procedurave për regjistrimin online të studentëve dhe për përditësimin e portalit, për ruajtjen digjitale të dokumentacionit për studentët, për stafin akademik dhe institucionin[214][215][216]. Por, gjatë takimeve me studentët e programit, rezulton se përdorimi i Intranetit nuk ndodh me studentët që ndjekin këtë program. Studentët e këtij masteri shprehen se përdorin sisteme jo formale online si google classroom, duke përdorur adresat e tyre personale të gmail-it dhe jo ato të personalizuara nga institucioni e që i jep akses në një gamë të gjerë shërbimesh dhe të dhënash në lidhje me progresin e tyre. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Sipas dokumentacionit të DVV-së, UniBa aplikon struktura të teknologjisë dhe të përdorimti të sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit për aktivitetin e personelit akademik[217][218][219]. Nga diskutimet me stafin akademik, u konfirmua përdorimi i intranet si një metodë online për menaxhimin e informacionit në lidhje me aktivitete të ndryshme mësimore, kërkimore dhe administrative. Gjithashtu, gjatë intervistimit të stafit akademik rezulton që përdoret gjithashtu edhe platforma google classroom. Stafi administrativ konfirmoi lehtësinë në përdorimin dhe ruajtjen e informacioneve me anën e sistemit intranet. Sipas këtij stafi, informacioni ruhet në gjendje fizike dhe digjitale. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Pavarësisht se UniBa ka organizuar sistem të menaxhimit të informacionit online[220], ku sigurohet akses i dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët, e programit master në psikologji klinike, ky sistem nuk aplikohet me studentët. Në këtë program, studentët, informacionet për kurrikulën e programit, për oraret, strukturën e vitit akademik, i mermin me anën e komunikimit me pedagogët përkatës në platformën google classroom. Gjithashtu, informacione më të |

[213] Evidenca 35. Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK
[214] Evidenca 18.1. Rregullore për Funksionimin e Sekretarisë Mësimore
[215] Evidenca 34. Rregullore Protokoll Arkive (marrë nga dosja e RVB-së Arsim Special)
[216] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023
[217] Evidenca 35. Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK
[218] Evidenca 19.1. Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[219] Evidenca 34. Rregullore Protokoll Arkive (marrë nga dosja e RVB-së Arsim Special)
[220] Evidenca 35. Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK

| | |
|---|---|
| | detajuara në lidhje me datat e provimeve, riprovimeve, punësimet, studentët i gjejnë në sitet e universitetit si dhe rrjetet sociale. Këto forma të komunikimit ishin shumë të përdorura nga to. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | DSHSSH ka krijuar një rrjet komunikimi të brendshëm midis stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të programit që i përgjigjet nevojave reale, shpejt dhe me efikasitet. Ky komunikim ndodh më së shumti në nivel sistemesh të mësimdhënies jo formale, në platforma me akses të lirë si google classroom, me anën e rrjeteve sociale si facebook, instagram, tittok, X, Linkedin, dhe sitit të internetit, ku ka një hapësira të dedikuara stafit administrativ, stafit akademik, studentëve, punësimit, karrierës dhe njoftimeve në kohë reale[221]. Nga takimet në institucion, e veçanërisht takimet me studentët, këto platforma komunikimi ishin shumë praktike për to, por ato shprehen se do të donin sisteme akoma më të specifikuara ku të mund të shfrytëzonin maksimalisht nga sistemi shfletimin e literaturës, regjistrimin online në provime, apo informimin e individualizuar në lidhje me vlerësimin me nota. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi teknologjik i menaxhimit të informacionit, intranet që ofrohet nga institucioni, në rastin e këtij programi studimor nuk aplikohet me studentët e programit. Më së shumti, për studentët, informimi në kohë reale realizohej me anën e platformave të rrjeteve sociale, apo të google classroom. Gjithashtu, UniBa ka një faqe interneti ku përditësohet vazhdimisht me informacione në interes të studentëve. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | UniBa në faqen zyrtare siguron informacion në shqip dhe në anglisht në lidhje me programet studimore, procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve, informacione për studentët, stafin akademik, për zhvillimin e karrierës, punësimin, aktivitetin kërkimor. Gjithashtu, në faqen e inernetit jepen linqe të aksesueshme si E-Albania, Matura Shtetërore. [222] Në këtë faqe mund të akses dhe në rrjetet sociale të UniBa. |
| **Konkluzione** | *Në konkluzion, duke u bazuar në dokumentancionin e DVV si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ gjykon se UniBa disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional Intranet. Ky sistem përdoret më shumë nga punonjësit* |

[221] https://www.umb.edu.al/
[222] https://www.umb.edu.al/

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *e administratës, personelit akademik dhe ndihmës akademik, por në programin e studimit master shkencor në psikologji klinike, nuk përdoret nga studentët. UniBa dhe DSHSSH ka vënë në dispozicion platforma komunikimi për studentët me anën e rrjeteve sociale, faqes së internetit, platformave të mësimit online, por është e nevojshme që sistemi Intranet të aplikohet tek studentët e programit të masterit shkencor në psikologji klinike.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga DVV, vihet re se nuk sigurohet një plan financiar i Institucionit për programin studimor. Dokumentet në DVV për menaxhimin e financave janë dokumentet për burimet financiare të UniBa[223] dhe të raportit vjetor[224]. Në raportin vjetor akademik 2022-2023 institucional, shprehet se Zyra e Financës, nën drejtimin e Administratorit, hartojnë raport të hollësishëm të kostove për realizimin e programeve të studimit duke bërë parashikime për periudha afatmesme, por ky plan për programin nuk është i evidentuar. Dokumentit i burimeve financiare të programit studimor është i njëjtë me tabelën 18[225], e lidhet me të ardhurat e 3 viteve të fundit në nivel institucional[226]. |

[223] Evidenca 45 Burime Financiare UniBa
[224] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023
[225] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)
[226] Evidenca 43. Plan financiar i programit të studimit 2022-2023 dhe 2023-2024

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet | UniBa në raportin vjetor raporton për plane të hollësishme financiare në nivel programesh studimesh[227], por në dokumentin për burimet financiare[228] evidentohet një plan i përgjithshëm institucional për menaxhimin e të ardhurave, ndërkohë që plani i financimit të programit që është pjesë e njësisë kryesore dhe njësisë bazë mungon. Nga takimet me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe administrativ vihet re se përgjegjësia e menaxhimit të financimit është në nivel të Zyrës së Financës dhe se në zëra që lidhen me programin, stafi akademik dhe përgjegjësi i departamentit bëjnë konsulta dhe krijohen hapësira të vendimmarrjes së bashku me njesinë bazë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | UniBa në raportin vjetor institucional[229] menaxhon kontrollin financiar me anën e auditeve të brendshme dhe të jashtme. Këto audite realizohen në periudha të caktuara, çdo një vit dhe realizohen nga institucioni por edhe kompani auditi ndërkombëtare të regjistruara në Shqipëri (kompania Grant Thornton shpk), por edhe kontrolle nga Drejtoria e Tatim Taksave. Raportet e auditit dhe rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e senatit akademik. Nga DVV figuron një raport vjetor i auditit të brendshëm i vitit 2019[230], por nuk figuron një raport auditimi i jashtëm. Pavarësisht, se në fund të auditimit të brendshëm konfirmohet se auditimi i jashtëm ndodh nga kompania Grant Thornton, dhe se raportet e auditit mund të gjenden me lehtësi online, nga një kërkim i bërë nuk figuruan raporte të auditimit. *Sugjerohet dokumentimi i auditit për çdo periudhë kohore, si auditit brenda institucionit dhe atyre jashtë institucionit.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Në burimet financiare UniBa[231] raporton mbi vitet 2020-2022 për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra, e më pas jep një pasqyrë të veprimtarisë së parashikuar për vitin akademik 2023-2024. Në dokumentin e vënë në dispozicion nuk ka të dhëna specifike për programin studimor. Nga dokumentat në DVV si dhe nga ato të marra mbas vizitës, nuk është dërguar realizimi i buxhetit në njësinë kryesore dhe bazë në lidhje me realizimin e programit. GVJ rekomandon që të krijohet një sistem menaxhimi financiar që |

[227] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023
[228] Evidenca 45 Burime Financiare UniBa
[229] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023
[230] Evidenca 44. Raport Auditim i Brendshëm
[231] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023

| | |
|---|---|
| | përfshin jo vetëm Zyrën e Financave por edhe njësinë kryesore dhe atë bazë, në mënyrë që të realizohet një buxhet financiar sa më efikas dhe në përputhje me nevojat ekonomike të programit studimor. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion[232][233][234], rezulton se ka një mungesë në dokumentacionin mbi raportet vjetore financiare, si në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Pavarësisht, se në rapotin institucional shprehet se ka qëndrueshmëri financiare, mungesa e dokumentacionit përkatës tregon një mosevidentim të qëndrueshmërisë financiare. Nga burimet financiare, vërehet se baza e të ardhurave financiare vjen nga tarifat e shkollimit, por jo nga fonde të tjera të cilat mund të rrisin sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare, si p.sh. të ardhura nga projekte kërkimore apo nga fonde të fituara publike ose jo publike. Hartimi i një raporti specifik financiar për çdo program studimor dhe planifikimi në nivel afatmesëm dhe afatgjatë duke marrë në konsideratë rrisqet dhe menaxhimin e tyre, mund të krijojë më shumë objektivitet për qëndrueshmërinë financiare. |
| **Konkluzione** | *Në konkluzion, GVJ rekomandon një analizë më të hollësishme të buxhetit financiar si në nivel institucioni, të njësisë kryesore dhe njësisë bazë duke evidentuar këtë proces. UniBa garanton financim për realizimin e programit, por ky financim nuk evidentohet si i qëndrueshëm në kohë, e gjithashtu nuk evidentohet nëse njësitë bazë kanë kapacitete të menaxhojnë në mënyrë efikase burimet financiare për programet e tyre, dhe rekomandohet që çdo program të ketë një buxhet specifik të implementimit të tij.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

232 Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023
233 Evidenca 45 Burime Financiare UniBa
234 Evidenca 43. Plan financiar i programit të studimit 2022-2023 dhe 2023-2024

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | UniBa ka hartuar politika, aktet vetërregulluese dhe procedura[235][236][237][238][239][240][241][242] sipas kuadrit ligjor[243] për të rregulluar ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja dhe zbaton politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve. Në statutin dhe rregulloren e UniBa[244], përcaktohen politikat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin, dhe largimin e studentëve por edhe detyrimet e tyre. Gjithashtu, këto politika janë reflektuar në rregulloren e fakultetit, departamentit, në rregullore e programit të studimit si dhe në rregulloren e zyrave për studentët dhe rregulloren për transferimin e programeve dhe regjistrimin në programe të dyta. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | UniBa mbështetet në rregulloret e tij[245][246][247][248][249], dhe sipas politikave të hartuara, akteve vetrregulluese për procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, siguron të drejta të barabarta dhe të plota për të gjithë studentët[250]. Nga shqyrtimi i DVV-së por edhe vizitës në institucion me studentët, me dekanin e studentëve, personelin ndihmës në sekretarinë mësimore, vihet re një angazhim maksimal për të garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët e programit mësimor. |

[235] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[236] Evidenca 1.5. Kodi Etikës
[237] Evidenca 20.4 Rregullore e zyrave studentore, alumni dhe karriera
[238] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
[239] Evidenca 19.5. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa
[240] Evidenca 1.2 Rregullore e departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[241] Evidenca 1. Strategjia e zhvillimit për programin e studimit Msc Psikologji Klinike
[242] Evidenca 1.1 Rregullore e fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit
[243] Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015 https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/P%C3%ABrmbledhje-e-legjislacionit-p%C3%ABr-arsimin-e-lart%C3%AB-perditesuar-deri-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf
[244] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[245] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[246] Evidenca 18.2 Rregullore e brendshme për transferimin e studentëve
[247] Evidenca 1.5. Kodi Etikës
[248] Evidenca 20.4 Rregullore e zyrave studentore, alumni dhe karriera
[249] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
[250] Evidenca 20.4 Rregullore e zyrave studentore, alumni dhe karriera

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | DSHSSH propozon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve[251]. Më pas merret miratimi në nivel njësie kryesore dhe senati akademik[252]. UniBa në faqen zyrtare të internetit, siguron të gjithë informacionin e nevojshëm për të orientuar maturantët për kriteret e pranimit dhe procedurat e aplikimit si dhe studentët për transferim studimesh apo për studime të dyta. Gjithashtu, informacionet shpallen në tendat përkatëse pranë sekretarisë apo departamentit për programin studimor[253][254]. Nga të dhënat e mesatareve hyrëse[255] del se mesataret hyrëse të studentëve për programin master shkencor në psikologji klinke janë 7.5 për vitin akademik 2022-2023 dhe 7.8 për vitin akademik 2023-2024, mesatare plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor për kriterin e mesatares në programet studimore në degë që ofrojnë mundësi për të vazhduar studime të ciklit të dytë në mësuesi[256][257], pavarësisht, se ky program studimor nuk është i profilit mësuesi. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | UniBa ka platforma të komunikimit për procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve për programet përkatëse, për përparimin përgjatë kursit të studimit, të transferimit, të njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjessshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cila janë të pasqyruara në faqen zyrtare[258], në statutin e UniBa[259], rregulloren e institucionit[260], rregullore të DSHSSH dhe të programti studimor[261][262][263][264][265]. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në UniBa shpreh se proçedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me |

[251] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
[252] Evidenca 2.3 Vendimet për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve
[253] https://umb.edu.al/transferohu.html
[254] https://umb.edu.al/pranimet.html
[255] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)
[256] Vendim Nr. 46, Datë. 27.1.2021 https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf
[257] Vendim Nr. 363, Datë. 26.5.2022: https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/vendim-363-date-26.5.2022.pdf
[258] https://admission.umb.edu.al/
[259] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[260] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[261] Evidenca 18.2 Rregullore e brendshme për transferimin e studentëve
[262] Evidenca 20.4 Rregullore e zyrave studentore, alumni dhe karriera
[263] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[264] Evidenca 1.2 Rregullore e departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[265] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike

| | |
|---|---|
| | VKM[266][267] në fuqi për kriterin e mesatares hyrëse për programet e studimit në ciklin e dytë apo të integruar. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Në faqen zyrtare të UniBa gjenden informacione për të interesuarit dhe publikun mbi kriteret e programit të studimit. Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Klubin e Karrierës organizon Panairin e Punës duke ftuar ish studentë, Alumni[268], të diplomuar dhe të interesuar të cilët dëshirojnë të studiojnë pranë UniBa[269]. Gjithashtu, UniBa organizon ditët e informimit dhe promovimin e programeve[270] si dhe informon vazhdimisht me botimin e revistës studentore[271], studentët aktualë dhe ato që kanë interes të studiojnë në programet e UniBa për jetën studentore, shërbimet e marra në UniBa dhe kriteret e pranimit në programet e studimit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi organizimin e ditëve të informimit, si dhe angazhimit të institucionit për të promovuar programet studimore me anën e informimit dhe ndërgjegjësimit të interesuarve për të ndjekur studimet në UniBa, dhe veçanërisht në programin e masterit shkencor në psikologji klinike. Studentët në programin studimor përfshihen në klube sipas interesave të tyre studimore[272][273][274][275], duke pasur një agjendë të pasur me aktivitete që nxisin zhvillimin personal, krijimin e rrjeteve të Alumnit, rrjetëzimin e tyre dhe angazhimin aktiv jo vetëm si studentë por edhe si individë aktiv që kontribuojnë në komunitet. |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Nga shqyrtimi i DVV, nuk rezulton të jenë hartuar politika për kritere të veçanta për përzgjedhje të kanditatëve nga grupet e margjinalizuara dhe grupet e pakicave. Në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton të krijohen kritere të veçanta në raste kur kanditatët shfaqin aftësi të veçanta dhe të larta që dallojnë për këto aftësi[276][277][278][279]. |

[266] Vendim Nr. 46, Datë. 27.1.2021 https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf
[267] Vendim Nr. 363, Datë. 26.5.2022: https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/vendim-363-date-26.5.2022.pdf
[268] Evidenca 58. Plani strategjik Alumni dhe karriera 2020-2025
[269] https://students.umb.edu.al/news5650.html
[270] Evidenca 49. Agjenda e javës orientuese (marrë nga dosja e masterit profesional Arsim Special)
[271] https://students.umb.edu.al/revista-studentore.html
[272] Evidenca 15. Lista e anëtarëve të klubit studentor të psikologjisë
[273] Evidenca 16. Kalendari vjetor i aktiviteteve të klubit studentor të psikologjisë
[274] Evidenca 19.4 Manual i klubeve studentore 2022
[275] Evidenca 19.3 Strategji e klubeve studentore 2020-2025
[276] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[277] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[278] Evidenca 1.2 Rregullore e departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[279] Evidenca 1.1 Rregullore e fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UniBa nuk përcakton kritere shtesë për përzgjedhjen e kanditëve nga shtete të tjera. Në kriteret e përcaktuara nuk ka kufizime për kandidatë që aplikojnë nga shtete të tjera, por përcaktohet që për secilin kandidat që ka një diplomë jashtë Shqipërisë të bëhet njëhsimi sipas procedurave ligjore përpara aplikimit për programin studimor dhe të dorëzohet diploma e njëhsuar[280281282283]. |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | UniBa në rregullore e tij[284] përcakton dhënien e bursave për studentë, dhe përcakton akte normative[285]. Në faqen zyrtare të UniBa, specifikohen bursa të ekselencës 1 vjeçare për maturantët, bursa merite për maturantët me merita të spikatura dhe bursa sociale të pjesshme një vjeçare për studentët me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara, me vështirësi ekonomike familjare, apo kur është fëmijë i një polici të vrarë[286]. Në dokumentacionin e DVV nuk ka shembuj të vendimeve të komisioneve ad hoc apo të Bordit të Administrimit për të evidentuar dhënien e bursave për studentët e këtyre kategorive. |
| **Konkluzione** | *GVJ arrin në konkluzionin se UniBa ka hartuar politika mbi procedurat e pranimit, përzgjedhjes, përparimit të sudentëve të programit master shkencor në psikologji klinike, si dhe procedura të transferimit të studimeve, të njohjes së studimeve dhe të diplomimit të studentëve. GVJ evidentoi që kriteret e pranimit në këtë program mësuesie janë në konform të kuadrit ligjor, duke respektuar kriterin e pranimit sipas mesatares për programet psikologjisë. GVJ rekomandon zgjerimin e politikave në kuadër të grupeve të pakicave dhe të margjinalizuarëve. UniBa sipas rregullores së saj mbështet studentët me bursa, specifikisht, bursa të ekselencës 1 vjeçare për maturantët, bursa merite për maturantët me merita të spikatura dhe bursa sociale të pjesshme një vjeçare për studentët me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara, me vështirësi ekonomike familjare, apo kur është fëmijë i një polici të vrarë. Rekomandohet që institucioni të evidentojë raste të marrjes së këtyre bursave nga studentët sipas specifikave përkatëse..* |

280 Evidenca 1.1 Rregullore e fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit
281 Evidenca 1.2 Rregullore e departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
282 Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
283 https://umb.edu.al/pranimet.html
284 Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
285 Evidenca 20.4 Rregullore e zyrave studentore, alumni dhe karriera
286 https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | UniBa me anën e rregulloreve në nivel institucioni, njësisë kryesore, njësisë bazë dhe të programit të studimit, dhe me anën e faqes zyrtare të tij, rrjeteve sociale, vë në dispozicion informacione të rëndësishme për procedurat e përparimit akademik të studenëtve, për kriteret e kalimit nga një vit akademik në vitin tjetër akademik, si dhe informacione për kriteret e pranimit[287]. Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit[288][289][290] dhe rregulloren e programti të studimit[291]. Në takimin me studentët, rezultoi se ato ishin të informuar mbi detyrimet dhe të drejtat e tyre si studentë, detyrimet për programet lëndore dhe detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogët përgjegjës. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | UniBa ka procedura dhe akte vetrregulluese[292] për të orientuar kandidatët për të studiuar në programet që institucioni ofron duke publikuar kriteret dhe procedurat e e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme të studimeve të tyre. Gjithashtu, në programet lëndore janë të shprehura informacionet për kreditet e lëndëve, temat specifike të lëndëve, vlerësimi i dijeve, aftësitë që synohen të zhvillohen në programet lëndore, duke mundësuar procesin e konvertimit, njehsimit të kualifikimeve të studimeve të mëparshme[293]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e | UniBa ka në dispozicion rregulloren e programit ku studentët informohen për vlerësimin e dijeve dhe aftësitë që programi synon |

[287] https://students.umb.edu.al/revista-studentore.html
[288] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[289] Evidenca 1.2 Rregullore e departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit
[290] Evidenca 1.1 Rregullore e fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit
[291] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
[292] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[293] Evidenca 1.4. Syllabus Msc Psikologji Klinike

| | |
|---|---|
| vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | të zhvillojë[294]. Gjithashtu, studentët informohen mbi procedurat e vlerësimit të dijeve në silabuset e lëndëve[295]. Gjatë takimit që GVJ pati me studentët e programit, rezulton se ato kishin informacione të larta mbi çdo procedurën e vlerësimit dhe zhvillimit të aftësive që lidhen me programin studimor. Sipas tyre, pedagogët e lëndëve informojnë vazhdimisht studentët në lidhje me detyrimet, vlerësimin e vazhdueshëm të dijeve dhe aftësitë që zhvillohen në kurset përkatëse. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Sipas rregullores së fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit, neni 16[296], pika 4, studentët e programit diplomohen me punim të diplomës. Në rastin e programit studimor master shkencor në psikologji klinike, prova finale, sipas pikës 3.c[297], është duke bërë një hulumtim kërkimor, në formën e një teze kërkimore, seri esesh kërkimore, dosje kërkimore apo implementimin e një projekti kërkimor. Kriteret dhe proçedurat e provës finale për tezën kërkimore janë të paraqitura specifikisht në dokumentin e provës finale, por nuk ka udhëzime në këtë dokument për format e tjera të hulumtimit kërkimor. Nga takimi me studentët, u vu re që studentët e vitit të dytë ishin angazhuar në hulumtim kërkimor që bazohej në një tezë kërkimore. Studentët shprehën mbështetje të vazhdueshme nga udhëheqësit e tyre në punën kërkimore. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | UniBa nëpërmjet faqes zyrtare në internet, rrjeteve sociale[298], javës orientuese[299], klubeve studentore[300][301], synon të informojë studentët e ardhshëm për programet e studimit që ofron. UniBa ka një larmi broshurash në funksion të promovimit dhe informimit rreth shërbimeve, programeve të studimit që ofron. |
| **Konkluzione** | *GVJ pas shqyrtimit të DVV dhe pas takimeve në institucion, konkludon se UniBa ka vënë në dispozicion të studentëve të programit studimor të gjithë informacionin e duhur për studentët* |

[294] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
[295] Evidenca 1.4. Syllabus Msc Psikologji Klinike
[296] Evidenca 1.1 Rregullore e fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit
[297] Evidenca 13.3 Paketa e proves finale
[298] https://www.umb.edu.al/
[299] Evidenca 49. Agjenda e javës orientuese (marrë nga dosja e Arsimit Special)
[300] Evidenca 19.3 Strategji e klubeve studentore 2020-2025
[301] Evidenca 16. Kalendari vjetor i aktiviteteve të klubit studentor të psikologjisë

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *e që lidhet me procedura, aktivitete, kritereve të vlerësimit të dijeve, aftësitë që zhvillon program, detyrimet dhe përgjegjësitë e studentëve, të pedagogëve, të stafit ndihmës akademik, të administratës në mënyrë që studentët të jenë të orientuar gjatë procesit studimor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Gjatë vizitës së GVJ, rezultoi se studentët ishin shumë të informuar mbi strukturën, organizimin, tarifat, kreditet që duheshin për të kaluar në vitin pasardhës. Informacioni merrej nga zyrat e studentëve, sekretaria mësimore, lajmërimet e pedagogëve për lëndët përkatëse, lajmërimet në stendat përkatëse në departamente, në sekretari, në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale. Studentët gjatë javës së parë të studimeve orientohen për programin studimor, për detyrime dhe shërbimet në funksion të arritjeve akademike[302]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Informacionet e rëndësishme për studentët si për shembull rregullorja e programit të studimit, apo rregullorja e zyrës së studentëve, viheshin në dispozicion të studentëve përmes faqes së internetit[303], komunikimit me pedagogët me anën e platformës së Google Classroom, javës së orientimit, gjatë aktiviteteve të klubeve studentore dhe me anën e silabuseve. Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, u konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për | Për të mbështetur studentët për orientimin drejt tregut të punës, UniBa ka organizuar struktura që monitorojnë dhe orientojnë studentët për punësim. Këto struktura janë Zyra e Karrierës dhe Alumni[304], Bordi i Karrierës[305], Klubi i Karrierës[306], si dhe |

[302] Evidenca 49. Agjenda e javës orientuese (marrë nga dosja Arsim Special)
[303] https://umb.edu.al/en/dossier-UniBa.html
[304] https://umb.edu.al/zyra-e-karrieres-dhe-alumni.html
[305] Evidenca 29. Vendim Bordi i Karrierës
[306] Evidenca 19.3 Strategji e klubeve studentore 2020-2025

| | |
|---|---|
| orientimin drejt dhe në tregun e punës. | shërbimet e punësimit që ofrohen nga Am-Barleti Human Capital[307], në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit[308]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Pavarësisht se institucioni UniBa ka një sistem të menaxhimit të informacionit të brendshëm, ky sistem nuk përdorej me studentët e këtij programi studimor. Gjatë vizitës së GVJ në institucion, rezultoi se studentët përdornin adresat e tyre personale në komunikimet me stafin akademik, apo komunikime të tjera me stafin administrativ, personelin ndihmës akademik. Gjithsesi, studentët ishin të mirëinformuar mbi organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të programit. Kjo falë komunikimit të vazhdueshëm me stafin akademik, përgjegjësin e departamentit, zyrave studentore dhe stafit të sekretarisë mësimore. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes platformave alternative tek studentët e këtij masteri dhe jo përmes Intranet, sistemit të brendshëm të informacionit që universiteti ofron. Studentët e programit përdornin platformën Google Classroom, si një platformë ku mundësohej online marrja e leksioneve, dorëzimi i projekteve, marrja e njoftimeve për programet lëndore. Kjo platformë e përdorur lehtëson komunikimin e shpejt dhe në kohë reale të studentëve pavarësisht distancave të tyre. |
| **Konkluzione** | *Në përfundim, GVJ vlerëson se studentët ishin të informuar mbi procesin mësimor, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit, objektivat e programeve lëndore, mundësitë e punësimit, shërbimeve që ofron UniBa në funksion të zhvillimit të karrierës dhe punësimit. Pavarësisht se për këtë program studimi nuk përdorej një sistem i menaxhimit të informacionit të brendshëm, format alternative të platformave të komunikimit dhe ndërveprimit online janë përdorur me rezultat dhe kanë qenë shumë komodë për studentët. GVJ rekomandon që sistemi i brendshëm i informacionit, Itranet, të implementohet tek studentët e programit studimor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.4** |
|---|

[307] https://humancapital.al/
[308] Evidenca 58. Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020-2025

| **Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Programi i masterit shkencor në "Psikologji Klinike" është hapur në vitin akademik 2022-2023[309]. Në përfundim të vitit akademik 2023-2024, diplomohet grupi i parë i studentëve. Statistikat për këtë grup lidhen me numrin e studentëve që janë regjistruar në program, numrin e studentëve që vazhdojnë programin, numrin e studentëve që e kanë lënë programin, mesataret hyrëse[310]. Gjatë vizitës së GVJ, personeli ndihmës akademik në sekretari konfirmoi ruajtjen e të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore administronte një regjistër duke ruajtur vlefshmërinë e procedurave të hedhjes së informacioneve por nuk kishin një regjistër themeltar të studentëve nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Referuar tabelës 21[311], vihet re se për vitin akademik 2022-2023, numri i regjistrimit të studentëve të rinj në program është 4, dhe mesatarja e tyre 7.5. Në vitin e dytë shohim një trend rritës të regjistrimit në vitin akademik 2023-2024, 15 studentë të regjistruar me mesatare hyrëse[312] 7.8. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Sekretaria mësimore disponon të dhënat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, nëse ka pasur tërheqje nga programi, largime, mospërfundim me sukses të programit. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program për vitin akademik 2022-2023 është 4, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 është 15 studentë. Mesataret hyrëse janë 7.5 dhe 7.8. Siç vihet re, numri i studentëve në vitin e e dytë të ofrimit të programit është shumë më i lartë në krahasim me vitin e parë, dhe mesataret hyrëse të studentëve janë në rritje, përkatësisht 7.8. |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të | Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin e informacionit në lidhje me studentët sipas programeve përkatëse si dhe me të dhënat statistikore nga hyrja deri në dalje të studentëve nga programi[313]. Sekretaria menaxhon të dhënat e stundentëve |

[309] Evidenca 23. Urdhër Nr. 507, datë 6.9.2022. Për hapjen e programit MSH në Psikologji Klinike
[310] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)
[311] Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse (në fund të RVB-së)
[312] Vendim Nr.46, Datë 27.1.2021 https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf
[313] Evidenca 20.4 Rregullore e zyrave studentore, alumni dhe karriera

| | |
|---|---|
| informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit të brendshëm, që është Portali Studentor[314]. Personat e autorizuar përdorin sistemin për të gjeneruar statistika mbi studentët dhe për t'u informuar në mënyrë të shpejtë mbi arritjet e studentëve apo informacione të tjera të nevojshme. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Në bashkëpunim me Zyrën e Cilësisë së Brendshme të UniBa dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe të Programeve, planifikohen kontrolle periodike, të cilat janë përcaktuar edhe në rregulloret e institucionit[315][316][317][318]. GVJ, nga vizita në sekretarinë mësimore konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të rregjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi. Një problem shqetësues për stafin e sekretarisë mësimore ishte mungesa e regjistrit themeltar nga QSHA. |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | DSHSSH harton raporte periodike ku fokusi bie tek arritjet e departamentit, bashkëpunimet ndërkombëtare, avancimin e stafit akademik, trajnimeve në funksion të rritjes së cilësisë së programeve që departamenti ofron. Në raportin vjetor të UniBa[319] raportohet mbi gjurmimin e studentëve, si dhe punësimit të tyre[i]. Gjithashtu, në këtë raport bëhet një analizë e mesatares së studentëve të vitit akademik 2022-2023, ku raportohet se mestarja e grupit është 8.2, gjë që tregon një rritje në krahasim me profilin e tyre hyrës që është 7.5[320]. Një shpjegim për këtë rritje të mesatares nuk është dhënë në raport. Aftësimi i studentëve për tregun e punës është në vëmendje të institucionit. UniBa ka krijuar një sërë shërbimesh dhe aktivitetesh në funksion të rritjes së |

[314] Evidenca 35. Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK
[315] Evidenca 16.2. Rregullore e NJZHKC
[316] Evidenca 16.1. Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standarteve e të cilësisë në UniBa
[317] Evidenca 12. Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës
[318] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[319] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023
[320] Evidenca 55. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa 2022-2023

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | shanceve për punësim të studentëve[321][322][323], të cilat sugjerohen të specifikohen në çdo program studimi që ofrohet. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave që përdoret nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në Psikologji Klinike. Të dhënat ruhen edhe në regjistra të posaçëm nga pranimi dhe regjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu institucioni disponon të dhëna edhe për punësimin e studentëve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | UniBa në statutin[324] e tij dhe rregulloren[325] e tij parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse si Senati Akademik, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Standarteve të cilësisë[326], Dekanatit të Fakultetit, përfaqësimit të studentëve në mbledhjet e departamentit, të mbështetjes institucionale në formimin e qeverisë studentore[327][328] si dhe angazhimin e tyre në GVB. Përfshirja e studentëve apo e përfaqësuesve të tyre përcaktohet në aktet ligjore por edhe rregulloreve të vetë institucionit[329][330][331][332]. |

[321] https://humancapital.al/
[322] Evidenca 19.3. Strategjia e Klubeve Studentore 2020-2025
[323] https://students.umb.edu.al/news5650.html
[324] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[325] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[326] Evidenca 16.1. Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standarteve e të cilësisë në UniBa
[327] Evidenca 19.1. Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative
[328] Evidenca 19.2. Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në qeverinë studentore UniBa
[329] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[330] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[331] Evidenca 19.5 Rregullore e funksionimit të zyrave studentore, Alumni dhe karriera
[332] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Institucioni garanton përfshirjen studentore në strukturat vendimmarrëse sipas kuadrit ligjor dhe rregullator të tij[333][334][335][336], duke përcaktuar përfaqësues studentor në Senatin Akademik, në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë[337], dhe pjesë e GVB. Gjithashtu, UniBa ka krijuar struktura studentore për të mbështetur zhvillimin e aftësive të tyre profesionale por edhe të forcimit të rrjeteve studentore duke fuqizuar zërin e tyre[338][339]. Gjatë procesit të vlerësimit të stafit akademik, studentët luajnë një rol të rëndësishëm pasi angazhohen në vlerësimin e pedagogëve të programeve lëndore duke pasur impakt në procesin e cilësisë së mësimdhënies[340]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Nga vizita e GVJ në institucion si me stafin akademik, përgjegjësin e departamentit dhe me studentët, rezulton se studentët organizonin fokus grupe me stafin akademik, ose përfshiheshin në diskutime të DSHSSH për procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit ku diskutimet më së shumti ishin mbi organizimin e lëndëve, metodave të mësimdhënies demonstrative. Gjithashtu, studentët vazhdimisht vlerësojnë programin studimor dhe mësimdhënien me anën e vlerësimeve të vazhdueshme[341]. Studentët e programit studimor kishin mundësi të komunikonin në mënyrë të vazhdueshme për çdo sugjerim, apo përmirësim në procesit të mësimdhënies me koordinatorin e njësisë bazë[342], e më pas koordinatori reflektonte shqetësimet e studentëve në njësinë përgjegjëse. Por koordinatori ishte përgjegjës për të gjithë programet që ofron DSHSSH. Aktualisht nuk ka një koordinator që është përgjegjës vetëm për programin e studimit në master shkencor psikologji klinike, sipas udhëzimeve ligjore në fuqi[343] |

[333] Evidenca 1.4. Statuti i IAL
[334] Evidenca 16.1. Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standarteve e të cilësisë në UniBa
[335] Evidenca 19.2. Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në qeverinë studentore UniBa
[336] Evidenca 19.1. Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative
[337] Evidenca 16.1. Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standarteve e të cilësisë në UniBa
[338] Evidenca 19.3 Strategji e klubeve studentore 2020-2025
[339] https://students.umb.edu.al/qeveria-studentore.html
[340] Evidenca 11.2. Formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët
[341] Evidenca 11.2. Formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentët
[342] Evidenca 30. Nr.24, datë 14.10.2022 Për emërimin në detyrë të koordinatorit të DSHSSH
[343] Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021 Për miratimin e kodlit të cilësisë së arsimit të lartë. https://arsimi.gov.al/vendim-nr-824-date-24-12-2021-per-miratimin-e-kodit-te-cilesise-se-arsimit-te-larte/

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Procesi i vlerësimit dhe kontrollimit të dijeve është i rregulluar si në nivel institucioni[344][345], njësie kryesore[346] dhe njësie bazë[347]. Rregulloret e brendshme të institucionit, por dhe ajo e programit të studimit ju mundësojnë studentëve një proçes transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Sipas rregullores së UniBa[348] provimet sekretohen nga sekretaria, dhe këto provime hapen pas korrigjimit nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vlerësimit të studentëve. Studenti ka të drejtë të ankimimit për provimin dhe procedura e ankimimit rregullohet sipas Nenit 89 të rregullores UniBa. Nga vizita e GVJ në institucion dhe takimi me studentët, rezulton se studentët janë shumë të qartë për procesin e vlerësimit dhe kontrollimit të dijeve dhe nuk kishin pasur raste ankimimi, por ishin të qartë se si do të vepronin në rast se do të bënin një procedurë të tillë. |
| **Konkluzione** | *GVJ nga DVV dhe nga vizita në institucion del në përfundimin se institucioni kishte të ndërtuar kuadrin rregullator për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, dhe nga takimi me studentë u evidentuan raste kur ata ishin të përfshirë në procesin e hartimit, miratimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit. Gjithashtu, institucioni UniBa ka krijuar procedura transparente të vlerësimit dhe kontrollimit të dijeve. GVJ rekomandon përcaktimin e një koordinatori për çdo program studimor që ofrohet nga DSHSSH, sipas kuadrit ligjor për kodin e cilësisë në arsimin e lartë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme | UniBa në mbështetje të studentëve ka krijuar një infrastrukturë dhe mekanizma specifik në funksion të informimit, dhënies së |

[344] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[345] Evidenca 19.5 Rregullore e funksionimit të zyrave studentore, Alumni dhe karriera
[346] Evidenca 1.1 Rregullore e fakultetit të shkencave sociale dhe turizmit
[347] Evidenca 3. Rregullore e programit MSH në Psikologji Klinike
[348] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti

| | |
|---|---|
| në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | shërbimeve për studentët, sipas parashikimeve ligjore[349] dhe akteve rregullatore[350351352] të institucionit. UniBa vë në dispozicion disa zyra të rëndësishme për të ofruar shërbim për studentët si Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra Alumni dhe Karriera, Biblioteka, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, si dhe një tërësi klubesh studentore[353] që kanë si qëllim orientimin dhe përshtatjen e studentëve me jetën studentore. Këto struktura ofrojnë shërbime të nevojshme dhe mbështetëse për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në UniBa dhe vijojnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj. Gjithashtu, UniBa ka krijuar një agjenci punësimi[354], Barleti Human Capital, që ka si qëllim të krijojë një urë midis Alumnit të tij dhe tregut të punës, me anën e promovimit të ofertave të punës, trajnimeve profesionale, mbështetje për start-up etj. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | UniBa vë në dispozicion disa zyra të rëndësishme për të ofruar këshillim, asistim, ndjekje dhe përparimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra Alumni dhe Karriera, Biblioteka, kanë si qëllim orientimin dhe asistimin e studentëve gjatë procesit mësimor dhe më tej në mbështetjen për t'u përqasur në tregun e punës. UniBa me anën e agjencisë Barleti Human Capital[355] ka si qëllim të mbështes Alumnin e tij në tregun e punës, me anën e promovimit të ofertave të punës, trajnimeve profesionale, mbështetje për start-up etj. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe | Në UniBa Zyra Alumni, Karriera dhe Dekani i Studentëve u ofronin studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Alumnit dhe Karrierës ka krijuar një bazë të dhënash për Alumnin[356]. Gjithashtu, UniBa mbështet këshillimin e karrierës të studentëve duke organizuar edhe aktivitete nga Zyra Alumni[357], Klubi i Karrierës[358] dhe aktiviteteve të organizuara nga agjencia e |

[349] Ligji Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/AKTET_NENLIGJORE.pdf
[350] Evidenca 1.3 Rregullorja e Universitetit Barleti
[351] Evidenca 19.5 Rregullore e funksionimit të zyrave studentore, Alumni dhe karriera
[352] Evidenca 19.1. Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative
[353] https://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html
[354] https://humancapital.al/
[355] https://humancapital.al/
[356] Raporti Alumni https://umb.edu.al/upload/pdf/Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf
[357] Evidencë 22.2 Raport Alumni (marrë nga dosja e programit Arsim Special)
[358] https://students.umb.edu.al/klubi-i-karrieres.html

| | |
|---|---|
| periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | punësimit Barleti Human Capital[359]. Kjo agjenci mbështet studentët dhe Alumnin në ofertën e punës, asistimin për aplikim për punë, organizimin e seminareve dhe uorkshopeve në ndihmë të procesit të punësimit, praktikave profesionale etj. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | UniBa nëpërmjet Zyrës Alumni dhe Karriera ndjek studentët pas diplomimit, mbledh dhe përpunon statistika mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Këto statistika raportohen në raportet vjetore të institucionit[360] dhe të Zyrës Alumni dhe Karrierës. Zyra e Alumni dhe Karrierës bashkëpunon me Agjensinë e Punësimit Human Capital Barleti, në mënyrë që shërbimi për studentët dhe Alumnin si dhe gjurmimi i tyre të jetë në funksion të punësimit. |
| **Konkluzione** | *Si përfundim, UniBa garanton mekanizma rregullator dhe ofron shërbime me anën e zyrave të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, asistimin e studentëve në problematikat e tyre përreth vlerësimit, kontrollit të dijeve apo procesit studimore. Këto mekanizma janë të sanksionuara nö rregulloret e institucionit e shërbimet ofrohen nga një tërësi zyrash në funksion të studentëve si zyra e pranimit, sekretaria mësimore, zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumnit dhe Karrierës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[359] https://humancapital.al/
[360] Evidenca 57. Raporti vjetor UniBa 2022-2023

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | UniBa ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies për programet studimore që ofron[361]si dhe udhëzues për të mbështetur studentët në përdorimin e programeve online për mësimdhënien apo përdorimin e teknologjisë së informacionit[362]. Institucioni ka miratur Komisionin e Sigurimit të Standarteve të Cilësisë[363], i cili është një organ kolegjial që kryen sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit, duke punuar në sigurimin e standarteve shtetërore të cilësisë të parashikuara në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kuadrit ligjor që rregullojnë elementët e programeve të studimit[364]. UniBa ka struktura përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të cilat janë: Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë dhe koordinatori institucional, Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Komisioni i Vlerësimit të Performancës[365], Senati Akademik, koordinatorët e njësive bazë, si dhe Grupet e Vlerësimit të Brendshëm. Por, nga DVV, por edhe nga vizita në institucion, evidentohet mungesa e një koordinator për programin studimor. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative | Strukturat kryesore të monitorimit dhe vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe personelit akademik dhe ndihmës akademik në UniBa janë Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Komisioni i Vlerësimit të Performancës dhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Përmes rregullores së Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë[366], Rregullores së Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave[367][368] dhe Cilësisë dhe Vlerësimit të |

[361] Evidenca 11.1 Udhëzues për metodat e mësimdhënies
[362] Evidenca 35. Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK
[363] Evidenca 16.1. Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standarteve e të cilësisë në UniBa
[364] Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021 Për miratimin e kodlit të cilësisë së arsimit të lartë. https://arsimi.gov.al/vendim-nr-824-date-24-12-2021-per-miratimin-e-kodit-te-cilesise-se-arsimit-te-larte/
[365] Evidenca 60. Manuali i cilësisë
[366] Evidenca 16.1. Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standarteve e të cilësisë në UniBa
[367] Evidenca 16.2. Rregullore e NJZHKC
[368] Evidenca 59. Plan Pune NJZHKC

| | |
|---|---|
| të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Performancës[369] synohet të sigurohen standardet e cilësisë duke krijuar vlerësime të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë të UniBa së bashku me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë[370], vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së studentëve, vlerësimin e cilësisë së personelit[371]. Pjesë të këtyre veprimtarive janë zyra e burimeve njerëzore, njësitë për kërkimin shkencor, fakultetet, departamentet dhe zyrat për studentët dhe koordinatorët institucional dhe të njësisë bazë. Bazuar në informacionin e paraqitur në DVV dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se bëhen vlerësime të vazhdueshme për të monitoruar cilësinë e brendshme të institucionit. |
